

81H-32

7 76

**THANAS JORGJI**

**Ajër  
i kulluar**

novelë,  
tregime

8JH-52

776.

Thanas Jorgji



Ajër  
i kulluar

●  
novelë  
e tregime

SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHERI»

## Ajër i kulluar

Në dhomë dëgjohet zhurma e centrifugës. Nga dritarja e vetme e barakës vjen një dritë e paktë, dhe brenda është gjysmerrësirë. Dielli sapo ka perënduar, horizonti duket ende i përflakur. Është ajo kohë kur duket shpejt për të ndezur dritën dhe vonë për të ndenjur pa të. Jemi vetëm të dy: unë e ndihmësi, një djalë bardhosh që sapo ka mbaruar kursin e bletërritësve. Unë pres me thikën e madhe si mistri kapakët e dyllit të kornizave e ia afroj Tonit, ndihmësit.

Flasim rrallë, shohim punën. I vë veshin zukatjes së bletëve në xhamin e dritares, që mundohen më kot të dalin jashtë. Toni kujdeset të mos e shpejtojë më shumë se ç'duhet vërtitjen e dorezës. Hojet e reja japë delikate dhe rrotullimi i tepërt i këput. Nuk flasim shumë, ndoshta nga qenë ende nuk jemi njohur mirë. Ka vetëm një javë që ai ka ardhur ndihmës tek unë. Herë-herë, si për t'u gjendur në fjalë, i them:

— Toni, ha mjaltë. Mos të të vijë rëndë.

Toni, që sikur e pret këtë, mban për një çast dorezën. më hedh ata sytë e bardhë dhe pyet:

— Po ti, usta?

— Unë? Unë s'e ha mjaltin.

Duket hapur që ai s'më zë besë, bile vështrimi i tij bëhet dyshues. Në sy i shkëlqen një inat i lehtë, gati i padukshëm e megjithatë nuk flet. Vazhdon t'i japë dorezës.

Ajo mëri e heshtur dhe ai djalë më kujtojnë veten dhe ustanë tim.

## 1

Sapo kisha mbaruar kursin njëvjeçar të blerëritësve, kur më thanë se do të punoja me Kolën. Më porositën të kisha kujdes me të. Ishte ca i sertë e i çuditshëm, por usta në zanat. Unë do të isha ndihmësi i tretë. Dy të parët i kishte përzënë. Pyeta për të e më thanë se ky Kola ishte një burrë rreth të gjashtëdhjetave, banonte në qytet dhe kishte një vajzë të bukur. Dikush më tregoi se ai ishte një tip i mbyllur e i heshtur si murg. Nuk më erdhi mirë kur më thanë se për një kohë të pacaktuar do të punoja ndihmës i tij.

E ç'është ky Kola?! u skërmita përbrenda. Një i pashkollë, ndoshta një sharlatan. Ja, prandaj s'bën përpara shkenca, se ka njerëz praktikistë që me plot gojën më thonë: «Shko puno si ndihmës i Kolës» mua, teknikut të mesëm të bletëve, që në provimet kualifikuese kisha marrë vetëm dhjeta. Megjithatë nuk bëra zë. Vendosa të shkoja atje ku më caktuan e, po ta donte puna, t'i shpallja luftë shkencore atij Kolës që e kishte një mexhide fjalën.

Vendi ku ndodhej parku ishte vetëm nja katër a pesë kilometra larg qytetit tonë të vogël, midis disa dhjetëra hektarëve akaciesh e pishash.

I lodhur e i djersitur, hyra në masivin e akacieve. Për një çast mbajta këmbët, jo për t'u çlodhur, po për të admiruar pamjen. Ishte fund maji e akaciet ishin në kulmin e lulëzimit. Qe me të vërtetë një pamje e bukur: akacie të ngarkuara me vilet e luleve të tyre të bardha në ngjyrë qumështi, si të rënduara nga dëbora. Poshtë këmbëve të mia shtrihej qilimi i butë e i bardhë i lulëshqerrave. Kurrë nuk kisha parë aq shumë lulëshqerra, aq të dendura e në një hapësirë aq të madhe. Një bardhësi që të merrte sytë.

Në natyrë gjithmonë mund të gjesh pika ngjashmërie, në të cilat kryqëzohen stinët: arabeskat e akullta në xhama në palcë të dimrit të kujtojnë blerimin e luleve të pranverës, ashtu si bardhësia e luleakacieve të kujton degët që u merr frymën dëbora.

Ndenja disa çaste mëdyshas me atë druajtjen e njeriut në pragun e një dhome, në dyshe-menë e së cilës shtrihet një qilim i mrekullueshëm ku ai druhet ose i vjen keq të shkelë.

Mbresa e dytë më erdhi fill pas së parës: Një aromë e mirë lulësh, që të kujtonte erën e mjaltit, më bëri të merrja frymë fort, me gjithë mushkëritë.

Asnjë gjeth nuk lëvizte. Ajri i ngrohtë e i ngopur me aromë rrinte pezull. Ja, pikërisht për një ditë të tillë e për këto kushte klimatike e kishte fjalën profesori, kur shpjegonte «rënien e mjaltit»: një ditë e kthjellët, e ngrohtë e pa erë.

Tani po «bie mjalti», mendova unë e ndërkaq diçka tjetër më tërhoqi vëmendjen: një zhurimë e ulët, monotone dhe e vazhdueshme që sikur më kujtonte: «Mjalti nuk duhet vetëm «të

bjerë», duhemi edhe ne që ta mbledhim.» Ishte përshëndetja e parë e bletëve të Kolës. Kisha hyrë në mbretërinë e tyre.

«Bletët e Kolës». Këto fjalë të shkuara natyrshëm nëpër mend sikur ma prishën kënaqësinë e m'i davaritën mendimet. Hodha me vendosmëri, pothuaj me inat hapat mbi qilimin e trashë e të butë të luleshqerrave. Ktheva kokën pas. Prapa në lëndinë dukeshin qartë hapat e mi. Qëndrova dhe u ula të shihja me kureshtje. Vura re luleshqerrat e shkelura, që me lëvizje të ngadalta ngrinin kryet përpjetë dhe më erdhi keq për to.

Eca sërish i rrethuar nga cicërima e zogjve të pyllit. Nga larg pashë parkun e bletëve, të qarkuar me një gardh të bukur teli. Zgjojet, vendosur në rreshta të rregullt, hipur mbi këmbalecë, ndrisnin nga boja. Dukej si një copë mozaik me gurë të bardhë, të verdhë, jeshilë e bojë qielli. Përpara verandave bari ishte i kositur e sipër tyre mbështeteshin dërrasat, mbi të cilat ngjiteshin në verandë bletët e lodhura.

Genka njeri punëtor ky Kola. thashë me vete atë që s'ma kishin thënë të tjerët. Nuk di si më erdhi nga ky përfundim, mirë apo zili, por vazhdova të vëreja me kujdes. Diku, nga mesi i parkut, u ngrit ngadalë një burrë me kanotierë të bardhë. U përkul prapë e nga lëvizjet mora me mend që po vinte tavanin e zgjoit dhe pastaj çatinë.

Sapo më pa, mori nga toka një bllok të madh shënimesh dhe u afrua te dera. I dhashë dorën dhe i thashë kush isha. Ai më hodhi një sy nga poshtë lart, si për të më matur sa vlejja, dhe më ftoi të hyja brenda gardhit.

Kishte ecje të shtruar e trup rrondokop, të lidhur mirë. Disa çaste nuk folëm, si të mbanim

vesh fëshfërimën e hapave tanë nëpër bar. Papatitur u ndal duke më mbajtur fort nga krahu, sikur para nesh të qe vendosur një minë. U ul me kujdes, pas tij u ula dhe unë. Në bar ishte një bletë me këmbët e pasme ngarkuar me pjalm ngjyrë karote.

Kola futi nën sjetull bllokun e madh të shënimeve, lyer aty-këtu me dyllë e propolis. Gishatat e tij të trashë e të ngathët e kapën me kujdes, aq sa ç'mund të kapnin ata, nga krahu. E ngriti, e vuri në pëllëmbë dhe pëshpëriti:

— Qenke lodhur, moj xhane, qenke ngjitur gjer në Moravë.

Zëri i Kolës buronte ngrohtësi, aq sa mua më erdhi të qeshja. M'u duk shumë komike që një burrë i thyer në moshë, me lëvizje të ngathëta si të një ariu, të fliste me aq delikatesë me një mizë.

Barku i bletës fryhej e mblidhej me të shpejtë nga frymëmarrja e nxituar. Pasi u çlodh, ajo drodhi krahët dhe fluturoi. Kola e ndoqi një copë herë me sy, si të dallonte e ç'zgjoi ishte, apo të sigurohej që s'binte prapë. Pastaj, aq papatur sa më trembi, bërtiti sa i hante zëri:

— Yftata! Ahaa! — dhe zuri ta valëviste me vrull bllokun e madh.

Unë kërceva si i pickuar nga gjarpri. Kola, me kokën lart nga qielli, vazhdonte të gërthiste, madje më ftoi edhe mua:

— Thirr, ç'e mban veten! — Hodhi bllokun përtokë dhe nisi t'u binte fort shuplakave.

— Ah, që s'e kam çiften! Të më shihnin bizbiqkat, — tha me inat e urrejtje.

Në qiellin e kaltër s'pashë gjë tjetër veç dallëndysheve që vërtiteshin të gëzuara. Paska rrjedhur plaku i shkretë! thashë me vete.

— Kujt u thërret ashtu, usta, dallëndyshe-

— S'të pyeta për provimet. Në shkollë mund të marrësh dhjetë e nesër të mos dish gjë hiç. Mund të marrësh pesë e, po punove, të kesh bereqet. Bilbilin e njeh kënga, njeriun puna. Unë të pyeta për tjetër gjë: a të pëlqen kjo punë, jo si zanat... dua të them... përveç lodhjes, a ndien ndonjë kënaqësi kur punon me to.

Sytë e Kolës ndrisnin më tepër se nga një kureshtje e thjeshtë. Ata prisnin përgjigje.

— Ma merr mendja, më mirë se në fermë duhet të jem, — thashë.

Nuk e kuptova ku e kisha shkelur. Pashë Kolën të ngrihej nga karrigia dhe të shkonte te një kolonë zgjojesh të vendosura një mbi një. Seç filloi të rrëmonte kot atje, duke më kthyer shpinën. Nuk deshi që unë ta vija re se përgjigjja ime e kishte zemëruar. Pas pak u kthye dhe u ul atje ku kishte qenë. Zumë të bisedonim për gjëra të përgjithshme. Kola sikur druhej të më pyeste prapë. Trembej se përgjigjja ime do ta zhgënjente më keq.

Pasi folëm një copë herë, midis nesh ra prapë heshtja, siç bie gjatë një bisede që shtyhet me zor. Ndenjëm disa çaste pa folur, derisa heshtja u bë e rëndë. Këtë e ndjeu më shumë i zoti i shtëpisë, që duhej të mbante gjallë bisedën.

— Ou, pika plakut! — bëri befaz Kola. — Po unë s'të qerasa me mjaltë.

— Nuk prish punë, usta. Nuk prish punë. I ngopuri nuk kujtohet për të urtuarin, — thashë unë.

Kola u ngrit, mori një pjatë të madhe, të nderë e me lule dhe hapi një bidon.

— Unë, si s'e ha vetë, them se edhe të tjerët s'e hanë, — tha ai duke më vënë përpara pjatën me mjaltë.



Ia qepa sytë të dalloja në tallej, apo e kishte me gjithë mend. Kola po kruante qetësisht xhepat. Kërkonte paketën e cigareve.

— T'i kesh duart në mjaltë e të mos i lëpish, e thotë edhe fjala e urtë, — thashë me mosbesim unë dhe ndenja pak i sëndisur. Le ta kuptonte një herë e mirë që s'isha aq mendjelehtë sa ç'mund të kujtonte ai e të mos hiqej më katolik se papa.

— Ashtu vërtet, — tha Kola pa vënë re, — po ja që unë nuk e ha. Më vjen keq të ha mjaltë, më duket sikur u vjedh bletëve gjënë e tyre, punën e tyre.

Unë lëviza vendit. Ky ishte kulmi. Kërkon të më shtihet edhe i shenjtë, pale. Ka njeri që të mos e hajë mjaltin? Për çfarë më merr ky? Për naiv apo për leshko? u brejta me vete dhe vendosa aty për aty t'ia bëja bromb Kolës. Duhet t'i tregoj se nuk e kisha ngrënë thatë një vit të tërë në Tiranë e se, për punë bletësh, nuk ma hidhte dot.

Pasi futa një lugë në gojë, thashë rëndë-rëndë:

— Mjaltë i mirë ky i akacies.

Kola vuri një cigare në buzë, e ndezi e, pasi lëshoi një fjollë tymi, tha:

— Nuk është prej akaciesh. Akacia tani sapo çeli.

Unë mbeta me lugë në ajër. Më nxore of-sajt, o Kolë, thashë me vete me maraz, po loja s'ka mbaruar. Qesh më mirë ai që qesh në fund. Duke ndërruar ton, thashë:

— Çfarë kullotash shfrytëzon sipas stadeve të vegjetacionit? A e aplikon metodën e shtimit intensiv dhe me ç'mënyrë e bën rritjen artificiale të mëmave? — Fola me një frymë dhe pri-

ta të shihja efektin, si një artiljer që ka qëlluar me top.

Kola heshti. Ai vetëm u koll, ndërsa unë ngazëlleva përbrenda. Ja ku po fillonte hakmarrja ime.

— Në sa për qind të parkut ke mëma të cilësisë së parë? — s'e lashë të merrte frymë unë. Ky ishte grushti i fundit, pas të cilit Kola duhej të dergjej përdhe në mënyrë të tmerrshme.

— Nuk e di, — ma preu Kola me një zë që unë nuk e prisja; jo prej të munduri, po prej kryeneçi.

## 2

Mendime të zymta më mbështillnin të nesërmen, tek ngjitesha për në park. Ecja dhe nuk vija re aromën e luleakacieve që të djeshmen më kishte dehur, nuk shikoja bardhësinë që dje më kishte mrekulluar e as që më vinte keq për qilimin e lulëshqerrave që shkelja me hapat e mi të rëndë,

Ç'tip i fantaksur ky Kola! Mirë thoshin që ai pëlçet derrin. Ruhet se mos i vjedh zanatin, ariu plak. Gabohesh, o Kolë, gabohesh! Ja ku ta them unë: ti ke praktikën, po unë kam shkollën e shkolla nga praktika ka dalë. Kujton ti se unë s'do bëj dot pa shpjegimet e tua, se do bie në gjunjë para teje?

Unë s'e ha mjaltin, tha. E vret ndërgjegjja para bletëve. Ç'komedi! Mbase më merr për ndonjë buzëqumësht kokëbosh që mund t'i besojë përrallat e tij.

Këto bluaja në kokë rrugës për në park, du-

ke shtrënguar nën sjetull mëngjesin e drekën,  
futur në një qese celofani.

Trokita dhe hyra në barakë.

— Mirëmëngjesi! — thashë.

Kola, pa këmishë, vetëm në kanotierë, dig  
po bënte në një zgjua. As që ktheu kokën e, në  
vend të përshëndetjes, tha:

— Mbylle derën!

Pasi mbaroi punë, m'u kthye:

— Si u gdhive?

Unë s'fola. Ishte radha ime të mos i për-  
gjigjesha. Le ta dinte që edhe unë kisha dinji-  
tetin tim.

— Mëngjes ke ngrënë? — pyeti Kola.

— Jo, — thashë ftohtë unë.

— Atëherë ulu të hamë, — tha ai dhe nxo-  
ri nga dollapi dy pjata, në të cilat kishte vezë  
të fërguara, feta djathi e domate.

Hapa celofanin tim dhe nisa të haja, duke i  
dhënë haptas të kuptonte se s'kisha asnjë dëshirë  
të shkëmbenim ushqimet.

Ai, pasi lau duart, mori bukën, preu dy feta,  
veçoi me thikë koret nga tuli e m'i zgjati mua:

— Po të duash, haji. Janë të mira.

Unë mbeta i habitur me kafshatë në gojë  
dhe çapëleva sytë, sikur përpara meje të mos  
qëndronte Kola, po një fokë Arktiku. Brofa për-  
pjetë e thashë me zë të ulët e tërë mllef:

— As babai, as gjyshi im nuk kanë lypur  
kurrë edhe kur kanë vuajtur urie.

Nuk di si isha bërë në fytyrë, por mund ta  
kuptoja lehtë duke parë atë të Kolës, që dukej  
e habitur dhe e hutuar:

— Nuk ta thashë për ndonjë gjë, more dja-  
lë. Ta thashë ashtu, pa të keq. Pse të shkojë  
kot? Buka është e mirë, ti ke dhëmbë.

I hodha një vështrim plot përbuzje dhe

mbylla celofanin tim. Oreksi më ishte hequr si me dorë. Edhe ato pak kafshata që hëngra, m'i kishte shpënë në kurriz Kola.

Ai vazhdonte të hante me vështirësi për shkak të dhëmbëve që i mungonin, ndërsa unë mblihdja tërë vullnetin tim për ta detyruar veten të mos dëgjoja mbllaçitjet e Kolës, që sikur e bënte enkas për të më cingëritur nervat. Një valë e nxehtë më ngjitej nga poshtë e më vinte t'i bërtisja: «Mjaft i përplase buzët ashtu. A s'mund të hash pa zhurmë, dreqi të marrtë!» Por nuk fola. Foli Kola:

— Po s'përtove, shko na mbush një ujë të ftohtë. Shishet janë te kova. Çezma është në fund të përroit. Të shpie vetë rrugica.

Mora shishet dhe dola në heshtje, me hesh-tjen e çirakut që s'i kundërshton dot ustait të dyqanit. Ky mendim më inatosi keq e mend u ktheva t'ia përplasja në fytyrë: në të pihet, shko vetë. S'jam hyzmeqari yt. Megjithatë vazhdova rrugën. Rrugica thyhej dy herë në faqen e rrë-pirtë të përroit mbushur plot shelgje e akacie. Poshtë ishte hije e plotë dhe ajri ishte i freskët e i lagësht. Në fund të përroit currilonte një çez-më e vogël dhe e ulët. Shpëlava shishet dhe i mbusha me ujin brisk. Tani isha pothuaj i bindur se Kola ishte një pasha a një çifligar që rronte në mes të të mirave. E ç'e donte qytetin ai? Kjo bindje ma shtoi edhe më pezmin e më-rinë. Shpura ujin e nisa të lexoja në heshtje gazetën e vjetër shtruar mbi tryezë. Kola piu me gërqe të madha dhe, ende pa i zbritur mirë në stomak, tha:

— Shkojmë. Merr arkën e kontrollit.

— Po tymësen, usta, s'do ta ndezim? — pyeta unë.

— E ç'e duam? Mjaft është leva.

— Libri thotë...

— Ehu, sa thonë librat, — tha Kola me të tillë mospërfillje, saqë unë u rreka të kuptoja nëse drejtohej ndaj librave apo ndaj meje mospërfillja e tij.

Hymë në park. Kola ecte përpara me hapa të shtruar, duke hequr zvarrë një palë këpucë të vjetra pune. Supet e tij ishin të pjekura fort nga dielli; kuptohej se ai gjatë tërë kohës në park rrinte në kanotierë.

Papritur diçka m'u përplas në fytyrë, zhu-zhuriu, bëri një rreth të vogël dhe u sul drejt hundës sime.

Nuk besoj të ketë njeri që të mos e ketë frikë sulmin e bletës. Largova kokën, shtrembërova trupin e më në fund flaka tej arkën me korniza dhe zura të luftoja me duar e me këmbë kundër bletës që s'më ndahej. Frika më hyri në palcë dhe qëlloja kuturu në ajër.

Kola kishte qëndruar e po vështronte. Dikur dora ime goditi bletën dhe e rrëzoi përdhe. Unë mora frymë lirisht. Kishte ardhur koha e shpaggës. U afrova te bleta e rënë në bar e me thembrën e këpucës nisa ta shtypja me urrejtje e pa mëshirë. Atëherë ngjau diçka që më trembi më shumë se thumbimi i bletës:

— Përjashta!

Ngrita kokën. Pashë Kolën të shfytyruar e të shkumëzuar nga tërbimi. Sytë i lëshonin një dritë të egër, teli i dhëmbëve gjithashtu.

— Përjashta! Jashtë nga parku! — thirrri prapë ai me frymëmarrje të nxituar e me duart e trasha më dha një të shtyrë të fuqishme, sa mezi u mbajta në këmbë.

— Parku është i shtetit, — ia pata unë.

Kola u ul në bisht, vuri syzet dhe zuri të kërkonte atje ku kisha shtypur bletën. Pasi

s'gjeti gjë, u ngrit, m'u afrua me një pamje kërcënuese e me zë të mekur si nga ngashërimi m'u hakërrye:

— Ti kurrë s'ke për t'u bërë bletërritës! Ai që s'ndien dhembshuri për bletën, ai që e vret me dashje, ai njeri kurrë nuk mund të bëhet bletërritës.

— Bëhem apo nuk bëhem, atë e di unë. S'e la njeri në dorën tënde këtë punë, — ia plasa unë me gjithë inatin që më ishte mbledhur e më ziente prej dy ditësh. — E ti mos kujto se je në mallin tënd këtu e mund të bësh ç'të duash. Parku është i shtetit, ti s'je padron këtu, dëgjon? S'je padron!

Kola thithi dy-tri herë cigaren e tha me zë të ulët sa mezi dëgjova:

— Ato fjalë t'i thashë jo si përgjegjës i parkut, por si bletërritës, more djalë. E kupton? Si bletërritës.

### 3

Kaloi një javë nga dita e parë e vajtjes në park. Tri herë vendosa të mos shkoja më atje e tri herë e ktheva vendimin. Kola qenkësh një tip që s'hahej as me qepë, as me hudhra. Sec kishte një mënyrë të sjelli, që e vinte tjetrin në pozitën e një shërbëtori. Ishte i heshtur e fjalëpak dhe fliste vetëm kur urdhëronte për diçka. Dita dukej që në mëngjes: gjashtë ditë punë, shtatë herë të zënë! Kishte huqe, jo shaka Kola, si një vjehërr i rëndë. Duhej të mos uleshe në krevatin e tij, dera të puthitej, pjata të

lahej menjëherë e të vihej në vendin e vet, gazeta të shtrohej jo prapë, po mbarë.

Kisha një javë në park e levën nuk e kisha marrë asnjëherë në dorë, nuk kisha kontrolluar asnjë zgjua. Vetëm kolovitja në krahë arkën e kontrollit, nxirrja e futja kornizat, blija bukë, mbushja ujë e laja me leckë zgjojet. Të gjitha këto bënin të më vlonte përbrenda inati e më në fund të rebelohesha.

— Usta, edhe unë dua të kontrolloj bletët. Nuk kam ardhur vetëm për hamallëqe këtu, — i thashë një ditë.

Kola bëri një lëvizje të shpejtë në kundërshtim me gjithë natyrën e tij të ngathët, aq sa shqetësoi zgjoin mbi të cilin punonte. Drejtoi trupin, hoqi syzet dhe tha me ironi, pothuaj me përbuzje:

— Si the? Të kontrollosh bletët? Jo po, mos do të të bëj edhe dhëndër, pale!

Sa shumë që fyente ky njeri!

— Dhëndër mos më bëj. As mua s'më ha malli të të kem vjehërr, po levën do ma japësh se s'bën, se s'kam ardhur këtu vetëm të të mbush ujë ty. Jam teknik i mesëm e për bletët di jo më pak se ti.


I kërcyen edhe Kolës të tijat. Pështyu në lëndinë e tha i nxehur:

— Hicgjë nuk di, ja ku ta them unë. Pa hajde këtu. Ja, më thuaj... — ai vështroi rrotull e sytë iu ndalën në verandën e një zgjoi: — Më thuaj, pse rri ajo bleta me krahët varur në verandë?

Unë nxora gjoksin përpara. S'kishte pyetje më të lehtë e më qesharake se ajo:

— Sepse është lodhur, — thashë me bindje të patundur.

— Hë, sepse qenka lodhur! — shfryu Kola.



— Kur të them unë që s'di asgjë... Sepse e ka humbur zgjoin e saj e kështu u tregon rojtarëve të zgjoit se s'ka qëllime të liga dhe kërkon të bëhet pjesëtare e kësaj familjeje. Ja, shiko si shkoi ta nuhasë ajo. Vështro si kjo i lëshoi krahët fare, i uli edhe antenat!

S'më mbetej gjë tjetër veçse të dorëzohesha përpara plakut.

Kola eci më tej. Më thirri e unë u afrova.

— Vështroje këtë zgjua e më thuaj çfarë do të vësh re, — më tha.

Në derën e zgjoit hynin pa pushim bletë, aq sa mezi i nxinte deriçka. Shenjë e sigurt që zgjoi po vidhej nga bletët hajdute:

— Vjedhje, usta. Zgjoi po vidhet, — thashë me shqetësim unë.

Kola qeshi nën hundë:

— Ashtu, hə? Kështu thonë ata librat e tu? — qesëndisi ai. — Bletët hajdute sillkan pjalm në zgjoin që vjedhin, hə? Të rrofshin dhjetat! Kjo tregon që së shpejti koha do të prishet e bletët kudo që janë nxitojnë të kthehen në zgjua, se e ndiejnë shumë më parë prishjen e motit.

Unë e pranova humbjen. Me Kolën ishte e pamundur të ndeshesha. Gjithë ditën s'foli. Bëja në heshtje ato që më thoshte ustai e rrija i sëndisur e çehrevrarë. Isha rrëzuar në teori, tamam aty ku ndihesha më i fortë e ku isha i sigurt se do ta vija përfund Kolën. Nuk ndieja dëshirën më të vogël t'u afrohesha zgjojeve. Më dukej se të gjitha i kisha harruar e tani nuk isha në gjendje të thosha edhe gjënë më të thjeshtë, qoftë edhe sa këmbë kishte blea. Më dukej sikur çdo gjë e shihja për herë të parë e sikur ndodhesha krejt rastësisht në atë park.

Hëngrëm drekë në heshtje. Herë-herë hasja vështrimin e Kolës, që më vëzhgonte përmes sy-



zeve. Ndoshta gëzohej për disfatën aq të turpshme që pësova. Ai u ngrit. Çdo gjë e bënte papritur ky njeri: — Nasho, sot fli këtu. Sonte ka shi e s'dihet ç'bëhet. Unë po shkoj të tërheq zgjojet e reja, ato që kemi porositur në zdrukthëtari. Po shoh edhe për bidonë. Së shpejti do të vjelim. Nga shtëpia jote po dërgoj fjalë unë. Ushqime ke në dollap.

Nuk m'u dha të kundërshtoja. Gjithmonë kështu bosh të zinte Kola.

Iku. Unë mbeta vetëm në mes të atij pylli pishash e akaciesh që më shtinte një ndjenjë të rëndë e të përzishme. Mirë të më bëhej. Kur nuk isha i zoti të kundërshtoja, atje të ngordhja. Isha një gagaç, një memec që e kisha gojën vetëm për bukë. Dhe sa bukur që ma hodhi, pa! Rri këtu se sonde do të bjerë shi. Shi në atë qiell të kthjellët qelq!

Nëpër pyll dëgjoja krakitjen e laraskave dhe s'di të ç'shpendi tjetër që këlthiste me të madhe sa të fuste të ngjethurat në trup. Një shoqëri mjaft gazmore, besa! Kujtova shokët në qoshkun ndanë shëtitores, ku rrinim shpesh pasditeve pasi ktheheshim nga puna. Ata me siguri tani përgatiteshin për të dalë. Ndoshta do të pyesnin edhe për mua. Do të ngrinin supet e mbase ndonjëri do të hamendte: Ia ka mbledhur ustai. Ka një usta ai që... Pastaj sipas mënyrës së vet do të shprehnin keqardhjen për mua. M'u kujtua seria e filmit që ndiqja prej disa javësh në TV dhe m'u ngrit mendja më keq: Si! të rrija aty ngujuar, në mes të pyllit njëzet e katër orë rresht, kur të gjithë punojnë tetë?! Të harrohesha aty për së gjalli? Më hipi në kokë të ikja. Ngrita edhe një herë sytë në qiell dhe pashë mbi male disa re të vogla të praruara me një dritë argjendi, që veç shi nuk mund të sillnin. Po sikur... një zë i brendshëm

më pengonte. Ç'sikur, e kundërshtoja prapë veten. Parku ishte i rrethuar, me çelës. Nesër vij që herët. Kola tha vetë që nesër vonohej. Shikoj edhe filmin

Mbylla dorën dhe u largova me hapa të lehtë e hajdutçe, sikur t'i vidhesha dikujt. Largohesha dhe ktheja kokën prapa si një dezertor. Rrugës nuk isha i qetë.

Në shtëpi nuk më prisnin. Dikush u kishte thënë që atë natë nuk do të veja. S'mbaj mend ç'gënjeshtër thashë e ata s'dyshuan për asgjë. Gjithë atë natë bëra gjumë të trazuar. Shihja në ëndërr koshere që përmbyseshin nga rrëketë e shiut, ose një ari të madh e të zi mu në mes të parkut që shkallmonte zgjojet dhe hante kornizat me mjaltë. Pastaj ariu shndërrohej në Kolë, që më thoshte:

«Përjashta nga parku! Parku është i shtetit, zoti ari. Ti s'je padron, zoti Kolë, usta ari.» Pastaj ariu Kolë nisi të qante për bletën që e kisha vrarë me këpucë. Qante me lot të mëdhenj që pikonin me rrëmbim. Dikur më doli gjumi. Jashtë dëgjohej zhurma e një shiu të vullshëm, nga ato shira që bien në behar pas një thatësire të gjatë. U bëra menjëherë esëll dhe brofa përpjetë. Ja ku kishte dalë fjala e Kolës dhe instinkti i bletëve! Po tani? Sikur të ishte rrëzuar ndonjë zgjua, sikur të kishte ndodhur diçka? Hajde mendje! Ika sikur nuk do të fillonte xhiroja në shëtitore pa mua, sikur nuk do të shfaqej filmi në TV. Një parandjenjë e keqe më ishte qepur e s'më shqitej. Ma ndiente zemra se diçka do kishte ndodhur. Deri në mëngjes nuk më zuri gjumi. E gdhiva me sytë në tavan, duke i vënë veshin shiut, se mos ndoshta pushonte. Ai pushoi pa zbardhur dita.

Në mëngjes u nisa për në park. Rrugës pro-

voja një kureshtje të përzier me shqetësim e një ankth të lehtë. Ishallah nuk ka ndodhur gjë, lutesha me vete. Ec e dëgjo Kolën pastaj. Më mirë të ikje vetë.

U afrova te parku dhe... ngriva në vend. Te muri i barakës pashë Kolën që nxirrte nga brenda disa tavane zgjojesh dhe i vinte me radhë në lëndinë. Ta marrë djalli! Si nuk erdha gjysmë ore më shpejt, të shkretën. Po derën si e kishte hapur? E kishte shkallmuar. Isha aq i tronditur, sa nuk më shkonte mendja se mund të kishte çelësin e dytë. Po tani? Në sekondë u pendova për të gjitha. Kjo s'duhej të më ndodhte. U pa puna; do shkoja të takoja ndihmësit e tjerë. U mundova të mblidhja veten e të ruaja gjakftohtësinë. Ajo që u bë, u bë, nuk kthehej më. Zura ta pleqësoja punën. Gjendja nuk ishte aq alarmante sa ç'e bëja unë. Mund të sajoja diçka, për shembull: u ngrita, lava sytë dhe dola njëherë nëpër pyll. Ky mendim m'u duk shpëtimtar. U përgatita për këtë rol dhe bëra përpara:

— Mirëmëngjesi! — përshëndeta.

— Mirëmëngjesi! — tha Kola. — Hë, ç'kemi?

— Hiç. U ngrita dhe thashë: pse të mos dal njëherë nëpër pyll, derisa të vijë ustai...

— Si ia kalove? — pyeti Kola pa më vështruar në sy, duke shtruar tavane të tjera në lëndinë.

— Mirë, — u përgjigja unë.

— Ra shumë shi?

— Si të të them... ra, — thashë me thjeshtësi dhe u ngazëlleva përbrenda. Sa lehtë po e hante rrenën!

— Kur bie shi, këtu është fresk. Ti ngrive?

— Të them të drejtën, jo. As që ndjeva fare. Pylli të dhënka gjumë...

Tashmë nuk kisha fare emocione. Po e lua-

ja aq bukur rolin, sa edhe vetë habitesha. Kola mbaroi së shtruari tavanet. U ngrit, erdhi drejt meje, m'i qepi sytë nëpër gjyzlykë dhe tha:

— Pse gënjen, or djalë?

Mua m'u duk se më bënë veshët.

— Si?

— Ti s'ke fjetur këtu, — tha ai me ton të rëndë.

U mundova të buzëqeshja. Ndofta ai më provokonte. Erdhi çasti i ndeshjes së nervave; kush do të fitonte, ai apo unë?

— Kam fjetur e ç'të fjetur! — thashë me shaka.

Kola qëndroi, më pa vëngër dhe tha:

— Turp të kesh! Gënjeshtar! Paske fjetur ti... — shfryu. — Pa hajde këtu... — më mori për dore si një fëmijë që e shpien te vendi i fajit që ka bërë, më futi brenda dhe më shpuri drejt e te krevati. Hoqi me rrëmbim batanijet dhe unë pashë dyshekun të bërë pellg nga uji. Padashur ngrita kokën në tavan. Nën katrama ende dukeshin bulëza uji.

— Këtu ke fjetur ti?

Kola i kishte dhënë fund lojës. Duhej që edhe unë t'i jepja fund. Le të flisnim hapur:

— Të admiroj, usta Kolë. Qenke jo vetëm usta bletësh, por edhe usta kurthesh. Kështu ua punove edhe atyre dy të tjerëve?

Kola më pa me përbuzje. Teli i dhëmbëve i shndriti:

— Unë nuk jam i djallëzuar, more djalë, ashtu siç kujton ti. Ti kurthin ia ngrite vetë vetes. Gënjeshtria del në shesh. Turp të kesh. Merr dyshekun e batanijet e hapi të thahen në tavannet që shtrova.

Tha kështu dhe iku pa më thënë se ku shkante.

«Me siguri në drejtori po shkon, thashë me vete. Të më denoncojë.» Mora një nga një bantijet, çarçafët, dyshekun dhe i shtrova të thaheshin. Ja ku u mbyll papritur e pa kujtuar karriera ime e bletërritësit. Pa lavdi e me turp. Mirë të më bëhej; tamam sipas kokës festja. Isha një djalë mamaje, një bukurosh bulevardi, që s'e kishte parë punën, që s'ishte rrahur me jetën, një gjimnazist ende, që pret pushimet e verës që të shkojë kampeve e plazheve. Ndoshta Kola mund të ishte ç'të donte, edhe zët mund të më kishte, sa të mos më shihte dot me sy, po këtu fajin e kisha vetë. E shkela që në rastin më të parë e tani, si i thonë fjalës, ngarko dhe shko!

Zura të mblidhja rrobat e mia, dy-tre libra, i bëra pako e i lidha me një spango si bohçe. Me siguri Kola do ta bënte të madhen në drejtori. Do nxirrte vrer kundër meje e më së fundi do vinte me një copë shënim nga drejtori, ku njof-tohesha se isha i pushuar nga puna.

Lava disa zgjoje e pastaj nisa të shëtitja nëpër park, sikur t'u jepja lamtumirën e fundit bletëve. Zura të pastroja verandat e tyre e ashtu më gjeti Kola.

Nuk dihej sa minuta kishte te kangjellat duke më vështruar ashtu. Sapo e vura re, u shkëput prej tyre dhe hyri brenda. Pas tij shkova dhe unë. Le ta merrja sa më parë vendimin e pushimit e ta lija të qetë atë.

Hyra brenda. Kola po vështronte bohçen time lënë mbi tryezë. — Ç'është kjo? — tha.

— Plaçkat e mia.

— Ç'i ke lidhur?

— Të iki. A s'jam i pushuar? Ti shkove në drejtori. . .

Kola më vështroi gjatë e me ndot:

— Qenke me të vërtetë i lig, more djalë.

I lig e i djallëzuar. Njerëzit i matke me kutin tënd. Lëri budallallëqet e shtroju punës, atë bëj... Dhe mos kujto se të tjerët të kanë inat e të bien më qafë kot, — shtoi ai.

Unë dëgjoja dhe thosha me vete: S'i paska ndezur andej nga drejtoria. E si mund të flakin aq kollaj një teknik të mesëm bletësh!? Vetëm pse këtij xhaxhai i është bërë bezdi të ketë një njeri tjetër në park?

Kur po ndaheshim, Kola më tha:

— Nesër të vish herët.

Unë mbajta këmbët:

— Nesër është e diel, — thashë.

— E di, — tha ai, — po nesër do bëjmë shtesat. Duhet patjetër të jesh. Është në dobinë tënde të shohësh si bëhen shtesat. — Unë s'u përgjigja, por shpejtova hapin. Kur mendova që po më rrezikohej shëtitja e së dielës me shokët, vendosa me vete «Kaq ta bësh dhëmbin, s'të vij, o Kolë. Në qoftë se ti i ke hequr vijë shtëpisë e qytetit e jeton si eremit, mos kujto se edhe të tjerët janë si ti.»

4

Megjithatë, të nesërmen vajta. Gjithë natën e pleqësova me vete e më në fund e gjeta me vend të shkoja. Ishte në interesin tim të shihja si bëheshin shtesat. Vërtet teorikisht e dija, po noti s'mësohej në të thatë. Ndoshta Kola atë donte, që të mos shkoja, që nesër, kur të merrja park vetë e të dështoja, të thoshte: e, a nuk ju thashë unë që s'di gjë ai? U nisa pa dëshirë. Djall zannat edhe ky; të shkoje në punë kur të tjerët pu-

shonin! Mend ma shtrëngonte fytin ngashërimi.

Duke u afruar në park dëgjova tingujt e radios. Kola ishte ngritur e, si zakonisht, merrej me ndonjë zgjua.

— Mirëmëngjesi! — përshëndeta kot, pa pritur të ma kthente. E dija që më parë si do të më përgjigjej: «mbylle derën».

Më vonë e kuptova se ky nuk ishte një «huq» i Kolës, por një masë profesionale, që pothuaj i ishte bërë zakon. Bletët kanë nuhatje të mprehtë e shkojnë atje ku nuhatin mjaltë ose dyllë.

— Mbylle derën, — ma ktheu Kola.

Pasi hëngrëm mëngjes, u morëm me përgatitjen e zgjojeve të shtesave. Kjo punë na hëngri pothuaj tërë paraditen.

Për bletërritësin dita e bërjes së shtesave është një ditë e shënuar, një moment i rëndësishëm, pothuaj një rit.

Në çdo profesion ka çaste kur puna, përveç vullnetit, kërkon edhe frymëzim dhe, s'di se pse njeriut që punon i bie një nur i bukur, që të bën ta duash atë. Këtë e pashë te Kola gjatë bërjes së shtesave... As që mund ta merrja me mend se ai trup rrondokop mund të shndërrohej ashtu e të fitonte një zhdërvjelltësi të tillë. Gishtat e tij të trashë erdhën e u bënë të shkathët e të ndjeshëm për një punë aq të hollë e delikate. Zgjoi gumëzhinte me një zhurmë të qetë. Kola punonte shpejt e saktë si një kirurg. Mbi zgjua fluturonin një mori bletësh. Disa i qëndronin në llërë, të tjerat mbi supet e zhveshura, në qafë e në fytyrë. Kola vazhdonte të punonte pa e prishur gjakun, sikur bashkë të kishin lidhur që më parë një marrëveshje miqësie. Ndonjë bletë ngatërrohej në gjoksin e tij të leshtë, alarmohej e lëshonte një zukatje të mprehtë. Ai

e kapte nga krahu, e hiqte me kujdes dhe e lëshonte në ajër duke thënë:

— Ik, moj budallaçkë!

Unë, me arkë harruar në duar, shihja i mahitur Kolën lakuriq nga mesi e lart, të mbështjellë nga vorbulla e bletëve, e më dukej si një Rodos. Fytyra i ishte skuqur nga një afsh a gaz i brendshëm e buzët mend mërmëritnin një këngë mbarësie a një ninullë. Kur mbaroi, drejtoi trupin dhe lëshoi një psherëtimë të gjatë, sikur vetëm atëherë ta ndiente lodhjen e dy orëve punë përkulur mbi zgjua. U kujtua për mua. Më hodhi një vështrim e m'u bë se sytë e tij lëshonin një dritë dashmirëse. Pata përshtypjen se atë çast ndoshta po matej të më fliste ndonjë fjalë të ngrohtë.

Por ky çast kaloi e ustai im u bë prapë i ftohtë e fjalëpak, si gjithnjë:

— Shpjere në barakë arkën e çlodhu. Njeriu ka nevojë edhe për pushim.

Bëra ashtu si më tha ai, shpura arkën dhe u ktheva në park. Kola ishte ulur nën hije e thithte i qetë cigaren.

Zura të shëtitja ngadalë nëpër rreshtat e zgjojeve. Përkulesha e shihja me vëmendje se si hynin e dilnin bletët nga zgjoi, si ngriheshin në fluturim e si uleshin të ngarkuara me pjalm. Pas pak shkoja te një zgjua tjetër e harrohesha atje. Vështroja bletët tek nuhatnin njëra-tjetrën, dridhnin krahët e lëviznin antenat. Mundohesha të dalloja ato shenjëzat e vogla, gati të padukshme, të cilat përbënin gjuhën e bletëve, atë që Kola e kuptonte aq mirë. Shihja e vetja më dukej krejt i paaftë për të kuptuar kodin e tyre misterioz, më dukej se kurrë nuk do të isha në gjendje të hyja në botën e çuditshme të tyre. Ndieja të dëshpërohesha e më vinte të ngrihesha



e të ikja, të shkoja te Kola e t'i thosha: «Mirë e the ti, unë nuk do të bëhem kurrë bletërritës i vërtetë.» Por një zë i brendshëm më thoshte: «Rri këtu! Bletërritës i vërtetë nuk bëhesh dot brenda një dite, as për një vit. Edhe Kola ka qenë dikur si ti e gjuhën e bletëve nuk e ka mësuar as për një ditë, as për një javë, siç kërkon ta mësosh ti, por gjatë një jete të tërë.»

Atëherë fillonte të më hipte dëshira përsëri dhe shkoja te zgjoi tjetër. E ndieja në kurriz vështrimin e Kolës, që më ndiqte nga larg, e isha kureshtar të dija ç'mendonte. Mbase matej të më përzinte nga parku duke më thënë se shqetësoja bletët.

Nuk di sa zgjoje brodha ashtu. Vetëm dikur dëgjova një zë:

— Hap një nga këto zgjoje.

U ktheva vrulltas: Përpara meje qëndronte Kola, që me dorën e shtrirë më zgjaste levën, ndërsa fytyra gati i buzëqeshte.

5

Kur dita është e mirë dhe kullota e bollshme, bletët janë të urta e paqësore. Ato të lënë të punosh me to e të futësh duart, ndërsa në një ditë tjetër është e rrezikshme ta bësh një gjë të tillë. Këtë zakon kishte marrë prej tyre edhe ustai im: kur dita ishte me diell e punët shkonin mbarë, Kolës i ndriste fytyra, në buzë i shkruhej një buzëqeshje e ai e shkelte «betimin» e tij. Në këto raste mund të fliste dy fjalë më shumë.

— Usta, të të pyes për dicka, por dua të më përgjigjesh drejt: a ia ke parë hairin këtij zanati? — e pyeta në një ditë të tillë.

— Hairin? — pyeti Kola sikur të mos e kuptonte fare këtë fjalë.

— Dua të them, në drejtim të të ardhurave mujore, a...

Kolës i ra një hije e zezë në fytyrë e buzëqeshja iu tret. S'di se ç'inat i hipi, tamam si ditën e parë, kur më pyeti në më pëlqente puna e bletërritësit e unë i thashë që më mirë se në fermë duhej të isha.

Njëherë u mat të mos më përgjigjej, po pastaj ndërroi mendje dhe tha:

— Hairin, the? Edhe ia kam parë, edhe s'ia kam parë. Nuk ia kam parë ndoshta, po të mendosh vështirësitë që ka puna jonë. Ti e sheh vetë, more djalë, gjithnjë vetëm. Më shumë në barakë kam fjetur se në shtëpi. Gjithnjë larg familjes. Por këto s'janë gjë para hairit që kam parë prej tyre. Ato më kanë mbushur jetën me gëzim. Bletët i kam dashur me shpirt, e s'ka kënaqësi më të madhe për njeriun se kur punon në një zanat që e do. Po bletët janë më shumë se zanat e ai njeri që llogarit paratë që do të marrë, më mirë të mos punojë me bletë.

Kola, megjithëse përmbahej, dukej i nxehur. I mëshoi me inat kornizës, e kjo hyri në zgjua me një trokitje të mbytur. Bletët zhurmuan të trembura. Disa prej tyre u ngritën e filluan të vërtiteshin rreth tij. Kola thithi dy herë cigaren për të bërë tym. Tym i duhanit i qetëson bletët.

Njëra, me një piskamë të mprehtë, iu ngjesh me furi në buzën e sipërme e ia nguli thumbin. Unë u rrëqetha dhe rregullova maskën në kokë. E dija ç'do të thoshte të të thumbonte bleta në fytyrë. Kola, i nxehur, e kapi për krahësh e, sikur të shante një njeri që kuptonte, tha me inat:

— Ç'fitove? Plase gjer thumbove. Budallaçkë e djallit!

Ai hoqi me thua thumbin e bardhë mbetur në buzë dhe vazhdonte ta shihte me inat e dhe-mbshuri bletën që pas dy-tri orëve nuk do të jentonte më.

— Pas pak kjo do të ngordhë, usta, — thashë unë pa të keq.

Kola kërceu përpjetë sikur ta kishte pickuar një bletë mu në sy:

— Përrjashta! — bërtiti ai.

— Më fal, usta...

— Të ... të ... djallos! — mbajti gojën ai: — Nuk kuptoj se çfarë ke mësuar në shkollë, more djalë, kur nuk paske mësuar gjënë e parë: respektin e njeriut për bletën. Pleqtë tanë të pashkollë qenë, po kaq gjë dinin të thoshin, xhanëm: bleta vdes e jo ashtu si thua ti. — Usta Kola ishte i nxehur sa i dridheshin gjyzlykët në sy.

— Më fal, usta, unë pa dashje, ashtu... u mundova t'ia zbutja zemërimin Kolës.

Ai më hodhi një vështrim përçmues dhe tha:

— Mos më kërko falje mua, po kësaj, punëtores më të madhe të botës. — Kola më shtriu pëllëmbën e tij të madhe, ku ndodhej ende bleta që e kishte thumbuar.

6

Ditët kalonin e me ne po ndodhte ajo dukuri që quhet përshtatje. Marrëdhëniet tona ngjanin me ato të një mali e një lumi: atje ku lumi është i rrëmbyeshëm, gërryen malin. Atje

ku mali është i fortë, lumi detyrohet të bëjë udhë, të dredhojë. Pak nga pak po i merrja huqet e ustait tim e gjithnjë e më rrallë dëgjohej zëri i tij: «mbylle derën».

Ndoshta nuk mund t'i vihej shumë faj për tipin e tij të heshtur. Puna e bletërritësit ka një natyrë të vetmuar, larg njerëzve, nëpër fusha e pyje. Kola po e ngryste jetën duke punuar me bletë e dalëngadalë heshtja i ishte bërë më shumë se një natyrë e dytë, ishte bërë natyra e tij e vetme dhe e vërtetë. Mos vallë ky profesion, që kërkon qetësi e vetmi, kishte zhvilluar tek ai një lloj bezdie për njerëzit, aq sa prania e tyre e shqetësonte e pothuaj e nervozonte?

Duhej ta njihje mirë Kolën. Ai i ngjante një kamine qymyri që digjet nga brenda e së jashtmi duket e ftohtë. Prapa pamjes së jashtme të tij fshihej një natyrë e ndjeshme e delikate. Kjo vihej re në shkëlqimin e syve të tij, kur vështronte një kornizë plot me mjaltë ose rrafsh me pjellje, kur në verandë zbritnin bletët e ngarkuara plot me pjalm.

— Zanat të mirë ke zgjedhur, usta, — i thashë një ditë, tek e shihja që po vështronte vilet e luleakacieve që kundërmonin erë të mirë.

— Ky zanat mban erë mjaltë.

Kola u kthye nga unë, hoqi syzet, si të don-te të më shihte drejt në sy, dhe tha:

— Jo, o Nasho, çdo punë mban erë mjaltë, çdo punë e mirë. Dije prej meje këtë.

Ecëm nëpër park. Pothuaj të gjitha zgjojet kishin magazina mjalti e ashtu dukeshin si pallelatet e një qyteti në miniaturë.

— Së shpejti do të vjelim mjaltin, o Nasho, — tha Kola me zë të ngrohtë. — Ke parë kur vilet mjalti? S'ka gjë më të bukur, do ta

shohësh vetë. Ti do t'i japësh dorezës së centrifugës e mjalti do të rrjedhë nga sylina. S'ka gjë më të bukur, do ta shohësh ...

Papritur Kola u ndal dhe qëndroi si i ngri-rë, sikur po mendohej. Pastaj foli me zë të ulët, aq sa unë, i larguar disa hapa, mezi e dëgjova:

— Nasho, eja këtu.

Unë e pashë ashtu e mendja më shkoi për keq. U afrova me të shpejtë:

— Ç'ke, usta? — e pyeta duke i futur kra-hun nën sjetull.

— Asgjë, në vesh më ka hyrë një bletë. Merr një fije bari e përpiqu ta nxjerrësh, por mos e tremb...

Bëra siç më tha Kola. Këputa një fije dhe zura ta ngacmoja ngadalë bletën që ishte futur në vesh. Kola s'bënte zë dhe rrinte pa lëvizur, si një fëmijë i bindur.

Më në fund bleta doli. Ustai e lëshoi frymën i lehtësuar.

— Ama, të ngriu gjaku, usta! — buzë-qesha me qesëndi unë. — Shpirti është i dhe-mbshur.

Kola nuk e kuptoi ironinë time.

— Nuk u tremba për vete jo, po për atë budallaçkën. Mund ta ngulte thumbin dhe vdiste.

7

Atëherë kur yjtë kanë kohë që janë shuar e qielli i larë ndritet nga rrezet e diellit të sapo-lindur, Kola del nga baraka, qëndron te pragu dhe ngre kokën lart. Hedh sytë nëpër tërë qiellin e kaltër e një buzagaz i lehtë, sa mezi duket,

i bie në fytyrë. Një ditë e bukur në korrik për bletërritësin është si një shi në maj për bujkun, s'blihet as me flori. Ndaj dhe Kola s'e përmban dot buzëqeshjen, tek sheh qelqin e qiellit të larë nga vesa. Përpara se të hajë mëngjesin, Kola e ka zakon të bëjë një shëtitje nëpër park, si një mjek që inspekton pavijonin e tij. Që kur i është bërë ky zakon, s'dihet. Unë ia mësova kur nisa të vija edhe vetë herët në park, duke hequr dorë nga ajo «ora shtatë» zyrtare.

Bëj të lëviz vendit e të ngrihem për ta shoqëruar, por Kola nxiton të më thotë:

— Rri, rri. Është herët. E ç'do të bësh kaq shpejt? Unë po dal sa për të parë njëherë.

Thotë kështu, por unë e kuptoj. Ai s'ka qejf të më shohë ndenjtur, jo se është shpirtlig, por sepse do që unë të bëhem punëtor. E punëtor është ai që diellin e pret në këmbë e s'e mban vendi. Kështu thotë Kola.

Ai niset përpara duke hequr zvarrë këpucët e palidhura, e unë, pasi puthit derën, e ndjek pas. Ai ecën përgjatë rreshtave të zgjojeve, vështron me vëmendje, vë vesh. Diku ndalon, heq ndonjë fije bari o ndonjë bletë të vdekur nga veranda dhe bën më tej. Diku përkulet, heq çatinë, bie në gjunjë dhe ngjit veshin pas tavanit të zgjoit. Dëgjon me vëmendje si një mjek në kurriz të të sëmurit. Pastaj i vë me kujdes çatinë. Ndonjëherë, e kjo ndodh kur Kola e mban më gjatë se *zakonisht* veshin mbi dërrasë dhe vrenjt *vetullat*, ai jep recetën: — E dobët. Vëri një vazo sherbet, Nasho.

Kjo shëtitje zgjat rreth gjysmë ore. Gjatë saj Kola e ka zakon të mos flasë. Ndaj unë e lë të qetë. Pasi shikon edhe rreshtin e fundit, ai kthehet në barakë, thua se më ka harruar mua që e ndjek pas.

Ustai im shtyn deriçkën dhe hyn brenda. Këpucët e pantallonat na janë bërë qull nga vesa e mëngjesit. Shtrohemi e hamë në heshtje, shpesh në të njëjtin tigan a pjatë. Mëngjesi ynë zakonisht përbëhet nga vezët e skuqura, sallami e perimet. Kola merr fetat e bukës e prej tyre veçon tulin. Koret i ha unë «që kam dhëmbë». Ndonjëherë më kujtohet se sa të fyer e ndjeva veten në fillim, kur Kola më tha të haja koret e tij, dhe më qeshet.

Pasi mbarojmë mëngjesin, ustai merr «qitapin» e tij të shënimeve, ndërsa unë, kjo ndodh rrallë, ndez tymësen. Në fillim habitesha e dridhsha kur shihja Kolën pa maskë, në kanotierë, aq sa mend arrija në një bindje supersticioze. Dalëngadalë frika më doli edhe mua. Më parë guxova të hiqja këmishën, pastaj maskën, e tani edhe kanotierën. Edhe unë kam zënë diç të kuptoj nga ato një mijë shenjizat e padukshme të gjuhës së bletëve e diçka mund të them ende pa e hapur tavanin e zgjoit.

Kola fut levën afër qoshes dhe ngre ngadalë tavanin. Ndodh që ky lëshon një kris-më të thatë e ai vrenjtet në fytyrë. Kjo do të thotë që ai zgjua është i dobët. Heq tavanin dhe e mbështet para verandës. Pastaj sheh mendueshëm bletën me miza të pakta e pëshpërit pothuaj me vete:

— Po pse, moj e uruar, pse, moj e uruar...

Monologu nuk dëgjohet më, por me siguri vazhdon në heshtje. Ndodh edhe që leva mezi shkëput tavanin e ngjitur nga propolisi që tërhiqet me fije të gjata si zamkë. Usta Kola e lëshon poshtë dhe vështron me zemrën mal bletën që ka mbushur zgjuan mizëri:

— Eh, të qofsha falë, moj bijë, të qofsha

falë, moj e mbarë. Plot e rrafsh! — pëshpërit.

Atëherë unë e kam të vështirë të dalloj, ndritin syzet apo sytë e Kolës. Nuk ka gjë më të bukur sesa të shohësh ustanë tim atë çast. Fytyra i rrezëllin, një hare e mbështjell të tërin e unë gati sa s'pandeh që ai do të shtrijë dorën mbi zgjua e do të përkëdhelë bletët që lëvizin ngadalë, që thurin hoje e bëjnë mjaltë. Rri pothuaj i harruar për çaste të tëra dhe vartet sikur ia fryn filladi i lehtë e i lë pak, shumë pak. Atëherë Kola, ky burrë i heshtur, ka qejf të bëjë shaka si një ari babaxhan e zemërmirë:

— E, mo Nasho, si të duket? Jo keq, hë?  
*Jo keq, Ka edhe më mirë.*

Tani buzëqesh edhe unë. Më ngjitet shendi i ustait, por më shumë më kënaq zgjoi i mbarë. Atëherë gjej rastin e rrallë e i bëj Kolës një lutje:

— Më lër ta kontrolloj unë këtë, usta.

Këtu Kola zihet ngushtë, s'di ç'të bëjë. Shtrëngon instinktivisht levën, sikur do t'ia rrëmbej me zor, dhe më vëren përmes syzeve. Jo çdo herë mund t'ia bësh një kërkesë të tillë usta Kolës. Pastaj ma zgjat levën në mëdyshje, sa thua se nga çasti në çast do ta tërheqë prapë mendjekthyer dhe thotë:

— Vetëm me mend, ngadalë. Bleta do shumë marifet. Është njësoj si vajza: pak më shumë ngutje e, në vend të puthjes, mund të marrësh prej saj një shuplakë.

Thotë kështu dhe skuqet, sikur ka thënë ndonjë turp. Dhe mua më shkon nëpër mend një mendim: Kur ka qenë i ri, ka qenë jo vetëm i bukur, por edhe çapkën ustai im.



— Nuk ka në botë zanat më të bukur se ky yni, Nasho, — tha Kola. — Ja, shiko: Kjo bletëz e vogël ka thurur tërë këto hoje, që as njeriu më i zot nuk e bën dot. Pastaj e ka mbushur me gjënë më të mirë që gjendet mbi këtë dhe: me nektarin e luleve.

— Me shpirtin e luleve, — thashë unë, duke kujtuar leksionet e shkollës.

— Po, — pranoi Kola pa i hyrë thellë metaforës. — Dëgjo, Nasho: Rrëfejnë se njëherë një profesor a shkencëtar i madh i bletëve aq u lidh me to, sa s'pati mend as të martohej, i varfri. Binte e ngrihej me bletët, thuajse për bletët rronte. Një ditë një bletë e thumboi drejt e në sy. U shtrua në spital shkencëtari, syrin e kishte keq. Dhanë e morën doktorët, por syrin s'ia shpëtuan që s'ia shpëtuan dot, iu verbua, të shkretit. Po, kur vjen e keqja, hapi dërrën: më t'iu infektua edhe syri tjetër e s'vaji shumë e iu prish edhe ai. Mbeti i verbër profesor, aq sa e hiqnin për dore. U ndodh një mendjefyckë dhe e pyeti një ditë: «Sikur të të kthehej drita e syve, me se do të merreshe?» Dhe a e di, o Nasho, se si iu përgjigj plaku? «Me bletë, i tha, or djalë!» Ja çfarë magjie të fortë ka zanati ynë. E ti më pyete një ditë a më ka zënë mirë rroga...

Kola ndërpreu tregimin dhe vështroi nga dera e parkut. U ktheva edhe unë andej. Te dera qëndronte një vajzë me fustan të kaltër.

— Oj, paska ardhur ime bijë! — tha Kola e m'u drejtua mua: — Merre arkën, Nasho. Kaq qe kështu për sot.

Dolëm të dy nga parku, unë me arkën në

Nga kthina u dëgjua zëri i Kolës që po lante duart:

— Nasho, s'do të hamë librat për drekë, — e duke hyrë brenda me peshqir në dorë, tha: — E po, na e zuri derën kjo, s'kemi ç'bëjmë. Do të shtojmë forcën sot.

U deshën vetëm pak minuta që Vala ta ndiente veten si në shtëpinë e saj. Pasi mësoi se ku gjendeshin ushqimet e enët, pas njëzet minutash na ftoi në tryezë. Kola preu tulin e bukës e tha me shaka:

— Në shtëpi i ha Vala koret, këtu i ha ti. Ndajini të dy.

Mua, s'di se pse, më erdhi mirë nga kjo.

Vala u skuq e turpëruar.

— Ama, si bëhesh dhe ti... Unë i ha se të kam baba. Ç'taksirat kanë të tjerët...

Pasi hëngrëm drekë, Kola e Vala u bënë gati për të dalë:

— Usta, më lër të rri sonte këtu, — iu luta.

Kola më vështroi me një palë sy të çuditshëm, si të donte të pikaste diçka.

— Jo, s'ka nevojë. S'ka asnjë rrezik. Unë që rri, rri se dua vetë, — tha.

— Edhe unë se kam qejf dua të rri, — thashë.

Ustait i shndriti teli i dhëmbëve bashkë me buzëqeshjen: — Rri, — tha, — çarçafë të larë ka mbi raft.

I përçolla deri larg. Vala më shtrëngoi dorën dhe unë i shoqërova me sy derisa humbën.

Po ç'që ajo rreze e kaltër drite që shkëlqeu për një çast si vetëtimë e si vetëtima u zhduk? Për shumë kohë mbeta atje i palëvizur e i harruar. Pastaj, pasi erdha në vete, u ktheva me hap të ngadalshëm. Dëgjoja vetëm hapat e mi e cicërimat e zogjve. Më pushtoi ndjenja e një vetmie të madhe dhe m'u duk vetja si një Robinson. Rreksha të kuptoja prej nga më vinte ajo ndjenjë vetmie: ngaqë mbeta vetëm në park, apo nga tretja në gjelbërimin e pyllit e atij fustanit të kaltër. S'dija ç'të thosha.

Hyra në barakë dhe zura të shfletoja ditarin e parkut. Nuk lexova asgjë. E mbylla dhe e hodha mbi krevat. Pastaj u ngrita e u solla kot nëpër dhomë. Nuk më rrihej brenda.

Dola jashtë e u futa në pyll. Ende bënte vapë dhe në pyll më mbështolli freskia e tij. Ecja e shihja nëpër fletë copëtimin e diellit.

Në pyll njeriu i vetmuar provon dy ndjenja të kundërta: e para është ajo që ai gjendet në mes të cicërimave e zhurmës së pyllit, dhe e dyta është ajo e qetësisë dhe e vetmisë së tij. Ecja dhe i vija veshin këngës së verdhashëve e bilbilave, çjerrjes së grifshave e laraskave dhe zhuzhurimës së vazhdueshme të bletëve, që ende s'e kishin lënë punën.

Befas kërceva mënjanë i trembur, me gjak të piksur: nga një gëmushë, mu te këmbët e mia, u ngritën me një potere të madhe e me britma çjerrëse disa shpendë të kuq midis pëllumbit e këndesit. Ishin fazanë. Ata nuk u ngritën përnjëherë si të gjithë zogjtë, por me rrahje të forta krahësh e me piskama të mprehta aq sa të trembnin.

I ndoqa me sy shpendët derisa u larguan e bashkë me ta m'u largua edhe dëshira për të shëtitur pyllin. U ktheva në park.

Gjithë mbrëmjes u mora me përgatitjen e darkës. Nuk nxitohesha. Krejt natën e kisha përpara. Radioja ishte i vetmi shok në qetësinë e natës.

Pasi hëngra darkë, u shtriva të flija, por gjumi s'më merrte. Isha çuditërisht esëll. Nga dritarja ndriste hëna e ngritur mbi pyll në një qiell të kthjellët vere. Ajo vishte trajtat e pemëve me pjalin e verdhë të dritës së saj. Hapa dritaren e brenda hyri fresku i mbrëmjes. As vetë s'mund të thosha dot pse nuk kisha gjumë: sepse nata ishte e bardhë e plot dritë, apo sepse ishte hera e parë që po flija i vetëm në një pyll.

Heshtja e natës së pyllit më shqetësonte disi. Tejlarg dëgjoheshin këngët monotone të gjinkallave. M'u kujtuan vitet e fëmijërisë dhe qesha me vete: sa net kisha bredhur kot nëpër prozhme, bahçe e jonxha duke rendur pas tyre sepse i pandehja zogj!

Brenda në barakë binte erë e mirë pishe, luleakacësh e mjalti. Zgjata dorën dhe zura të lëvizja stacionet e radios. Diku dallova tingujt e njohur të një muzike që më pëlqente shumë. Ishte kënga e Solvegut nga «Per Gynt» e Grigut. E lashë atje e rregullova volumin. Dëgjoja në heshtje. Nga jashtë vazhdonte të futej një fashë drite e bardhë. Më dukej sikur Grigu pikërisht për një natë si kjo e kishte kompozuar atë pjesë. Rrija e dëgjoja. Kurrë nuk mund ta mendoja që Grigun do ta dëgjoja në një natë vere me hënë, i vetmuar në një pyll.

Muzika mbaroi e unë s'mund të shkëpu-

tesha nga efekti i saj. Gjumi nuk ekzistonte më. Mendoja e mendoja, derisa ndjeva të më akulloheshin supet.

10

Nuk mbaj mend në jetën time të jem ngritur nga gjumi në një mëngjes aq të bukur, pas një gjumi aq të mirë. Gjithë zogjtë e pyllit këndonin në kor këngët e tyre për mua. Një mëngjes i kthjellët me ajër të freskët më ftonte të vrapoja në lëndinën e lagur nga vesa. U ngrita dhe dola jashtë. Ajri i pastër e i ftohtë më mbështolli si të isha kredhur në vorbullën e një lumi të kulluar.

Nuk di ç'më vlonte në shpirt e sa fuqi ndjeva në krahët e mi. Më vinte ta futja në mushkëri gjithë ajrin e pyllit. Mora shishet e kovën dhe, duke zbritur në çezmë, mendova shumë ndryshe nga dita e parë.

Pasi u lava, u ngjita në të përpjetën e rrugicës që dredhonte përroit. Nga larg, te gardhi prej kangjellash i parkut, pashë një njeri që mbante nga timoni një biçikletë dhe vështronte zgjojet. U afrova dhe vura re një burrë rreth të dyzetepesave, shtatshkurtër, me një kasketë në kokë, streha e së cilës bënte hije mbi fytyrën e tij të zeshkët. Mbi skarën e biçikletës kishte një thes gunga-gunga nga sendet brenda. U mata të hyja brenda në barakë duke bërë sikur s'e kisha parë, por më ndali zëri i tij:

— Mirmëngjesi, usta! — më përshëndeti ai.

— Mirmëngjesi! — thashë.

— Ç'thonë? — pyeti zeshkani dhe bëri me kokë nga parku.

— Ç'të thonë, kullotin, — u përgjigja duke u matur të hyja brenda.

— A të vij të ndez një cigare, usta? Pas kam harruar shkrepësen, — dhe, pa pritur që ta ftoja, ai mbështeti biçikletën të kangjellat e vra-poi brenda. Qëndroi te pragu, i hodhi një sy dhomës, nuhati me zhurmë.

— Ç'erë të mirë që mbaka këtu, — tha.

U ul në krevat dhe vazhdoi:

— Zanat të mirë keni, jo shaka, ju bletërritësit. Në mes të të mirave jeni; mjaltë sa të duash, sheqer me kuintalë.

— Po ti ç'punë bën, or shok? — e pyeta.

— Ah, — psherëtiu miku, — punën time ta marrë lumi. Kallajxhi jam, ç'e djallos. Hë, thuaj ti, hahet kallaji? Ja, e tillë punë është.

— Për ku kështu që në mëngjes?

Miku hodhi një mbi një këmbët e shkurtra e topolake dhe tha:

— Më thërresin Braçe. Thashë të dal njëherë këtej nga këto fshatrat, meqë kisha ca ditë pushim, po është bela e madhe...

— E pse bela? — bëra unë. — Ti për ndërmarrjen punon.

Tjetri u zgërdhi. Sytë e vegjël e të zinj si të ketrit shkëlqyen me djallëzi:

— Ç'për ndërmarrjen, o derëbardhë. Kisha nja tri ditë raport e thashë mos bëj ndonjë punë këtej.

— Private, — thashë unë.

— E po ç'ti bësh. Kaurdisemi, si i thonë fjalës.

— Po nga se vuan kështu ti, Braçe?

— Unë? — u habit e u frikësua Braçja duke prekur barkun me duart e tij topolake.

— Nga asgjë s'vuaj. Top fare jam.

— Po raporti?

Braçja qeshi me të madhe:

— Aha, raporti. Kam një mik, është mjek ai. Mik tamam s'e kam, po ja, i bëj ndonjë shërbim të vogël e ai më këput ndonjë triditësh. Se mos i kushton gjë atij. Një firmë e hajt tutje Braçja. E mira me të mirë lahet në këtë botë. Ja, për shembull, ti më jep një lugë mjaltë sot. E po Braçja ka aq mend sa të mos e harrojë të mirën. Do të të kallajisë ndonjë gjë ai, ndonjë tenxhere a gjym, s'ta lë borxh, jo!

Unë qesha:

— Braçe, ma ngule një kunj të bukur, — thashë unë dhe e pyeta: — Si e do, me pjatë apo me bidon?

Braçja u mendua një çast. Në ballë i shkrepiti një mendim e sytë i shndritën sikur të thoshte: pse, gënjehet Braçja me një lugë?

— E ç'ta ndotësh pjatën, o derëzi. Apo s'e paski edhe ujin larg. Ja, po marr nja dy-tri lugë në bidon, sa për urim.

Në fund të barakës kishim një bidon alumini me mjaltë. E ngrita me vështirësi dhe ia vura përpara mikut tim. Braçja hodhi sytë në bidon, ku shndriste me një shkëlqim të qetë të qelibartë mjalti. Ai kroi kokën nën kasketë dhe tha:

— Në mëngjes të bie si rëndë ky i uruar. Sikur të ma hidhje në një vazo atë që do haja. Ja, po shkoj vrap ta marr... — Braçja bëri të ngrihej, por u ul prapë i ndalur prej zërit tim:

— Aa, Braçe. Këtu e prishe.

U ul. Kishte rrezik të mbetej fare pa gjë. Mori me të shpejtë lugën dhe tha:

— Hajde gëzuar e mot më shumë, usta!  
— uroi ai dhe zhyti lugën në mjaltë.

Filloi të hante me lugë të mëdha. Pas çdo luge pëshpëriste:

— Ilaç është i uruari, s'ke ç'i thua.

Fijet e mjaltit rridhnin nga luga në mjekrën e kallajxhiut e prej andej mbi këmishën e lerosur.

— Ky është zanat. Mjaltin e ke, sheqerin e ke.

— Qumështin e ke, — vazhdova numërimin unë.

— Pse, edhe qumësht? — u mahnit Braçja.

— Posi, i ushqejmë bletët.

Ai më pa me admirim:

— Pse s'thënke ti që edhe përsheshin jua siguroka shteti.

— Bletëve, jo neve, Braçe, — bëra një saktësim të vockël unë.

— Ee, bletëve, merret vesh. Po edhe ti, po hëngre ndonjë përshesh, nuk bëhet kiameti de.

— Bile kemi edhe tetraciklina që kurojmë bletët, pimë sa të duam, — thashë unë.

Braçja uli lugën ngadalë. Admirimi i tij po shkante në veneracion:

— Po ti i thënke sëmundjes hajde! Edhe ilaçet i paske pa para, — ndenji disa çaste i menduar. Mjalti po e nxiste me ide të reja. — Usta, a ke ndonjë vend për ndihmës a për rojtar? Mos ki gajle, e lë zanatin unë. Fundja pas pune prapë merrem ndopak edhe me të...

Braçja ndërpreu fjalët. Ngjeshi lugën në bidon dhe filloi me frymëzim të ri. Pas çdo luge, vrulli, kundër dëshirës së tij, zuri të binte. Nisi të gëlltitej me vështirësi e në një pushim midis lugëve tha:

— Ore, se mos të bie rëndë ky i uruar?  
— U mendua një hop e u përgjigj po vetë: —



Ç'them edhe unë! Kur vuan nga stomaku, doktori «ha mjaltë», të thotë. — Ishte një argument aq bindës, sa Braçja gjeti forca në vetvete për një sulm të ri kundër bidonit.

Një copë herë ai s'foli. Bile edhe mbllaçitja e tij s'po ndihej. Unë ktheva kokën nga ai dhe pashë sytë e fikur, që vështronin gjithë frikë. Nga mjekra e kallajisur vazhdonin t'i vareshin fijet e mjaltit si jargë të gjata.

— Ç'ke, Braçe? — e pyeta i trembur.

— Ujë, — tha me zë të mekur ai.

Menjëherë e kuptova. S'ka ushqim më të rëndë se mjalti, kur teprohet me të. U mata të rrëmbeja një nga shishet e sapombushura, por ndërrova mendje menjëherë: edhe një ujë duhej, që stomaku i mikut tim të pëlciste.

— Ujë! — pëshpëriti ai me zë të përvajshëm.

— S'ka, — i thashë.

— Ujë se plasa! — klithi ai. — Ti tani sapo mbushe.

Atëherë m'u desh t'i shpjegoja si qëndronte puna. Braçja rënkonte sa të këpuste shpirtin e më dëgjonte duke më parë me sytë e pikëlluar që i puliste me siklet. Pastaj, me një hov të papritur u sul përjashta e ia dha të vjellit. Unë renda pas tij. Ia mora kokën ndër duar dhe e nxitja:

— Vill, Braçe, vill!

Ai dihaste:

— Oh, oh, i mjeri unë. Më qafë më paç, usta. Oh.

Frika më kishte hyrë në palcë. Fytyra e Braçes zverdhte si prej meiti, syri i ishte prerë e trupi i ishte lëshuar. Po sikur të vdiste atje? Vrapova brenda, mora kovën me ujë e ia hodha turirit, ashtu siç ua hedhin makinave kur i laj-

në. E shkopsita dhe fillova ta ajrosja e t'i bëja gjimnastikë. Braçja sikur u përmend. Hapi sytë e perënduar dhe belbëzoi:

— Më qafë më paç, usta! Amanet fëmijët.

— Braçe, mblidhe veten. Nuk vdes burri kaq kollaj, — i dhashë zemër më shumë vetes se Braçes.

Zura ta freskoja e ta fërkoja, sa duart m'u mpinë. Mbi ballin e Braçes më në fund bulëzoi një djersë e ftohtë, lehtësuese: E hodhi, mendova me ngazëllim. E pyeta në mund të ngrihej e, kur ai tundi kokën e rënduar në shenjë pohimi, e kapa nga sjetullat dhe e ngrita lart. Me hapa si prej të dehuri ai u afrua të biçikleta, e nxori në rrugë dhe e shaloi:

— Mbeç me shëndet, usta! — tha ai.

— Udha mbarë e duku prapë! — i thirra.

Kallajxhiu u kthye nga unë, më pa me frikë dhe tha:

— Unë të shkel më aty me këtë që pësova...

Qesha.

Ai i mëshoi pedalit dhe u nis

— Ej! — i thirra, pasi u kujtova edhe për diçka. — Harrove të ndezësh cigaren.

Braçja ktheu kokën e mend ra nga biçikleta:

— Ç'cigare, unë s'e pi duhanin, — foli me zë të mekur.

Erdhi edhe dita kur do të vilnim mjaltin. Atë mëngjes fytyra, zëri e sytë e Kolës seç ki-

shin një ndriçim të ri që s'ia kisha parë herë tjetër. Kishte edhe një turbullim të lehtë si të një nxënësi të përgatitur mirë që shkon në provim e që, megjithëse e di ç'notë do të marrë, prapëseprapë e ka një shqetësim.

Kola hapte magazinat e zgjojeve, ngrinte ngadalë kornizat e bardha nga dylli i ri e më dy-tri lëvizje të shpejta, të prera e të fuqishme, shkundte mbi zgjua bletët që punonin në kornizë. Ato që mbeteshin, i fshinte me një pendë të madhe gjeldeti. Më pas ishte radha ime të tregohesha i shkathët. Hapja shpejt arkën, futja kornizën dhe e mbyllja menjëherë kapakun. Kur arka mbushej plot, e shpija në barakë dhe e sillja bosh. Arka më lodhi, se mjalti rëndon shumë, por s'e bëja veten. S'më kishte hije të ankohesha e të dorëzohesha në çastin kur kurorëzohet gjithë puna e bletërritësit.

Kthehesha dhe shihja Kolën që tymoste duhan pranë ndonjë zgjoi, duke e kundruar. Afroheshja çaplehtë dhe dëgjoja mërmëritjen me zë të ulët të ustait tim:

— E mbarë, e mbarë. Qofsh e uruar, moj bijë. Plot e rrafsh!

Pasi më ndiente, merrte pamjen e tij të ftohtë dhe më thoshte:

— Pa shikoje njëherë këtë, Nasho. Si të duket, hë?

Afrohesha dhe shikoja zgjuan e hapur. Në të dukeshin kornizat e trashura nga hojet e mjaltit sa mend bashkoheshin dhe më vinte të pëshpëritja edhe unë si Kola: «E mbarë...»

Gjithë përgatitjet për centrifugim i bëri vetë Kola. Lau me ujë e sodë tavat, sitat, thikat e gjata, centrifugën e pirunët e mjaltit me kujdesin e merakun e një amvise nikoqire që s'ka besim t'ia lërë nuses punët e kuzhinës.

Mjalti centrifugohet vetëm në mbarim të ditës, pasi të ketë mbaruar fluturimi i bletëve.

Kur dielli u ul mbi majat e akacieve e dita u thye, filluam centrifugimin. Kola priste me thikë kapakët e dyllit, unë rrotulloja dorezën e centrifugës. Currili i mjaltit, i verdhë e i ku-luar si qelibari, rridhte në tenxheren e ma-dhe. Punonim në heshtje. Dikur u mata të hap-ja radion, por Kola më ndaloi:

— E ç'e hap atë? Ka muzikë më të mirë se kjo e centrifugës që rrjedh mjaltë?

Unë i dhashë të drejtë ustait tim. I vija ve-shin kërkëllimës së centrifugës e, megjithëse mjalti rridhte pa zhurmë, më bëhej sikur nga ai buronte një muzikë e bukur, që jo çdo vesh mund ta dëgjonte. Më bëhej sikur nga ai vinte zhuzhërima e qindra mijëra bletëve, fërgëllima e miliona luleve, kënga e duarve të Kolës dhe e të miave.

— Nuk ka në botë zanat më të mirë se ky yni, o Nasho, — thoshte Kola herë pas here.

Unë i përgjigjesha:

— Zanati ynë mban erë mjaltë.

Dhe Kola thoshte përsëri:

— Të gjitha zanatet e mira mbajnë erë mjaltë.

Pastaj, si të kujtohej për një gjë fare të thjeshtë, më thoshte: — Ha mjaltë, Nasho, mos të të vijë rëndë. Unë vetë nuk e ha. Sesi më duket, sikur i vjedh bletët.

E shihja drejt në sy.

— Edhe mua sesi më vjen, — thosha, — sikur më dhimbset mjalti. Për një lugë mjaltë ato shëtitin mijëra lule...

Kolës i ndritnin xhamat e syzeve e psherë-tinte thellë i kënaqur.

Pas shumë çastesh heshtjeje, ai tha si i harruar:

— Ti, Nasho, do të bëhesh bletërritës i mirë, se je edhe djalë i mirë. Në fillim m'u duke zevzek, — tha ai, që kurrë nuk lëvdonte njeri.

Pastaj, krejt papritur, pyeti:

— A ke ndonjë vajzë ti, Nasho?

Unë u habita dhe mbajta për një çast dorezën. Biseda të tilla nuk kishim bërë kurrë me Kolën. Madje as për punën s'kishim biseduar gjerë e gjatë. Kola e kuptoi që e kishte kaluar ca dhe shpejtoi të shpjegohej:

— Jo, unë kot ashtu, mos ma merr për keq. Nga dëshira... Kam qejf që në krah të kesh një vajzë të mirë. Ti je goxha djalë.

Zëri i Kolës ishte i ngrohtë, i dashur, i sinqertë. Mua në sy më shfaqej një vajzë, në pyll, si rreze e kaltër e gati sa s'i thosha: «Valën tënde dua të kem përkrah, usta!»

## 12

Puna e bletërritësit më në fund ka edhe të bukurën e njëkohësisht të vështirën e saj: shtegtimin.

Bleta është lidhur ngushtë me lulëzimin. Bimët rriten në vende të ndryshme e lulëzojnë në kohë të ndryshme. Për këtë arsye bletërritësit nuk i zënë këmbët dhë e s'hedh rrënjë asgjekundi. Është në lëvizje të përhershme, është një nomad.

Në fillim habitesha për numrin jashtëzakonisht të madh të njohurive të Kolës. Dalëngadalë e kuptova që këto njohuri e kishin fillin te shtegtimet e një jete të tërë.

Më në fund edhe lulëzimi i pyllit tonë mbaroi. Ku vajti gjithë ajo bardhësi e vileve të akacieve e luleshqerrave? Në degë dukeshin luleakaciet e thata e poshtë bari i zhuritur nga vapa. Era që frynte lëshonte një shushurimë të thatë e të trishtë, sikur ishte pëshpërma e pyllit që thoshte: Asgjë s'kurseva për ju. Ç'kisha më të mirë e më të ëmbël, jua dhashë.

Për shtegtimin e nisëm punën disa ditë përpara. Hoqëm kornizat e mjaltit nga kosheret. Prej tronditjeve gjatë udhëtimit hojet e reja këputen. Mbërthyem edhe tavanet e dyshemetë e zgjojeve. Punoja me mendje të ngritur dhe provoja atë ndjenjë që provojnë ata që transferohen. Një ditë shkuaam te vendi i ri në mes të një pylli gështenjash dhe ngritëm barakën.

Ditën e fundit Kola s'erdhi në punë. Shkoi të merrte makinë, ndërsa unë u mora me prerjen e telit-sitë në copa të vogla, me të cilat zihen dyert e zgjojeve gjatë shtegtimimit.

Ai erdhi me gjithë makinë aty në të perënduar të diellit. Punëtorët e ngarkimit zbritën nga makina biçikletat që kishin marrë me vete për t'u kthyer dhe zunë të grumbullonin çatitë që hiqnim ne.

Gjatë verës një pjesë e bletëve rrinë jashtë në veranda e me dridhjen e krahëve freskojnë zgjoin deri afër mesnatës. Këto bletë bletërritësi i detyron të futen brenda me tym.

Ndeza tymësen dhe filluam nga puna. Unë tymosja bletët, Kola ngjishte me levë rrjetat e telit në dyert e zgjojeve. Veç ta shihje Kolën. Nuk e mbyllte zgjoin pa hyrë edhe bleta e fundit brenda. Për ndonjë që fluturonte e trembur e s'kthehej, Kola thoshte me inat:

— E po, s'kam ç'të të bëj. Të dola borxhit. Më qafë paç veten!

Nisëm të ngarkonim zgjojet. Punëtorët e veshur me maska e doreza na i sillnin deri te karrocëria. Kola dhe unë i vendosnim në të. Në qetësinë e natës dëgjohej vetëm zëri i Kolës:

— Kujdes, me ngadalë, lëshoje. Mos e përplas, mos e lësho si gur. Është bletë kjo, s'është derr në thes. Ik, ik. Më mirë ta bëj vetë!

Punëtorët mbase rrudhnin buzët në errësirë dhe thoshin me vete: «Ç'plak grindavec ky Kola!»

Kur mbaruam, u thamë natën e mirë punëtorëve, hipëm në makinë e u nisëm. Kola ishte i tëri i shqetësuar. Ndezi një cigare e i dha edhe shoferit një. Rruga e pyllit ishte gjithë gropa dhe e pashtuar, ashtu siç janë zakonisht ato. Makina zuri të lëkundej, aq sa Kola i kapi kra-hun shoferit:

— Të bëj rixha, të kam mik, të kam vëlla, vetëm jepi më ngadalë. Na trondite bletët, na more më qafë. S'bëhet kiameti të vemi një orë me vonesë. Ty të kushton një orë gjumë, neve na kushton sa s'ta pret mendja.

Zëri i tij ishte gati përgjërues, aq sa shoferi, një ezmer i shëndoshë sa gati i bënin faqet puf, i hodhi një vështrim e i tha:

— Mos ki frikë, xhaxha. S'janë qelqe të thyhen, as dinamit.

Po Kola as që e pati mendjen ç'tha shoferi. Ai ishte tërë sy e veshë e pothuaj ishte ngjeshur te xhami i makinës:

— Kujdes, përpara ke një gropë, merre në mes.

Makina shungullonte në qetësinë e natës e dritat e saj çanin errësirën e pyllit si dy projektorë kinemaje.

Dolëm nga pylli e hymë në rrugën automobilistike. Kaluam nëpër qytetin e heshtur që flinte. E lamë pas atë dhe vazhduam rrugën. Makina në asfalt ecte me shpejtësi dhe unë vija re plepat nga të dyja anët e rrugës së gjerë e të drejtë, që vraponin drejt nesh e pastaj hapeshin. Dikur edhe ata filluan të zbeheshin përpara syve të mi e më pas s'i pashë më. Më mbështolli dremitja.

U përmenda nga lëkundjet e makinës dhe hapa sytë. Kishim lënë rrugën e asfaltuar, po ngjiteshim në një rrugë malore në mes të një pylli gështenjash.

— Fli, Nasho, fli. S'kemi arritur, — më pëshpëriti Kola.

U shtrijta dhe i vura veshin bisedës. Ustai im nuk reshtte së foluri. Sapo mbaronte një bisedë, ia niste tjetrës, sikur ta kishte bërë gati që më parë. E për çfarë nuk fliste ai: që nga vera që po bënte e thatë atë vit e deri te disa lloje hapesh të mira për reumatizëm. U habita me të, por shpejt e kuptova. Ai e mbante me muhabet shoferin që të mos e zinte gjumi mbi timon. Papritur i zuri krahun shoferit dhe tha:

— Mbaje. M'u bë se dëgjova një zhurmë.

— Zunë të të bëjnë veshët, xhaxha. U plaqe, — tha shoferi me shpoti duke ndaluar makinën.

Ne zbritëm. Kola përpara, unë pas tij. Freskia e natës më ra në fytyrë e më largoi përgjumjen. Kola kishte ecur përpara, sa shquhej vetëm silueta e tij. U përkul diku dhe thirri:

— Nasho, shpejt një çarçaf! Ka rënë shtatëdhjetekatra.

Unë vrapova për te Kola, por ky ma priti ashpër:



— Çarçaf, të thashë. Ç'më vjen me duar në b...

Vrapova në kabinë, mora një çarçaf e sakaq u ktheva.

— Largohu! Do të të thumbojnë, — më urdhëroi ai.

Gjithandej fluturonin qorrthi bletët e zgjoit të rrëzuar. Disa bletë m'u qepën e nja dy më thumbuan. U largova siç më tha Kola dhe vështroja së largu ç'po bënte ai. Sapo u afrua, menjëherë u mbështoll nga një re bletësh që e sulmonin. Kola mbuloi me duar sytë. Pastaj, duke marrë në sy rrezikun, hoqi duart, e la veten krejt të pambrojtur ndaj sulmit të bletëve dhe u përkul i vendosur mbi zgjuar.

Atëherë ai burrë plak, s'di se pse, m'u duk i madh e i fuqishëm si një titan. Me lëvizje të shpejta e të vendosura vuri zgjoin mbi dyshtemenë e tij hedhur tej, rregulloi disi kornizat e shkoqura dhe mbi to vuri tavanin. Pastaj shpalozi çarçafin, mbështolli me të zgjoin, e rrëmbëu në krahë e u sul drejt makinës, sikur shpëtonte nga flakët një foshnjë. Me vështirësi, duke gulçar rëndë, e ngjiti sipër, hipi edhe vetë dhe thirri:

— Nisuni!

Unë shkova ta shihja e ta pyesja si ishte; por ai prapë më thirri:

— Nisuni, ju thashë! E njeh vendin?

— Po, — thashë

— Oburra, sa më parë!

Hipa në kabinë. Shoferi kishte mbyllur xhamat dhe ishte strukur nga frika e bletëve që sillëshin rrotull.

U nisëm. S'më hiqej nga mendja ajo që bëri Kola. Nga guximi e bëri atë? Një zë më

thoshte se e bëri nga dashuria për bletën. Dhe unë këtë zë e besoja. Herë-herë nxirrja kokën dhe pyesja duke thirrur:

— Kolë, si je?

Nga mugëtira e natës që po zbehej dëgjoja:

— Mirë. Nxitoni se na zuri dita.

Ecëm edhe gjysmë ore dhe arritëm te vendi ku do të vendosnim parkun. Ishte një lëndinë e sheshtë dhe e madhe në mes të pyllit të gësh-tenjave. Makina qëndroi. Unë kërceva jashtë dhe vrapova te Kola. Çarçafi mezi njihej që ishte i bardhë. Ishte mbuluar nga bletët që dilnin pa pushim nga zgjoi i plasur. Kola ishte strukur e bërë grusht dhe shtrëngonte me pëllëmbë fytyrën. S'levizte, sikur të kishte ngrirë.

— Kolë, si je? Arritëm! — thashë me shqetësim.

Ai u ngrit ngadalë e me lëvizje të ngathëta si prej të dehuri zbriti poshtë duke u përplasur rëndë.

Hapëm spondet. Kola mori të parin zgjoin e rrëzuar dhe e shpuri në skajin më të largët të lëndinës. U mata ta ndihmoja, por ai ma preu shkurt:

— Rri ti, do të të hanë.

Filluam të zbritnim zgjojet. Nëpër duar e këmbë na hynin bletë e na thumbonin. Dhembja më shkante në zemër, po s'e bëja veten. Kushedi ç'kishte hequr Kola lart në makinë!

I shkarkuam të gjitha zgjojet në dy rreshta të gjatë. Po u vinim çatitë, kur dëgjoja rënkimin e Kolës.

Hodha tej çatinë që kisha në dorë dhe u sula tek ai:

— Ç'ke, Kolë?

Atij iu prenë gjunjët dhe u plas në lën-

dinë. Në dritën e paktë të mëngjesit që po fekte, pashë fytyrën e zbehtë që ndriste paksa nga djersa e ftohtë. Ajo ishte e tëra në ngërç.

— Ç'ke, Kolë? — pyeta sërish.

Ai, nëpër dhëmbët e shtrënguar, pëshpëriti si në jerm:

— S'jam mirë. Më hëngrën shumë.

Kaq tha e u platit përdhe.

Atëherë unë ia futa krahët nga poshtë, e mora hopa si të ishte një fëmijë dhe vrapova te makina.

— Nisu sa më shpejt. Drejt e në spital! — thashë përmes dihatjes.

Shoferi e futi makinën në marsh. Kola ngriti kokën e me zë të mekur, por urdhërues, tha:

— Ti mos eja. Do të më kalojë. Qëndro këtu. Vëru çatitë zgjojeve e hiqja rrjetat e telit nga dyert. Kur të gdhihet, po të duash, hajde më shiko.

Nuk munda t'i kundërshtoja. Seç kishte diçka solemne a një pushtet të padiskutueshëm ai zë i dobët që mezi dëgjohej, saqë unë zbrita poshtë pa thënë gjysmë fjale.

Makina u nis me uturimë. Unë vazhdova punën. Kur mbarova, hapa barakën, futa plaçkat e u shtriva në krevat pa u zhveshur.

U zgjova kur dita kishte hapur. As që më shkoi mendja të laja sytë. Mbylla barakën dhe u nisa me vrap deri te rruga kryesore, ku qar-kullonin makinat. Pylli i gjelbër i gështenjave kundërmonte erë të mirë. Pemët po lulëzonin e boçet e tyre të blerta, me gjemba të hollë e të butë ia shtonin bukurinë pyllit; këto i vija re duke vrapuar. Diku gjeta një makinë drush. Hipa në të. Mendja më rrinte te Kola, me shoferin nuk këmbeva asnjë fjalë. Nuk mbaj mend në

i pagova gjë atij për udhëtimin. Mbaj mend që bëra fjalë me portierin e spitalit dhe hyra gati me forcë brenda.

— Do të jetë i biri, — dëgjova pas meje portierin të fliste me vete.

Një infermiere më shoqëroi për te pavijoni i Kolës. Ajo ishte mjaft e emocionuar, plot përshtypje:

— Qenka njeri i jashtëzakonshëm, i hekurt, ai plaku, — thoshte ajo duke ecur nëpër korridor. — Mos është babai juaj? Kaq vite bëra në punë, por s'më ka bërë vaki rast i tillë. Me një sasi aq të madhe helmi do të kishin vdekur pesë njerëz, tha doktori ynë dhe unë atij i besoj. Ç'ka të bëjë imuniteti, — ligjëronte infermierja. — Po ç'i duhej të hynte te bletët natën? S'e dinte që ato të pickojnë? Ja dhoma e tij.

Unë hapa derën, hyra brenda dhe e mbylla me kujdes. Në dhomë kishte dy shtretër, po pacient ishte vetëm Kola. U afrova me hap të lehtë dhe po e vështroja. Ai kishte rënë në gjumë të thellë. Mjekra e zezë, aty-këtu e thinjur, i ishte rritur pakëz, kurse lëkura e buhavitur nga thumbimet ishte e djersitur.

Gropat e syve pothuaj i ishin rrafshuar e krahët më shumë u ngjanin dy sallameve tepër të trasha.

— Hë, Nasho, erdhe? — pyeti Kola me zë të qetë.

Unë u habita. Ai paskësh qenë zgjuar! Më gënjyen sytë e tij të mbyllur nga e enjtura. U afrova dhe i mora dorën në pëllëmbë:

— Si je, Kolë?

— Mirë.

— Ke dhimbje?

— Bletët si janë? I mbulove... Rrjetat ua hoqe të gjithave?

— Po, ashtu siç the ti...

S'mund të flisja më. Ngashërimi më zuri fytin.

— Po shtatëdhjetekatra si është? Sapo të vesh, ndërroja zgjoin, ose laja me ujë mjaltin e rrjedhur. Vështro mos e vjedhin të tjerat, sidomos njëqindegjashtëmbëdhjeta. Ç'hajdute që është ajo!

Kola heshti për disa çaste. Pastaj vazhdoi prapë:

— Në mbrëmje vëri një vazo me mjaltë të holluar shtatëdhjetekatrës. E shkreta ajo. Kushedi si do jetë bërë brenda. Dhe sa shumë që më thumbuan! Mbi njëqind vdiqën, buđallaçkat.

— Mos ki merak. Të gjitha do t'i bëj. Ti vetëm qetësohu e shërohu, — thashë, por ai më kundërshtoi:

— Ç'të qetësohem? Unë nesër do dal. Lëre ç'thonë doktorët. Ti më prit te parku i gështenjave.

Jashtë pothuaj është errur. Toni ngrihet e ndez llambën. Pastaj vazhdon të rrotullojë dorezën. Nuk flasim. Dëgjojmë «këngën» e mjaltit që rrjedh. Toni është djalë i turpshëm e i përmbajtur. I hahet mjaltë, por i vjen zor ta bëjë këtë. Herë-herë, kur kujtohem, i them:

— Toni, ha mjaltë. Pse ke turp?

Tani është bërë natë e s'ia shoh sytë e bardhë, që me siguri i ndritin:

— Po ti, usta? — pyet ai.

— Unë s'e ha mjaltin, — i them. — Më duket sikur u vjedh bletëve punën e djersën.

Toni hesht, sepse është djalë i mirë. Sikur jam në mendje të tij: Ai s'më zë besë. Patjetër që më pandeh gënjeshtar e njeri që dua të hiqem i shenjtëruar. Pastaj, si pa dashje, them:

— Nuk ka në botë zanat më të bukur se ky yni, Toni. Njëherë, një profesori plak, shkencëtar i bletëve, iu verbuan sytë nga thumbimi i tyre...

Papritur buzëqesh. Më kujtohet usta Kola!

## Fredi

Kisha një orë që prisja buzë rrugës. Tek-tuk kalonte ndonjë makinë e ngarkuar që, pasi linte një re pluhuri të dendur, zhdukej prapa kthesës. Pritja më nervozonte pa masë e s'di për të satën herë shikova orën. Asnjë makinë nuk qëndronte.

«Edhe dhjetë minuta do të pres», vendosa me vete.

Diku u dëgjua një zhurmë Zisi që afrohej, por unë, i mësuar tanimë me mospërfilljen e makinave, as që shpresova. Zisi frenoi. Nga dritarja e makinës doli koka flokëverdhë e shoferit që thirri:

— Ej, Nesti! Të zuri gjumi, dreqi të mori!

Unë njoha Fredin, shokun tim të fëmijërisë. U gëzova që e pashë, pasi shihemi rrallë e për mall, dhe renda ta takoja.

— Hë, ç'më rri atje si gur kilometrazhi? — pyeti Fredi pasi u përshëndetëm.

— Dua të shkoj në Gurbardhë.

— Ashtu? Po ç'pret akoma, hip!

Unë hipa.

— U bëmë për t'u puthur, o derëbardhë,  
— tha ai duke futur marshin.

Fredi ndezi një cigare. Më zgjati edhe mua një.

— Falemnderit! Nuk e pi, ti e di, — thashë unë.

— E di, po ndize kot.

Nuk ia prisha. Isha i sigurt që ai do të mër-zitej. Fredit i mbetej hatri shpejt.

— Ç'kërkon në Gurbardhë?

— E di, Fredi? Më ka zënë po ai hall që kishe edhe ti vjet.

— Ç'hall? — Fredi s'po kuptonte. — Bjeri shkurt, o lumëmadh.

Gjithnjë mahnitesha me Fredin. Ç'tip që kish!

— Po shkoj të takoj një vajzë. E kam njo-hur që kur isha atje me punë, — i rashë drejt unë.

— Një vajzë? — Fredi fishkëlleu. — Edhe ti, që na hiqeshe i turpshëm si një virgjëreshë, e prishe ndërgjegjen?! Shumë keq, djalë. Po a s'e di ti që këto janë gjëra turpe? Ngrihet burri i botës dhe shkon deri në Gurbardhë për të takuar një vajzë. Jo, këto gjëra nuk janë serioze.

Mua më erdhi inat. Më mirë të mos ia kisha treguar. Ec e dëgjo thumbat e Fredit!

— E, mjaft, se na shkrive. Vetëm surrati yt paska të drejtë të martohet? — thashë po-thuaj i pezmatuar.

Fredi ia plasi një të qeshuri buçitës, ashtu siç dinte veç ai. — Shiko, shiko, djalli! Qenka bërë burrë! — Fredi u bë serioz: — A e njeh mirë atë vajzë?



— Më duket se e njoh, — thashë me ton pajtues unë. — Është vajzë e mirë. Bisedonim kur e sillte rasti.

— Vetëm kaq?

— Pothuaj vetëm kaq. Nuk i kemi thënë asgjë njëri-tjetrit, megjithëse e ndiej që...

Ndenjëm pa folur një copë herë. Fredi dukej i menduar e mbase matej të më thoshte diçka.

— Po a je i sigurt që edhe ajo ndien për ty? — më pyeti Fredi, pa kthyer kokën, i përqendruar në timon.

Unë lëviza kot në ndjenjëse. S'dija ç'të thosha. Kjo pyetje më kishte ngacmuar sa herë që mendoja për atë vajzë.

— Nuk e di, po më duket se...

Rruga nisi të merrte përpjetë dhe makina, e ngarkuar rëndë, filloi të gulçonte. Fredi ndërroi marshin.

— A e di ç'më ka ndodhur njëherë në Fierzë, Nesti? Një ngjarje që, sa herë e kujtoj, më bën të skuqem.

Unë u ktheva nga shoku im. Ai me të vërtetë ishte skuqur dhe muskujt e nofullave i shquheshin mbi faqe, tek shtrëngoheshin. Pasi thithi thellë cigaren, lëshoi tymin duman nga hundët dhe vazhdoi:

— Atëherë mbaja gurë. I merrja në gurore dhe i shpija në digë. Atje punova për mjaft kohë. Një ditë, kur matesha të ikja, vjen një punëtor i vjetër dhe më thotë: «Or Fred, a po e merr këtë çikën deri në sektor?» Hedh sytë përjashta dhe shoh. Vajza kishte ulur kokën paksa e po priste në heshtje ç'do të thosha unë. «Mirë, them, në qoftë se ka qejf, le të vijë.»

Ajo hipi në kabinë dhe u ngjesh në skajin më të largët.

«Ka frikë», mendova unë. Kjo gjë më zemëroi. I hodha një vështrim nga pasqyra. Ishte një vajzë me të vërtetë simpatike. Një nga ato brunet e rralla me sy bojë qielli.

Vajza shikonte përpara me një pamje serioze, që tregonte sheshit se s'kishte ndër mend të hapte as më të voglën bisedë dhe dëshironte të ruante distancën. Mua ky qëndrim më inatosi. «Mos ki merak, fola me vete, do të ta heq frikën. As gjysmë fjale s'kam për të të thënë.» Ti më njeh, unë kaq dua.

— E marr me mend, ti fyhesh shumë shpejt,  
— thashë unë.

— Tërë rrugës nuk folëm. Kur zbriti, ajo më zgjati paratë. «Nuk është nevoja, s'të mora për lekë. Të mora për hatër të Pjetrit», i thashë. «E po, falemnderit, atëhere!» — tha vajza. «Edhe për këtë mos u harxho. Falëndero Pjetrin.»

Befas më kishte lindur dëshira ta fyeja atë vajzë kryelartë dhe ndjeva kënaqësi kur e pashë të trishtohej ashtu.

Të nesërmen, në rrugën e fundit, në të dalë të gurores, e shoh prapë atë. Shtova shpejtësinë dhe mendova që, po të kishte ndonjë pellg uji përpara saj, ta spërkatja me rrota. Kur, për çudinë time, ajo më ngriti dorën.

«Më merrni deri në sektor?»

Unë nuk fola dhe bëja sikur mendohesha, enkas për ta fyer. Pastaj, pa qejf, i thashë të hipte.

Ajo hipi. Unë nisa makinën. E pashë me bisht të syrit. Ajo e kishte lënë skajin dhe rrinte e qetë. Në fytyrë kishte një shprehje në mos miqësore të paktën jo të frikësuar. Unë vazhdoja lojën time. Admiroja malet e larta dhe kantierrin gjigant, thua se po shkelja për herë të parë në Fierzë dhe kabinën e kisha fare bosh.

Vajzën s'po e nxinte vendi dhe po matej të fliste:

«Nga Korça jeni?», pyeti më në fund ajo.

«Urdhëro?» pyeta unë gjoja i befasuar, megjithëse e kisha dëgjuar shumë mirë.

«Korçar jeni?» pyeti sërish ajo.

«Po», u përgjigja thatë.

Vajza heshti. Biseda s'po ecte.

«Unë mund të kisha shkuar edhe me ndonjë makinë tjetër», tha ajo me vështirësi pas një heshtjeje të gjatë.

«Sigurisht. Ka plot makina të reja, makina naftë. Kjo imja nuk është aq e re, mban erë benzinë. Mos jeni penduar? Mund të zbritni», thashë.

Frenova. Vajza u hidhërua dhe sytë i shndritën, mbase nga lotët.

«Nuk doja të thosha këtë. Unë vetë... doja të udhëtoja me ju.»

E pashë shtrembër dhe nisa makinën, si një njeri që e ka zënë belaja e s'di si të sillët. Udhëtuam me kilometra të tërë pa folur. Herë-herë hidhja një vështrim nga pasqyra. Nuk jam i zoti të lexoj në fytyrat e të tjerëve çfarë blujajnë, por më dukej se ajo s'ishte e qetë. Matej të fliste e s'fliste dot.

«Desha të udhëtoja me ju që t'ju kërkoja falje», tha më në fund ajo me një frymë, sikur trembej se s'do t'i arrinte guximi.

«Falje? Mua? E përse!»

«Për dje.»

Unë u ngërdhesha dhe fola me mospërfillje, sikur ajo bisedë të më interesonte më pak se çdo gjë në botë.

«Nuk mbaj mend të më keni fyer. Madje ju as nuk folët. E si mund të fyeni një njeri pa i folur asnjë fjalë?»

«Pikërisht. Unë ju fyeva me heshtjen time, me frikën time të kotë», tha ajo me zërin e një të penduare.

«Nuk shoh ndonjë gjë fyese në këtë mes. Është me dëshirë. Bisedon me atë që dëshiron. Bile, edhe tani, po të doni, mund të heshtni, pa pasur frikë se më fyeni.»

«Nuk e di, por unë jam e bindur që ju u prekët nga qëndrimi im i djeshëm. Sa budallaqe që u tregova!»

Vajza fliste pak e mallëngjyer e me zemër në dorë, siç na ndodh atëherë kur e kuptojmë edhe vetë që e kemi shkelur. Dalëngadalë po më ikte marazi. Ajo ishte një vajzë shumë e sinqertë, shumë e mirë. E me ç'të drejtë fyhesha unë, që një vajzë e panjohur nuk desh të bisedonte me mua? Për herë të parë ktheva kokën nga ajo dhe i fola thjesht, pa thumba: «Po, është e vërtetë që më mbeti ca hatri. Po ne nuk njihim. Ja, biseduam sot.»

Ajo u çel dhe psherëtiu e lehtësuar. Ndërkaq kishim arritur. Vajza kërceu poshtë e lehtë si një flutur. Nxori një trelekëshe dhe ma zgjati.

«Dëgjo, moj vajzë...»

«Më quajnë Lida. Jam nga Tirana, stazhiere», tha ajo me thjeshtësi.

«Dëgjo, Lida. Në qoftë se do të udhëtosh prapë me mua, fute atë treshkë në xhep, ndryshe nesër prit ndonjë makinë tjetër. Kurse mua më quajnë Fredi», i thashë.

U lidh një si marrëveshje e heshtur, që rrugën e parë ta shpija në gurore dhe të fundit ta ktheja në sektor. Shpesh ajo e hante mëngjesin në kabinë, në udhëtim e sipër. E ndihmoja nganjëherë edhe unë. Ajo rrinte në kabinë e shpenguar. S'ngopej së foluri për Tiranën e saj,

tregonte ndonjë histori gazmore ose këndonte me zë të ulët. Unë kënaqesha dhe më dukej sikur makina ime nuk vraponte, por fluturonte e ngrihej lart, mbi retë. Më vinte keq që udhëtimi ishte aq i shkurtër dhe prisja me kënaqësi rruqën e fundit. Jo rrallë shkonim në kinema e ditët e rrogave hynim patjetër në pasticeri. Tek na shihnin ashtu bashkë, njerëzit buzëqeshnin e mbase thoshin me vete: «Ja dy të rinj të gëzuar», ndërsa Luli, ai shoferi që ti e njeh, më hidhte vështrime me plot kuptim e më shkelte syrin. Mua këto vështrime më bezdisnin e më prishnin humorin.

Një mëngjes, në pluhurin e derës së makinës shoh të shkruar me gisht: «sylesh». Njoha menjëherë shkrimin e Lulit. Mora leckën, fshiva pluhurin dhe u nisa për në punë. Gjithë atë paradite u brejta me vete e s'më pritej sa të hasja Lulin. Në drekë e gjej në mensë. Pasi e përshëndeta, e pyes:

«Ti shkrove ashtu në derën e makinës?»

Luli shtyu përpara pjatën e boshatisur, mbështeti bërrylat në tryezë dhe tha:

«Jo, çne. Unë besoj se e ke rregulluar me atë kryeqytetësen. Po nuk më thua, për kokën tënde, ç'magji i bëre?»

Luli më shihte me një palë sy ku shkëlqente kureshtja e përzier me një lloj paturpësie.

«Për Lidën e ke fjalën?» thashë.

Ai u skërmit. Vështrimi iu bë ironik dhe ma pati:

«E për kë ta kem? Për retë e vjetshme? Ah, ti, thëngjill i mbuluar, bën sikur s'kupton! Ju engjëjt të digjni. S'thonë kot, «ruhu nga cjapi shyt».»

«S'kam gjë me të», i thashë.

«Aha, konspiracion!». Luli u zgërdhi me të madhe. «Jo me mua, vogëlush, jo me mua. Sidoqoftë, po të kesh nevojë për vend, e rregullon lala atë punë.»

«Të betohem... këmbëngula unë, vetëm miqësi kam.»

Ai u kthye nga unë e, pasi më pa gjatë drejt në sy, tha:

«Atëherë qenke gomar i matufepsur, qenke vërtet një sylesh, eunuk.»

«E pse?»

«Si, mor, pse? — vuri kujën Luli. — Të shëtitësh atë farë zoçke lart e poshtë e të bisedosh vetëm për hidrocentralin! Po pse, kot të ngjitet ajo ty? Apo ka pak makina gurorja. Ajo pret tjetër gjë nga ti, more merhum. Eh, të isha vetë!»

Luli ndezi një cigare. Më dha edhe mua një dhe vazhdoi:

«Pse, ç'kujton ti, se me këtë qëndrimin tënd asaj i shtohet respekti? Të gënjen mendja, i neveritesh e patjetër që ajo thotë me vete: «Ama ç'qenka një gargull ky që s'e paska shokun. Pse, ç'pret i humburi, t'i shtrihem në sedilje e t'i them: hajde?» Ke për të parë, do t'i pështirosesh e as sytë s'do të t'i hedhë. Femrat i duan meshkujt të hedhur, agresivë, imponues. Kjo është në vetë natyrën e tyre. Nejse, ti bëj si të duash, po një ditë do më thuash: «ku e dije, bre Luli!»»

«Nuk e bëj dot», thashë.

«S'e bën dot, — pyeti ai e, pasi u mendua një hop, sytë i ndritën: — Atëherë, prezantomë mua me të. Të shohësh se kush e hedh nokaut. E lëmë për sot, pas pune. Shkojmë në pasticeri. Ti rri pak, gjej një shkak dhe largohu. E di vetë unë pastaj.»

«As këtë s'e bëj dot, iu përgjigja. Bile, do t'i them të këtë kujdes nga ti.»

«Ashtu?» më tha. M'u afrua te hunda. Mblo-  
dha grushtet e i dhashë karar: po të donte sherr,  
do t'ia prisja turinjve. Të dilte ku të dilte. Ai e  
vuri re këtë, lroi grushtet e duke ikur tha:

«Me kë grij lakra dhe unë, me qullin. Ai  
s'të jepte fletoren e detyrave e jo të të japë një  
femër.»

Hodhi xhaketën supit dhe doli. Unë mbeta  
si hu. Në kokë më vinin rrotull fjalët e Lulit si  
diçka pa fillim e pa fund, që s'ke nga ta ka-  
pësh. Mos e kishte mirë Luli? Mos ndoshta ajo  
priste më tepër e, kur shihte që mua as që më  
shkonte mendja, më nxirrte gjuhën prapa shpine  
e më përqeshte duke më bërë sylesh në një kohë  
kur unë kujtoja se bëja shoqëri të madhe? Fi-  
llova të rikujtoja gjithë qëndrimin dhe sjelljen  
e saj. Mundohesha të dalloja në çdo fjalë të Li-  
dës një nënkuptim a një nëntekst. Nisa të sillja  
ndër mend çdo hollësi, deri edhe te vështrimet.  
Ndonjëherë më bëhej t'i besoja arsyetimit të Lu-  
lit dhe e gjykoja veten: budalla me brirë je, o  
Fred. Ndofta në timon je i shkathët, po këtu,  
ëhë, i ngathët si një kërmill. Pastaj, papritur  
më dilte përpara fytyra e Lidës, me sytë e saj  
bojë qielli të errët, që sikur më thoshin: «Si!  
me gjithë mend i beson Lulit ti?» Sytë e saj  
ishin aq të pastër, aq larg nga çdo prapamen-  
dim i lig, sa që unë ndieja të skuqesha e të më  
hipnin djersët. Sidoqoftë, Luli kishte lëshuar një  
grusht me miza, të cilat s'më linin të qetë.

Dola nga mensa dhe hipa në makinë. Isha  
bërë tym. Ndeza makinën dhe u nisa. «Do ta vë  
re e do ta provoj», thashë.

Rrugën e fundit mora Lidën. Nuk isha i  
qetë. Pija cigare dhe heshtja. Ja ku e kisha aq  
pranë. Mjaft të më shpëtonte dora nga marshi

dhe do të kapja gjurin e saj. I hidhja nga një shikim të shpejtë dhe pyesja veten: si ta provokoj? Një valë turpi më bënte të shtrëngoja fort timonin për atë mendim. «Pse, ç'pret ti, të të shtrihet në sedilje?» më jehonte në vesh zëri i Lulit. Shihja me bisht të syrit Lidën. Gjiri i saj ishte vetëm katër gishta larg bërrylit tim. Frymëmarrja po më nxitohej. Diku, në një kthesë, bërryli im preku nuk di në ç'pjesë të butë të trupit të saj. U drodha si prej korentit. Ajo s'lëvizi. Shikonte tutje. Ndoshta as që e kishte mendjen tek unë. Apo ndoshta e kishte dhe ndenji vetë? Ç'e ngatërruar që qenkej kjo puna e femrës! Ec e merre vesh si e ka në mend. Si ta provokoj, si t'i them? Buzët i ndieja të thara e zëri s'më dilte. Përfytyroja çastin e parë ja, do t'i hidhja krahun në qafë, do t'i afroja kokën e do ta puthja. Ajo do tulatej pas meje si një kotele dhe do pëshpëriste: më në fund... Pastaj do ta kapja për beli, ndoshta... Frenova buzë hendekut. Edhe një sekondë dhe do të ishim në fund të përroit. Isha shumë i shqetësuar. Kjo gjë i ra në sy edhe asaj.

«Ç'ke kështu, Fred?» më pyeti Lida duke më kapur nga bërryli.

Përpara xhamit më dolën sytë e Lulit, që zgërdhiheshin: «A s'të thashë?»

Unë heshtja. Në tru më vërtitëshin lloj-lloj mendimesh. Si ta provokoj, si? Thonë se mjafton vetëm një sekondë guxim. Lida ma kapi krahun dhe ma shtrëngoi.

«Ç'ke kështu, Fred, — pyeti prapë. — Sot je i çuditshëm. Thonë se, kur djemtë bëhen të heshtur, kanë rënë në dashuri. Mos të pëlqen ndonjë vajzë, Fred? E njoh unë? Po qe kështu, pse s'ia thua?»



Prapë më doli para syve Luli, duke zënë kokën me të dyja duart e duke thirrur: «Kulmi, ky është kulmi! Më troç se kaq as që mund të thuhet. Sylesh, eunuk!»

As unë nuk e di si e hoqa dorën nga timoni, ia hodha në qafë, e afrova nga vetja dhe i pëshpërita në vesh:

«Po ç'je kaq e mirë, moj Lidë?»

Ajo në fillim nuk e kuptoi se ç'ngjau. Pastaj, befas, kërceu tutje dhe po më shikonte e llahtarisur:

«Fred, a je në vete?!» bërtiti ajo me egërsi.

Në sekondë e kuptova marrëzinë time. Kisha kërkuar mekanikisht, sipas «udhëzimeve», diçka që merrej vetëm me zemër. U ktheva nga ajo. Lida, e shfytyruar nga inati, po më shihte me ca sy të mbushur plot zemërim e urrejtje. Një habi e madhe, e përzier me pyetje e frikë, kishte ngrirë aty e cepat e buzëve filluan t'i dridheshin nga ngashërimi. Sytë i morën një shprehje të thellë keqardhjeje e zhgënjimi. Befas ia dha të qarit. Supet i dridheshin. Unë e shihja kështu e s'më bënte goja t'i thosha «më fall!» Atë çast e urreja atë fjalë, me të cilën mundohemi ta hedhim lumin pa u lagur, duke shpëlarë gojën. Ajo u kthye nga unë, më pa me sytë e përlotur drejt në sy e përmes dënesës tha: «Pse e bëre këtë? Për çfarë më kujton mua?» Pastaj, me një hov të papritur zemërimi, thirri:

«Ndaloje makinën!»

«Nuk e ndaloj!»

«Ndaloje, se do të hidhem!»

«Hidhu!» Ajo ishte kokëfortë, por unë edhe më kokëmushkë.

Lida hapi derën. Unë frenova. Ajo zbriti,

kaloi hendekun e rrugës e u ul mbi një gur. Kokën e mbështeti mbi duart e vëna mbi gjunjë dhe vazhdonte të dëneste. Unë shova makinën dhe po prisja i heshtur. Shaja veten e nuk u përpoqa të zbutja Lidën. Duhej të ndëshkohesha rëndë, në mos për tjetër, të paktën për shpërdorimin aq të poshtër të shoqërisë së saj.

Kaloi një makinë. Njerëzit panë me dyshim nga ne. Lida u mundua ta lehtësonte gjendjen duke bërë sikur e kishte zënë makina.

«Pse s'u the atyre si qëndronte puna, Lida? — fola për herë të parë, pasi iku makina. — Pse nuk shkove tek i plotfuqishmi? Unë e meritoj. U tregova i ulët, kafshë»...

Lida ngriti kokën dhe më vështroi e përloitur. Sytë e saj dukeshin ashtu edhe më të bukur, si një copë qiell i larë nga shiu i majit.

«Unë jam ashtu, siç the ti, Lida: i poshtër, harbut.»

Vajza u ngrit në këmbë, u shkund dhe hipi në makinë.

«Shkojmë», tha me ton indiferent ajo.

U nisëm. Herë-herë i hidhja ndonjë vështrim të shpejtë nga pasqyra. Ajo ishte akoma mjaft e zemëruar. Ecnim dhe nuk flisnim. I hodha prapë një vështrim. Lida po më shihte nga pasqyra. Sytë tanë u ndeshën. Unë nuk i ula të mitë, e durova qortimin e syve të saj. Kështu u pamë disa çaste, si dy fëmijë që mundin sytë. Më në fund Lida ia plasi gazit:

«Sa i keq që u tregove, Fredi», tha ajo.

«Po, i keq. Madje shumë i keq. Më vjen turp, Lida. Singerisht ta them. Ti ndoshta nuk e beson.»

Sa dëshiroja që ajo të më besonte! S'gjeja dot fjalë për t'i treguar sa isha penduar. Sikur

të kishte mundësi që njeriu të hapte gjoksin e të tregonte zemrën!

«E besoj, sepse je djalë i mirë», tha Lida.

«Jo. Jam i keq. Më i keqi i gjithë hidrocentralit», i thashë.

Ajo fshiu lotët. Nga zëri ndihej prapë e lehtë e pothuaj e gëzuar, si përherë, ndërsa unë s'e shikoja dot drejt në sy tek bisedonim.

Fredi thithte thellë cigaren e shtrëngonte fort timonin, sikur të donte të shkarkonte atje një pjesë të tensionit që provonte ato çaste, ndërsa unë rashë në mendime të thella dhe fillova të rivlerësoja edhe një herë marrëdhëniet e mia me atë vajzën nga Gurbardha.

## Rastësia

Të katër heshtën dhe e ndien veten të lodhur e pa pikë dëshire për ta vazhduar më tej debatin. Kështu bënë përherë. Në qoftë se nuk lexonin a loznin shah, ia nisnin bisedës shtrirë, secili në krevatin e vet. Shpesh këto biseda përfundonin në grindje, sepse në atë dhomë kishte dy kundërshtarë të papajtueshëm: Naimi e Dhori. Asnjëherë nuk ndodhte të ishin në një mendje. Sapo njëri shfaqte një pikëpamje, me njëherë tjetri do të dilte mbrojtës i zjarrtë i tezës së kundërt, edhe sikur vetë të ishte krejt i sigurt për drejtësinë e mendimit të shokut. Tek përfytyreshin ashtu, ngjanin si dy avokatë kundërshtarë ose, akoma më keq, si dy gjela që kreshpërojnë pendët e qafës për t'u kacafytur. Dy të tjerët krijonin, sipas rastit, «bllloqet» e njërit ose të tjetrit. Njëri ishte Iliri, një djalë zeshkan e fjalëpak, i urtë si një lejlek, pasioni i të cilit ishte frëngjishtja, e tjetri Andoni, një burrë rreth të dyzetave. Ai kishte disa muaj që ishte

transferuar aty dhe banonte në hotel të beqarëve derisa të sillte familjen. Kur Dhori e Naimi ziheshin, ai buzëqeshte me një shprehje të tillë, sikur të thoshte: rini, hesapi, i zien gjaku si mu-shti në vozë.

Haheshin për gjithfarë gjërash, që nga teoritë e mëdha e ligjet e universit e deri tek ato njëqind e nëntëdhjetë e pesë metrat mbi dyzet e dy kilometrat e garës së maratonës. Gjithçka mund të bëhej objekt i grindjeve të tyre, madje edhe pikat në vezën e pulës së detit. Grindeshin deri vonë e të shumtën e herës flinin pa u shpallur fituesi, për të rifilluar të nesërmen. E, megjithatë, zinin be për kokën e njëri-tjetrit.

— Pra, ti mohon rastësinë, — tha me ton provokues Dhori, atëherë, kur të gjithë kujtuansen ajo bisedë aq e patë.

— E mohoj kategorikisht, — tha me ton të vendosur e me vrull të ri Naimi.

Dhori buzëqeshi hidhtas dhe tha me ironi e me triumf, sikur ta kishte kapur tjetrin në grackë.

— Ti mohon veten, or baballëk. «Rasti, ka thënë Balzaku, është mbret i botës.» Ç'i thua ti kësaj? Dhe s'e ka thënë njëfarë inxhinieruci si ndonjë këtu rrotull, — fjalët e fundit Dhori i theksoi, — po pikërisht ai, të cilin Marksi e ka quajtur doktor të shkencave ekonomike...

— Kurse materializmi...

— ... dialektik thotë që parësore është domosdoshmëria. Kështu? E di, moj zemër. Sa për sqarim, filozofinë e kam mbrojtur me notën dhjetë, kështu që s'është nevoja të lodhesh duke na cituar leksione, — ia rrëmbeu fjalën nga goja Dhori.

Andoni, që ishte ngritur me bërrylat mbi jastëk, tha me ton pajtues:

— Nuk dua të përsërit ato të vërteta që dihen e që edhe ju vetë i dini, pavarësisht që grindeni. Dua të tregoj diçka për rastësinë.

Andoni u rregullua mbi jastëk.

— Mund të kenë kaluar mbi dhjetë vjet. Atëherë punoja në një kantier në Tiranë. Në shtëpi vija rrallë. Ndieja që kisha shumë forca e më dukej se mund të shembja një ndërtesë të tërë.

Andoni buzëqeshi.

— Po kthehesha nga një prej këtyre vizitave të rralla. Kisha dalë në agjencinë e autobusëve dhe prisja të vinte ora e nisjes. Duhej edhe më shumë se gjysmë ore. Hyra në bufenë e stacionit dhe porosita një kafe. Përkrah meje, në banak, ishte një vajzë e gjatë, me flokë të drejtë, të dendur e të bukur bojë gruri. Unë mora filxhanin, u tërhoqa në një tryezë aty pranë dhe zura ta rruftitja ngadalë, si ata që duan të vrasin kohën. Sytë më vajtën prapë tek ajo vajza që bleu bashkë me mua. Ajo qëndroi në tryezën pranë dhe nisi të hante diçka me druajtje. Fillova ta vështroja; ishte një vajzë e hijshme. Ajo e vuri ré dhe u bë më e matur. Herë-herë ngrinte sytë. Unë vazhdoja ta shihja dhe po më pëlqente. Ah, sikur ta kisha ditur që në agjenci do takoja një femër të tillë, do kisha dalë edhe një orë më parë. Koha për t'u nisur po afronte e s'më mbetej gjë tjetër veçse të gjeja autobusin. Hipa në të e u ula në vendin tim, përkrah një plaku që kollej thellë. Unë, përgjithësisht, nuk kam fat për punë vendesh në autobus. Pothuaj gjithmonë më rastisin vendet e mesit. Ajo ditë bënte përjashtim, vendin e kisha te dritarja. Kjo më gëzoi. Ende s'isha ulur mirë, kur nga xhami pashë edhe atë vajzën që po nxitonte drejt

autobusit tonë. Hipi dhe u ul diku. Pas saj u ngjit një djalë, moshatar me mua. Pasi numëroi me sy vendet, ai m'u drejtua duke më treguar biletën: — Ju lutem...

Unë hapja sytë. Në krye pandeha se mos isha ngatërruar. Pashë numrin pas shpinës së ndenjësës e pastaj atë të biletës. I njëjti numër. U hëngrëm pak me fjalë e u shigjetuam me thumba. Puna shkoi deri te shoferi. Ky mori të dyja biletat tona dhe i shkoi me vëmendje. E qartë, ishte gabimi i biletarisë. Pasi pa një vend të lirë, ai i tha moshatarit tim:

— Uluni tek ajo vajza, ju lutem. Bëhen gabime.

Tjetri shkoi atje ku i thanë dhe u ul. Unë sa s'plasa nga marazi. Të rroftë vendi, Andon, thashë. Piji lëngun. Je shumë i ngathët, dreqi të marrtë! Nuk di fare të manovrosh: E ç'të shkrepiti të ngulësh këmbë aq shumë si mushka? Vendi tënd deshi ai? Hallall ta kishte! Tani do ishe përkrah saj.

Autobusi u nis. Unë vazhdova të brehesha me vete. Herë-herë hidhja andej një vështrim me bisht të syrit. Ata rrinin të heshtur, si rrinë dy të panjohur. Dikur ai i foli me zë të ulët e të druajtur, nga frika se s'do të merrte përgjigje. Mbase e pyeti ku po shkonte ose prej nga ishte. Ajo iu përgjigj po me zë të ulët. Mua sikur më shkelën në kallo. Heshtën një copë herë. Vazhdoja t'i vështroja me bisht të syrit. Ai kishte marrë një pamje sikur mendohej ç't'i thoshte më tej e ajo sikur rrinte në pritje të një pyetjeje tjetër. Ai prapë i foli e mua m'u duk se më cimbisi njeri. I poshtri! — blova nofllat në heshtje. Vajza qeshi lehtë e diç i tha. Ai mori zemër dhe u kthye paksa nga ajo. Fi-

lluan të çuçuritnin e mua mend më mbeti qafa prapa. Hajvan me zile, i thosha vetes, tani ai do të ishte ti. Rri këtu e dëgjo kollitjen e plakut tani.

Vajtëm në stacion të trenit. Zbrita i pari dhe, pasi u largova pak, zura të vrojtoja lëvizjet e kundërshtarit. Ai diçka i tha, mbase i propozoi ta ndihmonte. Ajo bëri me kokë një lëvizje miratimi e ai i mori valixhen. Zbritën poshtë. Përshkuan me hap të ngadalshëm sheshin dhe hynë në stacion. Vendosën bagazhet në një qoshe e ai shkoi të merrte bileta. Vajza mbeti atje, me sytë tek ai. Ishte një vështrim vlerësues. Me sa dukej, bashkudhëtari i pëlqente. Ai u kthye me biletat dhe hapën çantat. Nxorën për të ngrënë e, pasi shkëmbyen me njëri-tjetrin ç'kishin, nisën të hanin.

Unë s'po ua ndaja sytë. Më kishte hipur një kureshtje a zili që arrinte deri në smirë. Munda hesha të qetësoja veten e madje e shaja: me ç'të drejtë u qepesh atyre, mend vë ulërimën që një vajzë e panjohur u njoh me një djalë të panjohur? Smirëzi i mjerë!

Erdhi treni e unë hija e tyre. Ata zunë vend në një anë, unë paralel me ta në anën tjetër. Nxora një libër dhe nisa gjoja ta lexoja, por sytë e veshët i kisha gjetkë. Ai e ndihmoi atë të hiqte pallton dhe ia vari në varëse. Nisën të bisedonin. Nuk ishte e mundur të kuptoja qoftë edhe fjalë të vetme nga ato që shihja në libër. Tek unë ekzistonin vetëm veshët, e veshët i kisha dy metra më tutje. A mund ta besoni që në gjashtë orë e gjysmë udhëtim nuk u mora me gjë tjetër veçse me vëzhgimin e tyre? Ndiqja hap pas hapi ato një mijë e një manovra të vogla, të holla e të padukshme që bën një djalë



për t'i fituar zemrën ose së paku simpatinë një femre të bukur si ajo. E shihja tek përparonte ashtu ngadalë e me ngulm dhe më therte në zemër: unë mund të isha fare mirë në vend të tij.

Po i afrohem Tiranës. Fytyra e tij mori një pamje të përmalluar e lutëse. Ndoshta i vjen keq që ky udhëtim mbaroi kaq shpejt, maskarait, u skërmita unë dhe uroja nga thelbi i zemrës që treni të arrinte një sekondë e më parë. Ai i pëshpëriste me zë të ulët. Mbase i shprehte dëshirën që të takoheshin përsëri. Ajo bëri po me kokë. Ai nxori bllokun, shkëputi një fletë, shënoi diçka, mbase adresën e ia dha asaj. Ajo e palosi me kujdes dhe e futi në xhep. Ai i kërkoi diçka me zë të ulët. Kjo, po në atë mënyrë, nisi t'i diktonte me të pëshpëritur. Ai shkruante ethshëm adresën e saj. Nga vagoni zbrita i fundit dhe nisa t'i ndiqja ata si një i përбетuar. Gjë e ulët, do të thoni ju. Mbase po. Nuk di çfarë më shtynte të fshihesha nëpër kolonat e peronit e t'i gjurmoja. Kisha një kureshtje të fortë të dija deri ku do të arrinin ata dy njerëz, para disa orësh krejt të panjohur. Ai ia mori valixhen pas një kundërshtimi të lehtë të saj. Dolen nga stacioni dhe morën një rrugë anësore. Unë pas, si hije. Po rrezikohesha të mbetesha pa darkë. Mos qesh, Ilir. Rivali im kishte gjithnjë kujdes t'i ngadalësonte hapat. Bisedonin me zë të ulët. Kur e kur dëgjoja të qeshurën e saj të përmbajtur. Dikur qëndruan para një porte, unë u ngjita pas murit. Biseduan shkurt midis tyre e i dhanë dorën njëri-tjetrit. Ai ia mbajti dorën pakëz më shumë se ç'duhej. Ndoshta një të dhjetën e sekondës, por unë e ndjeva thellë që për ata ai fragment sekonde ishte një moment shu-

më i madh, ndoshta përcaktues për jetën e tyre.

Vajza u zgjat dhe shtypi sustën e ziles. Ai u tërhoq në errësirë. Përtej portës, në oborr, u ndez një dritë e pastaj porta u hap. U dëgjuan zëra habie e gëzimi. Vajza hyri brenda. Djali u tret në errësirën e rrugicës, kurse unë u largova për në hotel.

Për shumë kohë e sillja ndër mend këtë ngjarje si një rast që provonte ngathtësinë time. Pak nga pak ajo u fashit e isha gati ta harroja. Madje e harrova. Pas katër vjetësh lejen e kalova në një kamp malor të qytetit tim. Mora fletëkampin dhe u paraqita datën e caktuar. Isha ndër të parët që kisha vajtur dhe po rrija në një poltronë të hollit duke parë të vonuarit. Midis tyre pashë edhe një çift të ri, me një fëmijë rreth tre vjeç me palaçeta, që e tërhiqnin të dy për dore. U ngjetha. Mend kërceva nga poltrona përtpjetë. Ishin ata. Kaluan indiferentë pranë meje, kuptohet, as që më njohën. Unë për ta isha një nga ata mijëra të panjohur që na kalojnë çdo ditë para syve e që, ashtu siç ishin, ashtu mbeten, të panjohur. Kurse mua nuk mund të mos më kujtoheshin të dy, çifti që ndoqa atë natë. S'doja të besoja, por ishin pikërisht ata, vajza me flokë ngjyrë gruri dhe rivali im, tashmë të martuar e me fëmijë. Ja pra ç'bëri një vonesë prej një minute e tij. Po të mos kishte ndodhur ajo, kushedi, mbase kjo histori do kishte rrjedhur krejt ndryshe, mund të kishte ndodhur edhe e kundërta. Ku ta dish?

## Ditë te reja

Në shtëpi ishte bërë për të mos ndenjtur më. Kishte rënë heshtja sikur të kishte vdekur dikush. Ecnin pa u ndier, pothuaj në majë të këmbëve, si hije, e kjo ia shtonte edhe më shumë zymtinë shtëpisë. Sa herë takoheshin ballë për ballë, i hapnin rrugë në heshtje me njëfarë respekti të çuditshëm, si ndaj një të verbri. Vështrimet, sidomos së ëmës, nuk ua kapte dot. Kthenin kokën mënjanë e i vidheshin shikimit të tij. Çdo gjë në atë shtëpi bëhej në heshtje të plotë si në një tempull. Edhe buka shtrohej po në heshtje e të tre hanin për hesap të vet, si tre të panjohur të ulur rastësisht në një tryezë restoranti. I ati ia hidhte sytë e sa s'ia plaste: Mirë t'u bë. Mos i var turinjtë hiç. Të mësoje si shokët e sot do të ishe në shkollë.

Ndërsa e ëma, e butë, nga natyra, i hidhte një vështrim të pikëlluar e të dhembshur. Mendohej ta ngushëllonte e t'i rrinte pranë, ashtu siç e kanë zakon nënat.

Nga e gjithë kjo Tomit i vinte të çirrej me thonj. Nuk mjaftonte që s'i doli e drejta e studimit, po duhej të duronte edhe përdëllimin e së ëmës. Në karakter ai kishte marrë më shumë nga i ati, ishte krenar nga natyra. Më mirë duronte qortimin e të atit, sesa sjelljen e butë të së ëmës. I dukej sikur ajo e mëshironte siç mëshirojmë një sakat që nuk mund të ecë dot më. Ndonjëherë heshtja prishej e pothuaj gjithmonë shkaktare bëhej e ëma. Nuk i duronte dot barku dhe ia fillonte:

— Edhe ata të seksionit të arsimit hiç nuk janë në vete, — ankohej ajo. — Ne këtë kemi djalë, këtë çupë, e të mos ia nxirrnin të drejtën e studimit. Të birit të Selvisë, sa mirë ia nxorën. Që të katër i studiuan asaj. E po kjo është për të rrëfyer.

I shoqi hungëronte dhe ia priste:

— Posi, ashtu si thua ti është. Le të mësonte yt bir e sot do të ishte në Tiranë, po mbeti pas topit, pas filmave. Le po ke gojë të flasësh edhe për djalin e Selvisë. Atij s'i gjen një nëntë në dëftesë, moj grua.

— Se si mësojnë ca e ca! — tërhiqej e mundur e ëma. — Ku i gjejnë gjithë këto mend, xhanëm? I biri i Selvisë! S'të vjen të çahesh? Kurse ky yni...

— Kurse ky yni, kurse ky yni! — ia priste i shoqi me inat. — Çfarë jemi ne? Unë elektrikist, ti kuzhinierë. Intelektualë të mëdhenj ne, s'e sheh? Mos ia zgjat, se ti e ke bërë as mish, as peshk. Të punojë aty si shokët. Puna s'ha njerëz. Gjithë bota me punë rrojnë, oj!

Tomit zakonisht nuk merrte pjesë. E linte veten në dorë të tyre, si një i paditur që sheh si kacafyten për të pala akuzuese me atë mbrojt-

tëse. Rrallëherë, kur i ati e tepronte me fshikullimat e tij, mërmëriste me zë të mbytur:

— Po unë nuk isha aq i humbur, mor baba.

I ati qëndronte, i hidhte një vështrim mosbesues dhe fliste me një ton pajtimi:

— Mirë atëherë, kur s'je i humbur, puno ditën e mëso natën. Ndiqi studimet me korrespondencë. Njeriu që ka vlerë, kurrë s'humbet. Herët a vonë do ta zërë vendin që i takon.

Tomi nuk ndenji shumë pa punë. I dukej vetja si në azil tek vërtitej ashtu nëpër shtëpi. Heshtja mend e shtrëngonte në grykë. Shëtiste nëpër qytet, por edhe kështu u mërzit shpejt. Nuk shtyhej dita duke u sjellë vërdallë.

Qyteti i tij i vogël ndodhej rrëzë një vargmali mineralmbajtës e pothuaj të gjithë të rinjtë e qytetit të tij punonin në minierë.

Ai mori fletën e punës dhe u paraqit në ekipin gjeologjik. Mbase e caktonin në ndonjë piketim apo në ndonjë diçka të tillë.

— He, — pyeti e ëma, sapo ai shkeli në prag, — si dole?

— Si rruar, qethur. Më dërguan në puse, — tha ai.

— Korba! Të të zërë brenda pusi. Mos shko. Po vetëm pusi qenka për ty, more bir, s'kishin ndonjë punë tjetër?

— E po, s'do më vinin inxhinier, de! — shfryu Tomi i nxehur më shumë me veten se me të ëmën.

Nëna, një grua rreth të dyzetave, me flokë të errët e të dallgëzuar, me trup të shëndoshë, ashtu siç janë përgjithësisht kuzhinierët, kryqëzoi llërët e plota dhe tha duke psherëtirë:

— Rriten fëmijët, rriten hallet thuaj. Mos shko. Do gjejmë edhe ne dy njerëz që të ndër-

hyjnë. Qyqja, një djalë të vetëm kemi e ta futim në pus!

Kaloi edhe një javë e të gjitha përpjekjet shkuan kot.

— E kush të bën mirë sot. Ruajnë karrigen njerëzit, — ankohej e ëma.

— Jo se ruajnë karrigen, — sqaronte i ati, — po kjo bie erë hatërllëk. Pse t'i vidhet punës, djalë i ri është. Me shëndet s'është keq. E kush do të punojë në puset, pa më thuaj? Fundja, le të shkojë një herë e ta provojë. Po qe se është e vështirë dhe e rrezikshme, le të mos shkojë më. Kur t'i dalë puna.

Kështu e ndanë.

Të nesërmen e ëma e përcolli me lot në sy deri në rrugë, sikur ta përcillte nizam e jo në punë. Në dorë i vuri një pako të madhe me ushqime, sa për dy ditë bashkë.

Me një gjendje të zymtë, Tomi shkoi në ekipin gjeologjik. Nëpër oborr vërtiteshin njerëz të veshur trashë, me peliçe e çizme. Në kokë kishin kapelat mbrojtëse e ndonjë mbante në dorë llambën me karbit. Dikush pyeste, tjetri i përgjigjej. Njëri bënte shaka e të tjerët qeshnin me të madhe.

Atij iu mblodh diçka në grykë kur mendoi se, në vend që të ulej në auditor e të dëgjonte ligjëratën e pedagogut, do t'i duhej të punonte me ata njerëz të ashpër e mbase edhe të trashë. Pyeti dhe i treguan kryetarin. Ai ishte një burrë me flokë të dallgëzuar, të dendur e në ngjyrë të çelur, që po bisedonte me disa sondistë. Me ç'kuptoi ai, po flisnin për transportimin e një sonde.

Tomi priti me durim, derisa sondistët u larguan. Pastaj si me druajtje iu afrua kryetarit.

E merrte me mend që ai mund ta priste me përcmim; një njeri që s'kish siguruar as të drejtën e studimit, me mesataren tetë pikë tre. E përshëndeti me zë të ulët:

— Mirëmëngjesi, shoku kryetar!

— Mirëmëngjesi, djalë! Si e keni punën?

Tomi i tha se kush ishte e përse kishte ardhur.

— Ama, ti qenke Tomi?! — tha kryetari.

— Ti je Tomi qibari, që do punë të zgjedhur! Nga tërë ato ndërhyrje unë kujtoja se kushedi çfarë burri do ishte, more drejt... Po pse s'të pëlqen të punosh në pusët ty, Tomi?

Tomi u skuq. Nuk dinte çfarë të thoshte.

— Ke të drejtë, — u tall kryetari, — me gjithë ata punëtorë që vriten çdo ditë në pusët, edhe trimi i trimave të ishte, do të trembeshe.

Tomi u mat të thoshte diçka, po kryetari u tregua më i shpejtë:

— Ti do të thuash që je me shkollë të mesme, kështu? Mirë. Edhe ne nuk themi jo. Fillo punë njëherë, të njihemi e, po të jesh djalë i mirë e punëtor, mundësi kemi plot. Edhe inxhinier bëhu, po të jesh i zoti. Ja, edhe unë son-dist kam qenë. Bile një herë, e di? Ika edhe nga puna... — tha kryetari, duke e ulur zërin në mirëbesim.

Pasi pa përreth, pyeti një punëtor:

— Lirim, mos e pe gjë Rudin? Këtu sikur ishte.

— Në magazinë është, shoku kryetar, — tha ai që quhej Lirim, një djalë me fytyrë pak si të zgjatur, me sy të përhimtë, me një llambë karbiti në dorë.

— Shkojmë, — tha kryetari.

Nga magazina po dilte një burrë i ri, i gja-

të, i hollë e flokëverdhë. Pas e ndiqte një djalë që Tomi e njihte, Çimi. Ky kishte në duar një sharrë dhe një letër të trashë ambalazhi me gozhdë të gjata trarësh.

— Rudi, ç'kemi?

— Ç'të kemi, shoku kryetar. Mora ca gozhdë.

— E kishit përmbysur në dasmë të Seriut, — tha kryetari.

— Oj, të përmbysur! S'i thonë kot, një mar-tohet, njëqind tërbohen. Jemi industri e rëndë ne, bëjmë vend kudo që shkojmë. Kur s'ade-nje deri në fund, o kryetar.

— Pusi sa ka arritur?

— Pothuaj gjashtë metra.

— Hë, si duket?

— Doli i mirë. Ka një rërë të larë fare.

— Ashtu? Dëgjo tani, ky djali do të punojë me ty derisa të kthehet Seriu. Është djalë i mirë, prandaj ta bësh punëtor të mirë. «Erdha të punoj ku të keni nevojë ju», kështu na tha.

Rudi ia shtrëngoi dorën fort. Tomit i dhemb-i pëllëmba e gati u shtrembërua nga dhembja.

Ata u nisën. Tomi mori sharrën dhe e hodhi në sup. Sec provonte në shpirt, tek ndiente në sup sharrën: inat, mërzi, shqetësim, lehtësim e gëzim bashkë. Dhe sa e lehtë paskësh qenë biseda me kryetarin. Sa mirë që s'u për-mend ajo puna e mesatares së mallkuar, që e bënte Tomin të skuqej deri te rrënjët e flokëve sa herë binte fjala për të. Në njëfarë mënyre për disa ajo ishte bërë treguesi i vetëm për një të ri: E kishe mesataren nëntë pikë tetë, ata të shihnin me admirim, të respektonin edhe po të mos të të njihnin, të merrnin shembull kudo në lagje, të vishnin edhe ato merita që s'i kishe.



Ai që e kishte mesataren të ulët, ishte i shtrënguar të ulte kokën, të skuqej nga turpi, të shihej vëngër e nganjëherë me dyshim, si një njeri pa asnjë vlerë. Cilësitë e tjera eklipsoheshin. Asnjë nuk donte të dinte që ti ishte një zdrukthëtar duarartë, një atlet me të dhëna premtuese apo një letrar i talentuar. Kjo punë arrinte ndonjëherë në ekstrem, saqë ndonjë prind këshillonte djalin apo vajzën të mos e trashte shumë muhabetin me aksh vajzë apo djalë, me argumentin e tmerrshëm të mesatares së ulët. Tammam për këtë arsye edhe Tomi kishte filluar të ndiente një urrejtje instinktive e të turbullt ndaj notës mesatare. E ja tani ku kishte takuar një kryetar, i cili as që kishte çarë kokën për të. Me sa dukej edhe kryetari vetë nuk duhej të kishte qenë ndonjë yll në mësim.

Po shkonte në punë. Si do të ishte puna vallë? E lodhshme? E vrazhdë? Po ky Rudi, ustai i tij, si do të ishte? Si ia shtrëngoï dorën! Në të parë nuk duket burrë i keq. Ja, edhe Çimi rri fare lirshëm.

— Edhe sa të mbetën, more djalë? — pyeti Rudi.

— Si edhe sa më mbetën. Unë sot fillova, — tha Tomi.

Rudi qeshi me gjithë zemër. Edhe Çimi u gajas.

— Edhe sa gjemi të kanë mbetur pa mbytur, desha të them, — tha Rudi me sy të përlotur.

— Duhet të kesh kujdes me këtë ustanë tonë, — tha Çimi, — se ta hedh kur s'e ke mendjen.

Tomi filloi të ndihej pak më lehtë. I tha se si quhej e diçka rreth vetes së tij. Ndërkaq arritën te vendi i punës.

— Ky është pusi, — shpjegoi Rudi. — Hapet për të parë a ka shtresa rëre dhe sa të trasha janë. Puset mund të shkojnë edhe mbi dhjetë metra, po zakonisht shkojnë më pak se dhjetë. Pasi arrihet thellësia ku s'ka më rërë, pusi mbushet prapë, që të mos bjerë ndonjë njeri natën.

Pusi qenkësh pothuaj si puset e zakonshme të ujit, veçse më i gjerë, i rrethuar me armaturë trarësh e dërrasash të trasha. Mbi të kishte një çikrik të trashë druri me doreza katërshe nga të dyja anët e me një kavo të hollë në mes, që ngrinte e ulte kovën. Njëri krah i çikrikut ishte i thyer.

Çimi nisi të rrëmonte me këmbë grumbullin e rërës e që andej nxori të fshehur një sqepar, një lopatë të shkurtër e dy baromina.

— Na u thye dje nga minat, — shpjegoi Rudi dhe filloi me sharrë e sqepar të ndreqte çikrikun.

Tomi nuk fliste. Mendohej. Shokët e tij tani ishin në universitet. Ndoshta dëgjonin me vëmendje leksionet, ndoshta ishin në aksion. Këtë vjet do të shijonin jetën e studentit. Studime, provime e shqetësime plot, por edhe kinema, stadium e mbrëmje vallëzimi. E ai, i futur në atë vrimë që quhej pus, do hapte si urithi vrima të reja për puse të tjera, derisa të shkonte ushtar. Ç'grusht të fortë kishte ngrënë nga jeta!

Tomi preku me gishta nofullën, sikur t'i dhimbte vërtet. Kurrë nuk do të ndihej i barbartë me shokët që kishin shkuar në shkollë. Gjithmonë do të mbetej një copë punëtor mi-niere, ndërsa shokët e tij do të bëheshin inxhinierë, eprorët e tij.

Ndjeu ta kapte ngashërimi. Kohët e fundit prekej lehtë. U bë i mbyllur, aq sa filloi t'i videshej edhe takimit me shokët. Dy-tri herë i ishte shmangur edhe Vjollcës. Rrinte brenda në shtëpi e rrallë dilte jashtë. Ishin ditët e fundit të gushtit; ato ishin tortura e tij. Shokët përgatitnin valixhet, ai rrinte ngujuar. Kur i shihte, i përshëndeste nga larg ftohtë dhe nxitonte të largohej. Ditën e fundit ndeshi Vjollcën.

— Të kapa, — i tha ajo. — Ka tri ditë që dua të të takoj e s'të gjej dot. Ç'ke kështu, Tomi? Pse më fshihesh?

— Asgjë. E çfarë tjetër të kem? — tha ai.

— Sesi je bërë. Je hidhëruar shumë që s'të doli e drejta e studimit?

— Mbase ty që e hodhe lumin të duket gjë e vogël kjo, — tha Tomi me mllef. — I vdekuri i botës duket sikur fle. Nejse, mua më fal tani. Nxitoj për diku. Lamtumirë!

Ai u mat të largohej, po Vjollca nuk e la:

— Jo, qëndro këtu. Dua të bisedojmë. — Zëri i saj ishte i vendosur.

— Ah, po, — tha Tomi si të ishte kujtuar për diçka. — Duhet thënë të gjitha. Mirë pra, a s'do të ishte më mirë të harronim edhe atë historinë tonë fatkeqe? Është më shumë për të mirën tënde.

Vjollca i hodhi një vështrim të gjatë e therës:

— Si t'i nxë goja këto fjalë, Tomi?

Ai heshti, me sytë përdhe. Pastaj me vendosmëri tha:

— E ç'ti bëjmë qejfin vetes me llafe të bukura, Vjollca? Rrugët tona u ndanë. Një mjeke që ka për burrë një punëtor, një minator. A s'të duket e çuditshme?

— Ne, kur i thamë «po» njëri-tjetrit, nuk bëmë ndonjë kontratë tjetër përveç ndjenjave tona, — tha Vjollca duke u munduar të zotëronte veten.

Tomi e pa drejt në sy:

— Këto janë fjalë filmash, Vjollca. Por jeta të bën esëll në një mënyrë jo fort të këndshme. Edhe ti vetë ke për të qeshur me këtë histori.

— Nuk do qesh kurrë. Vendimin nuk e ndryshoj.

— Atëherë më duhet ta ndryshoj unë. Të tërhiqem unë nga fjala. Më kupto drejt, nuk dua që ti të skuqesh për burrin tënd punëtor e as mua nuk më pëlqen të jem përpara gruas inferior. Ika.

Tomi nxitoi të largohej. Ishte i sigurt se edhe disa sekonda dhe do t'i shkisinin lotët.

— Unë do të të shkruaj! — dëgjoi pas vetes Vjollcën t'i thërriste.

Të gjitha këto i kujtoheshin tek rrinte atje, mbi rërën e lagësht. Mirë t'i bëhej. Jo gjashtë metra po gjashtëdhjetë ta futnin. Vetë e kishte fajin e tani le të vuante.

Papritur ndeshi sytë e Çimit që po e vështronin me dashuri. Tomi e mblodhi veten. Kushedi ç'pamje për të qarë hallin kishte marrë. Ja sa poshtë kishte rënë: të mëshirohej nga Çimi.

— Pse sheh?

— Të shihja ty e m'u kujtua vetja, — tha me zemër në dorë Çimi. — Edhe unë si ti mendohesha ditën e parë: si do të bëj këtu, si do punoj, a do të rezistoj? Po tani s'iki. Mos ki merak, do të mësohesh.

Tomi dëgjonte e mendohej t'i kthente së prapi ato që thosh Çimi: «E di, mor vëlla, e di që s'ikën. Ta ka zënë rrota bishtin e s'lëviz, po

sikur të të linin, ikje natën e jo ditën ti.»

Ndërkaq Rudi e ndreqi krahun e çikrikut.

— Hajde, ngrihuni, djema, se na zuri dreka.  
Kapeni!

Të tre e vendosën çikrikun në dy mbështetëset. Pastaj Rudi hyri në kovë e ata e ulën me ngadalë poshtë. Tomi shtrëngonte me fuqi e me frikë krahët e çikrikut. Ajo që po bënte, i dukej një gjë e jashtëzakonshme. I dukej sikur po ulte dikë në varr. Po sikur t'i shpëtonin duart e kova të binte në fund?

Rudi filloi të punonte me lopatën e shkurtër; e mbushte kovën me rërë e ata e ngrinin lart. Kova e parë Tomit iu duk e lehtë. Por kovë pas kove puna filloi t'i dukej e rëndë e ai nisi të gulçonte e të djersinte. Lëkura e pamësuar e duarve iu nxeh e iu rrop nga doreza e re e palatuar. Çimi i tha të ndërroheshin, meqë duart e tij ishin të mësuara, po Tomi kundërshtoi me kokëfortësi.

S'e bënte veten dhe punonte në heshtje, si një njeri që ka marrë vendim të vetëndëshkohet. Kapte mekanikisht dorezën e çikrikut dhe e tërhiqte me forcë, pastaj kapte tjetrën. Bluante mendime e vetëm me trup ishte atje. Papritur doreza i shpëtoi nga dora, çikriku u rrotullua një xhiro praptas e kova u lëkund e u përplas pas armaturës së pusit, duke rrëzuar disa grushte rërë poshtë. Ajo ra me zhurmë mbi kokë e mbi kurriz të Rudit.

Ai ngriti kokën, vështroi lart dhe e kuptoi menjëherë se kush e kishte fajin. Megjithatë thirri:

— **Ku e ke mendjen, Çimi? Hap sytë e ki kujdes në punë!**

Edhe Çimi s'u përpoq ta mbronte veten, me-

gjithëse faji s'ishte i tij. Tomit i erdhi rëndë e u skuq deri te rrënjët e flokëve. Shtrëngoi fort dorezat e ashpra të çikrikut dhe nisi t'i jepte më me forcë.

Rëra në pus u mbarua. Rudi hipi në kovë dhe e nxorën jashtë. Ai u ul mbi një dërrasë, nxori ngadalë paketën, vuri një cigare në buzë dhe ua zgjati edhe djemve. Çimi mori, Tomi falënderoi. Nuk e pinte.

Pasi pinë cigaret, Çimi e Tomi u ulën me çikrik poshtë, morën barominat dhe filluan të hapnin birat e minaye. Formacioni i tokës ishte i shkrifët e birat i hapën me lehtësi. Dolën në sipërfaqe. Dielli vjeshtak ishte ngritur lart, aq sa mund të ngrihej në fund të shtatorit, në kohë dreke. Hapën çantat.

— Bre! — u çudit Rudi. — Një rosticeri të tërë paske marrë, sikur do këputej kova e do të mbeteshe brenda në pus.

— Merrni. — Tomi u dha atyre nga një copë sallam.

Rudi këputi një copë byrek nga i tij dhe ia vuri përpara, Çimi i hodhi një mollë.

Si hëngrën drekë, erdhi minatori, një burrë rreth të dyzetave, me një çantë të madhe meshini të mbushur me dinamit.

— Hë, ia thatë drekës? — pyeti ai sapo uli çantën.

— Ia thamë, o Myfit, — tha Rudi për të tre.

— Po ky djalë? Si je, more djalë?

Tomi u ngrit në këmbë dhe e toku.

— Erdhi në vend të Seriu. Seriu bën mua-jin e mjaltit. Kështu thotë Çimi, — foli Rudi.

— Çimi e ka gojën, s'ka nevojë për sufler, — i doli zot vetes Çimi.

Myfiti mbushi birat me dinamit, u vuri zja-

rrin fitilave, e ngjitën me të shpejtë lart dhe me nxitim u larguan.

Pasi pritën disa çaste, gjëmuan minat. Tri u dëgjuan mbytur e shurdhër, e katërta shpërtheu fort.

— Kjo po! — lëvdoi Tomi minën e fundit.

— Jo, — e ndërpreu Çimi, — ato që pëlca-  
sin fort, bëjnë më pak punë. Tri të parat po,  
— shpjegoi ai. — Sa më të shurdhëta e sa më  
të mbytura të jenë, aq më shumë punë bëjnë.

— Nc, nc, nc, gjë e zgjuar ky Çimi. — tha  
Rudi me shpoti. — Po e la bryma e të ketë ditë  
të bëhet, edhe Myfitit do t'ia kalojë.

— Ty s'ta kaloj dot, ti i bie tri herë dërra-  
sës e një herë gozhdës, — ia pati Çimi duke  
zbardhur dhëmbët.

Edhe Rudi qeshi. Pastaj tha:

— Fshihini veglat, djema!

— Pse? — pyeti Tomi.

— Si pse? Puna për sot mbaroi. Mirupaf-  
shim nesër.

Tomi shkoi në shtëpi pak më i lehtë se në  
mëngjes. Ishte lodhur vërtet, por dialli nuk pas-  
kësh qenë aq i zi sa e tregonin. E ëma i doli  
përpara me përkëdhelje e përmallim, sikur të mos  
e kishte parë prej ditësh.

— Hë, Tomi, si dole, të keqen, a u lodhe, si  
ishte puna? — lëshoi një breshër pyetjesh ajo.

— Mirë, — tha Tomi dhe u ul.

— A është rrezik, sa metra thellë të futin,  
a duket drita e diellit, a ka ajër të mjaftueshëm  
atje brenda, a rrjedh ujë? — vazhdoi të pyeste  
ajo, pa pritur përgjigje. — Të të vë për të  
ngrënë?

— Jo, — tha Tomi e, pasi hoqi këpucët dhe  
u la, u shtri në krevat.

— Të dhemb gjë? — e pyeti prapë e ëma, aq sa Tomi e humbi durimin.

— Jo, po më lër të qetë. — I kishte zët pekulet.

Futi duart nën zverk e me shikimin në tavan zuri të mendohej. Ja dita e parë e punës. Ai na qenkësh pusi i famshëm, aq i frikshëm për nënën. Sa i dhimbte kurrizi. Si të bënte për nesër, të shkonte apo të mos shkonte? Edhe duart zjarr i kishte. Ç'do të thoshte Rudi, po të mos shkonte nesër? «Buzëqumështi, djali i mamasë», do të thoshte patjetër. E, po të mos shkonte, ç'të bënte në shtëpi? Të lexonte romane? Po romanet s'të japin të hash. Ç'tip që qenkësh ai Rudi dhe sa me takt. Shau Çimin, megjithëse e pa mirë që rëra u rrëzua për faj të tij. Edhe ai Çimi s'iu duk djalë i keq. Mirë thonë që njeriu në punë njihet më mirë se kudo tjetër.

Trupin e kishte të lodhur. Duart i digjnin nga dorezat e çikrikut, sidomos nga ajo e reja e palatuar. Gjumi e kapulloi dhe nuk ndjeu të emën që i hodhi me kujdes një kuvertë.

Të nesërmen Tomi mori vetë rrugën për në punë. Ishte vonë, ndaj shpejtoi hapin. Sa e bezdisshme bëhej e ëma me gjithë ato përkujdesje, sikur ai të ishte fëmijë kopshti.

Rruga gjarpëronte përmes një blloku vreshtash. Gjethet e rrushit kishin filluar aty-këtu të zverdeshin, duke paralajmëruar kështu vjesh-tën. Mezhdat midis vreshtave ishin mbjellë me mollë, qershi e gështenja. Tek-tuk në largësi të madhe dukeshin drurët madhështorë e të gjelbëruar të arrave.

Diku, disa metra larg, rrëshqiti e trembur një dhel për e kuqërremtë, që mori përruan përpjetë me vrap të lehtë, sikur rrëshqiste. Tomi s'kishte



parë ndonjëherë dhelprë të gjallë, ndaj qëndroi dhe e ndoqi me sy derisa dhelpra u zhduk pas një gëmushe. Ndenji disa çaste ashtu. Iu kujtuan përrallat e vegjëlisë. Në to ajo paraqitej si Zonja Dhelprë, me përparëse të bardhë e shall rreth qafës, me zë të ëmbël dhe dinake si vetë ajo.

Shpejtoi hapin. Nga larg pa të ulur buzë pusit, me peliçe hedhur krahëve, Rudin dhe Çimin, që diç tregonte.

I erdhi zor që po e prisnin. Përshëndeti me gjysmë zëri dhe qëndroi në këmbë të dëgjonte kritikën e tyre. E kishte shkelur që ditën e parë. Dukej se sa me qejf e kishte marrë punën. Priti të dëgjonte Rudin kur t'i fliste ashpër e t'i thoshte që, në i pëlqente, le të rrinte, në mos po, he, le të ikte. Njeri me zor nuk mbanin.

**Dhe Rudi foli:**

— Ulu, Tomi, dhe dëgjo! Qenka shumë interesante! Demek, Çimi, ai mjekërcjapi ishte agjent, hë? Hë ia hëngsha t'ëmën!

Rudi dëgjonte me gojë hapur. Nga fjalët e Çimit Tomi e kuptoi se ai po i tregonte filmin që kishte dy ditë që po shfaqej në kinema.

— Unë, o Tomi, — foli Rudi, kur Çimi mbaroi, — i kam shumë qejf filmat e librat. S'ngopem së dëgjuari, sikur edhe një javë të më rrëfejnë. Vetë nuk lexoj dot, se aq shkollë kam. Matem të lexoj ndonjëherë, po, do ti, më rëndohen kapakët e syve, plumb më bëhen e më zë një gjumë që ç'të të them.

Tomi dëgjonte me buzëqeshje. E kishte harruar druajtjen.

— Hë, të isha unë, — tha Rudi, — ta përfshija për mjekre, pa të shihte.

Rudi hodhi tej bishtin e cigares dhe urdhëroi:

— Tani, djema, në punë! Në drekë e ka radhën Tomi.

Puna ishte ajo e djeshmja. Rudi zbriti në pus e ata ngrinin me çikrik rërën. Pastaj hapën birat dhe u ulën për drekë.

Tomi zuri të tregonte ashtu siç e kishin lënë me fjalë në mëngjes. Fliste ngadalë e si me druajtje, po, **kur pa që Rudi e Çimi dëgjonin me vëmendje, mori guxim, filloi të tregonte më me hollësi, duke bërë edhe ndonjë përshkrim. Duke treguar, ndeshte sytë e Rudit dhe mahnitej me të. Ç'dritë që kishin ata sy! Ishin dy sy ku buronte një kureshtje e fortë, gati fëmijërore. Goja i kishte mbetur paksa e hapur, si me habi, e cigarja e harruar tretej ngadalë, sa mend ia digjte gishtat e trashë.**

— Demek, ky Kuazimodoja na qenkej një ibret i botës! Nc, nc, nc, — përplaste gjuhën me cudi. — **Po pastaj?**

Dhe Tomi niste e tregonte prapë me frymëzim të ri.

Rudi rrinte për një kohë të gjatë në hesh-tje, duke thithur cigaren i menduar e pastaj thoshte:

— Sa gjëra ka kjo botë, sa gjëra! Prandaj edhe i them Çimit: «Shko në shkollë të natës, o Çimi, mos rri kështu, gdhë si unë». Ishte tjetër kohë ajo kur ishim të rinj ne. S'ngopeshim me bukë. Po sot është gjynah të mos kesh kulturë, të mos dish dy llafe për hënën a yjet. I sheh përnatë, po ç'janë? Hë, më thuaj, o Çimi? Ja, vështro si zgërdhiet. Zgërdhiet se s'di, prandaj. Zgërdhihu, o Çimi, zgërdhihu, pa do t'i biesh kokës më vonë. Lëre topin. Edhe ai ka një karar Po, vërtet, Tomi, thonë që Hëna është sa një lëmë. Të jetë e vërtetë? Po ata që vajtën në Hënë

si e shihnin tokën? E zgjatnin kokën dhe shihnin poshtë? Si mbahen e s'bien përdhe Hëna e yjtë? — pyeste Rudi dhe sheshohej edhe më mirë, që të mos i shpëtonte asnjë fjalë.

Tomi ia shkreppte të qeshurit nga pyetjet naive e me humor të Rudit dhe zinte t'ia shpjegonte. Niste kështu një mësim astronomie.

— Shkolla është gjë e madhe, të hap sytë, — përfundonte Rudi.

Ditët kalonin një nga një e Tomi gjithnjë e më tepër provonte një ndjenjë të re kur shkonte në punë. Ata njerëz i kishin hyrë në zemër me thjeshtësinë, me dashurinë e tyre, madje edhe me kureshtjen e tyre për të mësuar diçka nga librat. Ndërsa Tomi mësoi nga ata të njihte llojet e ndryshme të rërave, cilësinë e tyre, mori njohuri për shtresat e formacionet, se si armatosej një pus, si vendoseshin minat e plot gjëra të tjera. Një ditë zuri të latonte me sqepar dorezën e re të çikrikut. Rudi, i ulur disa metra më tej, tek e vështronte ashtu, buzëqeshi e, duke thithur cigaren, i tha Çimit:

— Shenjë e mirë kjo, o Çimi. Do na rrijë Tomi, — dhe qeshi.

— Pse qesh? — pyeti Çimi, sepse i dogji diçka.

Rudi qeshi prapë, kësaj here me zë. Tomi ktheu kokën dhe la punën.

— Dëgjon ti, Tomi? Të shihja duke rregulluar dorezat e çikrikut e m'u kujtua Çimi këtu e dy vjet më parë. Kur erdhi në fillim, ç'ta shihje: me pantallona të gjera, me atë rrip të trashë, me ato leshra të gjata, ja, mu si Kuazimodoja.

Tomi qeshi me gjithë shpirt. Edhe Çimi buzëqeshte si me turp.

— Po zemrën e kishte të mirë, ama, si të

Kuazimodos ... Në fillim hidhte vickla. I erdhën edhe nja dy shokë, deshën t'ia ngrinin mendjen. U tregova grushtin, i përzura. Një muaj të tërë me barominë të pakalitur punoi derri. Unë s'i bëja shamatë. Një ditë, kur do iknim në shtëpi, ky birbo i mori edhe barominat me vete. «Ku i shpie?» e pyes unë. «T'i kalit, s'e sheh si janë bërë?» Që atëherë ky Çimi është bërë një deli djallë, ja, si kjo rëra e pastër dhe e larë që gjejmë ndonjëherë. Pa do ta martojmë ...

Çimi u gajas së qeshuri.

— Të vjen mirë, hë? Zbardhi dhëmbët, zbardhi, po, po s'u fute në shkollë të natës, as qurrat s't'i hedhin vajzat. S'duan burra pa shkollë ato. Ç'të të bëjnë? Të të kripin?

Një pasdite Tomi nuk shkoi drejt e në shtëpi. U kthye nga zyrat e ekipit gjeologjik. Hyri në korridor dhe trokiti në derën e zyrës. Pasi dëgjoi t'i thoshin të hynte, hapi derën.

— Urdhëroni, — tha kryetari nga tryeza.

Në zyrë ishin ulur e po rrinin edhe dy-tre të tjerë.

— Urdhëroni, hyni, — e ftoi prapë kryetari. Tomit i erdhi zor nga burrat që ishin brenda:

— Kisha një fjalë me ju. Dua t'ju them këtu jashtë. Në qoftë se ka mundësi ...

Kryetari u ngrit dhe doli në korridor.

— Ç'është? — pyeti ai dhe u ngrys pak në fytyrë. I porsaardhuri ndoshta do t'i kërkonte ndonjë favor.

— E dini si është puna, shoku kryetar? Kisha një lutje ... do t'ju lutesha ... të më linit me Rudin, në pusët. Sigurisht, në qoftë se ka mundësi të bëhet, — tha Tomi me një zë të dredhur, sikur po kërkonte t'i bënin një nder.

## Ajo fjalë!...

Sa e vështirë qenka të pëshpëritësh atë fjalë! Këmbët të priten, duart të dridhen e zëri të meket sikur gjuha s'është më jotja. Ndoshta është e vetmja gjë, ku trimëria të lë në baltë, pëshpëriti shoku im, kurse mua m'u kujtua Irena në vitet e shkuara të gjimnazit.

Zhurma e shurdhër e valëve të detit atje tej duket si fëshfërima e fletëve të një libri, nga i cili duam të rilexojmë diçka të dhimbshme e të përmallshme. Dëgjoj shushurimën e tyre dhe filloj të shqiptoj me mendje bashkë me to atë fjalëz, të cilën nuk e thashë kurrë me zë të lartë: «Të dua, Irenë!» Zhurma e valëve përsëritet ritmikiht, sikur edhe ato të pëshpëritin me zë të ulët, të shurdhër e të mistershëm: «Të dua, Irenë, të dua, Irenë!» Një përmallim i lehtë më bën të psherëtitij e vetvetiu më ngacmon një pyetje, e cila s'më lë të qetë sa herë që e kujtoj atë vajzë: «Ç'ishte për mua Irena? Një realitet? Kanë kaluar kaq vite e unë tani s'mund t'i përgjigjem

saktë kësaj pyetjeje. Më lehtë e kam të pranoj se ajo ka qenë një ëndërr e bukur e rinisë sime të parë.

Koha bën të sajën e mbase tani Irena është martuar. Përpiqem ta përfytyroj të ndryshuar e të rritur, mbase me një bebe në krah, por s'mundem. Gjithmonë më del para syve ajo vajza trup-hollë, me përparëse të zezë e jakë të bardhë.

Për Irenën ai ishte shtatori i parë, për mua i treti. U takuam ballë për ballë në korridor, sa mend u përplasëm. Mbetëm të stepur të dy, si të verbuar nga një dritë e fortë. I hapëm udhë një-ri-tjetrit, e mua më mbeti në mendje vështrimi i syve të saj. Hyra në klasë duke marrë me vete dritën e tyre. Gjatë mësimit sepse më pëlqente të kujtoja e të rikujtoja sytë e saj.

Kalojnë ditë e unë e shoh shpesh atë. Ajo është nga një fshat i largët e piktoresk, me nam për bukurinë e tij. Si padashur këmbët më shpien nga klasa e saj dhe unë habitem kur e kuptoj këtë. Sa herë e shoh, ndiej që turbullohem. Kjo më zemëron e mundohem të sillem natyrshëm e i shpenguar, por këto përpjekje s'bëjnë gjë tjetër, veçse e theksojnë edhe më shumë turbullimin tim.

Shpesh, gjatë studimit, midis rreshtave dhe ekuacioneve, më dalin sytë e saj të zinj. Mundohem t'i largoj, po nuk është e mundur. Vështrimi çapkën sikur më përqesh e tallet me mua, sikur më thotë: «S'na përzë dot, s'na përzë dot!» Mendimet më rrëmbejnë e një zhurmë më sjell në vete: libri më ka rënë nga dora përdhé. Mbyll librin dhe pyes i turbulluar: «Ç'është kështu me mua? Ç'po ndodh? Ndiej se më mungon diçka, se kërkoj diçka, por as vetë nuk e di se çfarë. Në zemër kam një pështjellim e më lind dëshira të ëndërroj, të këndoj, të bëj diçka të mirë, ndërsa një

zë i brendshëm e i heshtur më thotë: «Ti e do atë!»

Vjen dimri dhe dëbora e parë zbardh kudo, me tërë bukuritë e saj. Mbaron ora e fundit e mësimit dhe vajzat vrapojnë duke lëshuar klithma të hareshme. Një breshër topash i ndjek pas. Edhe unë kam bërë një top, që e mbaj në dorë. Nuk gjuaj, megjithëse gishtat më mpihen së ftohtit. E ruaj për të. Ja, ajo del e vrapon si shoqet. Drejtohet nga unë, pa më vënë re, me kokën futur nën jakë. Ngre dorën lart dhe ... ajo më gjuan e para me vështrimin e syve të saj. Buzëqesh nën hundë e mua buzëqeshja e saj më çarmatos. Dora më mbetet pezull. E megjithatë e qëlloj. Sa dashuri ka brenda ai top!

Dëbora thërrmohet nëpër flokët e saj të zinj dhe unë e dëgjoj të pëshpëritë: «I lig, i lig. S'të vjen keq fare!» Por unë jam gati të vë dorën në zjarr që në zërin e saj s'ka asnjë notë zemërimi. Sytë e zinj ia përshkëndit nuk di çfarë drite, që i bën ata të qeshin aq sa unë nuk mundem ta shoh në bebëza. Ajo buzëqesh, ndërsa unë s'di ç'të bëj më tej: t'i gjuaj prapë, apo t'i them ndonjë fjalë. Aty-këtu, nëpër flokë, i kanë ngecur copëza dëbore që mua më ngjajnë herë me petale lulëshqerrash e herë me zambakë të bardhë uji.

Dikur njihemi. Që nga ajo ditë ajo gjithmonë më përshëndet, duke më parë drejt në sy, me atë vështrim të ngrohtë, diçka më tepër se miqësor.

Vjen një kohë kur për mua dita ka kuptim vetëm kur e shoh atë. Një ditë i them vetes: «E gjithë kjo mos e ka emrin dashuri? Atëherë duhet t'ia thuash vajzës atë që ndien për të. Nuk është krim të dashurosh një vajzë».

Ditët kalojnë, akujt shkrihen e ujërat gurgullojnë. Ngado dëgjojen zërat e natyrës që po

zgjohet, të hareshëm si tingëllima e mijëra zil-kave. Diku, rrëzë mezhdave, karshi diellit, kanë nxjerrë gjethëzat manushaqet e lulekaçet. Kudo ndihet prarimi i pranverës. Një degëz kajsie ka çelur me druajtje lulet e para. Ajo lëkundet lehtë, sikur shtriqet, e zgjuar pas një gjumi të gjatë, e habitur nga magjia e pranverës. Puhiza e ngrohtë i fryn e dega me lule fërgëllon e rrëqethet sikur të jetë me shpirt.

Janë net maji. Jashtë fryn erë e ngrohtë dhe e vrullshme, era e luleve. Unë rri në shtrat, i pagjumë, dhe dëgjoj zhurmat që jehojnë nëpër fushë. Përzihen tingujt e një kënge të largët me uturimën e një traktori. Ndoshta atë këngë e këndon një djalë dhe ndoshta një vajzë e pagjumë e dëgjon. Dy sy ndritin në terrin e natës së vakët e dy buzë pëshpëritin dhe buzëqeshin në hesh-tje. Zëri i përmallshëm i djaloshit vjen valë-valë. Një këngë dashurie e malli përzier bashkë:

... Sikur ta dish, moj vajza ime,  
ç'zjarr i madh më djeg për ty ...

Kënga bashkohet me flladin e vakët dhe hyn në dhomë. Provoj një ndjenjë të çuditshme, tundu-ese, diçka si ajo që aq bukur e ka skalitur De Rada në vargun e tij: «Bie, po s'dua të fle.» Ndoshta ka kaluar mesnata. Nga dritarja duket qielli, ku shkëlqejnë miliona yje të bardha e unë mundohem të shkruaj me yje emrin e saj.

Ardhjen e pranverës e ndiejnë edhe pemët e zhveshura krahëftohta. Fryma e saj e ngrohtë gjallëron edhe drurët e i bën të lulëzojnë e të zbukurohen me mijëra lule të bardha. Një dëshirë e pamposhtur më fton të ngrihem e të dal jashtë. Të eci nëpër kopshte, të shkopsit këmi-shën, të pres në gjoks flladin. Një zë i ulët më



pëshpërit në vesh: «Ngrehu, mos fli. Rend nëpër fusha, këndo edhe ti!» Ndaj gjumi më është arratisur e s'më zë në këto net të bukura maji. Përpëlitem në shtrat i shqetësuar e njëkohësisht i mrekulluar nga ky shqetësim i ëmbël: «Ç'të jetë, vallë? Pse s'mundem t'i largoj dot ata sy? Dhe pse më pëlqen t'i shoh gjithnjë? Ç'ke me mua, Irene? Pse s'më lë të fle?»

Qëndroj shtrirë, me sytë në tavan e duart në zverk. Zë të gjitha betë e botës se të nesërmen do t'ia them të gjitha. Le të bëhet ç'të bëhet!

I ngre pusí te rruga ku do të kalojë dhe rri e pres. Ja, ajo duket në krye të rrugës me çantë në dorë, e bukur dhe e brishtë si një lulemollë. Është e gjatë, e hollë, me flokë të zinj, të shndritshëm e të shëndetshëm, me lëkurë të bardhë e faqe të kuqe, sikur të jetë një copëz nga dëborat e bardhë e qershitë e kuqe të fshatit të saj. Në mjekër ka një shenjzë të vogël, kujtim nga femijëria.

Sa më shumë afrohet, aq më të shpeshta bëhen rrahjet e zemrës. Ndërkaq guximi më ka lënë dhe më vjen t'ua mbath këmbëve, por është vonë. Ajo më sheh me buzë në gaz e më përshëndet. Faqet i skuqen flakë dhe unë e kam të vështirë ta kuptoj: nga shëndeti apo nga gjë tjetër.

Matem t'i them ato dy fjalë të shkreta, po gryka më thahet, fjalët me ngecin në fyt, thua se më mungon laringu. Mezi i përgjigjem përshëndetjes së saj dhe vazhdojmë rrugën të heshur. I dëgjoj frymëmarrjen e nxituar. Irena dëgjon timen. Ajo e merr veten e para dhe buzëqesh:

— Çudi, ne gjithmonë këtu takohemi. Ç'ras-tësi!

Thotë kështu dhe hesht. Faqet i marrin

ngjyrë trëndafili. Ecim dhe heshtim. Më vjen të thërres, ta kap nga bërryli, ta kthej nga vetja e t'i them: «Të dua, Irenë, a s'e kupton? Unë të dua!» Por hiç. Ecim dhe heshtim. Unë e ndiej, ajo pret. Po a jam nga ata burra unë?

Hyjmë në shkollë. Para se të ndahemi, ajo më kërkon stilografin. Ia huaj duke ia kuptuar hilen. Unë e di: ajo ka stilograf, por do të ketë një shkak më shumë për të më takuar. Irena hyn në klasë, kurse unë mbetem në korridor, duke u brejtur me veten. Më vjen të pëlças: edhe sot në vendnumëro!

Në pushimin e madh dalim në oborr. Vë re me bisht të syrit ku zë vend Irena me shoqet. Pastaj u propozoj shokëve:

— Shkojmë këtej. Është më ngrohtë.

Shokët s'ma prishin, megjithëse nuk e kuptojnë pse pikërisht andej është më ngrohtë. Ne kalojmë pranë vazave e unë fshehtas hedh sytë tek ajo. Vështrimet tona takohen. Një nënqeshje e lehtë, që më shumë e ndiej se e shoh, i endet në buzë e në sy. Ndoshta edhe ajo ka qejf të më vështrojë vjedhurazi. Ç'tinëzare që është kjo Irena!

Koha kalon. Ndërkaq kam ndryshuar, sa as veten s'po e njoh. Jam bërë i ndjeshëm, më prek çdo gjë, një melodi e bukur, një mbrëmje e kthellët me hënë, kur në fushë këndojnë bulkthat. Kam dëshirë të vë në ballë dritën e blertë të një xixëllonje, por më dhimbset ajo. As vetë s'e di kush ma ka zbutur zemrën kështu mua, harrakatit të dikurshëm. Ditët kalojnë, e unë s'mundem t'ia them. Gjithnjë ngushëllohem dhe shpresoj tek e nesërmja. Edhe ajo e pret me padurim ditën tjetër; a do t'i them gjë, vallë, të nesërmen? Ndërkaq ditët e javët vrapojnë. Vjen dita e fundit. Unë kap vështrimin e Irenës. Në

të shkruhet një brengë e fshehtë, që pyet: «Kur? Pse?» Ndërsa unë vështroj si budalla e s'di ç'të them.

Të nesërmen ajo, me valixhe në dorë, futet në autobus, kurse unë, gjoja rastësisht, i kaloj pranë dhe e takoj nga dritarja. Sytë e saj pyesin me ngulm «Kur? Pse» e unë i them po me sy: «Në shtator, në shtator. Patjetër.»

Autobuzi niset. E, ndërsa ikën, degët plot gjethe të pemëve fërfëlljnë nga era, sikur e përshëndetin me tundje dore bashkë me mua e i thonë: «Mos harro shtatorin, dikush këtu të pret». Dora e saj valëvitet në erë. Unë e ndiej akoma ngrohtësinë e vështimit të saj dhe ngashërimi më shtrëngon fytin. Lotët më djegin në sy e zemra më rreh me forcë, teksa autobusi largohet.

Vetëm unë e di si kalojnë muajt e verës. Vjen një shtatori e oborri i shkollës merr jetë përsëri. Banorët e tij, përjetësisht të rinj, kthehen nga pushimet e verës plot gjallëri e plot përshtypje. Edhe unë jam në mes të shokëve. Bisedoj e qesh me ta, por sytë e mendjen i kam gjetkë. Çudi, ajo s' duket gjëkund. Mos bën shaka me mua? Të nesërmen, gjithashtu. Ndërsa të pasnesërmen mësoj se familja e saj është transferuar në një qytet të largët, diku në Veri.

... Shoku im hesht i menduar. Hesht edhe unë. I jap të drejtë në heshtje dhe i vë veshin zhurmës së valëve. Shushurima e tyre duket sikur vazhdon të pëshpëritë me zë të ulët, të shurdhër e të mistershëm atë fjalë, të cilën unë kurrë s'e thashë me zë të lartë: «Të dua, Irenë!»

## Jorgoja

Kisha vetëm një javë në Voskopojë. Emërimi më pëlqente, sepse jam tip kureshtar dhe më tërheqin shumë gjërat e vjetra e antikat. Që përpara se të shkelja atje, po shijoja kënaqësinë e të vizituarit të kishave e rrënojave të qytetit dikur të begatë të Voskopojës. Shëtitja rrugëve të fshatit me atë huqimin apo përumbjen në të cilën bien turistët kur vizitojnë një vend me të kaluar historike të dëgjuar. Më bënte përshtypje çdo gjë. Rrugët e kalldrëmta, çezmat ujëftohta, shtëpitë e forta prej guri e veçanërisht rrënojat me gurë të gdhendur e të bardhë. Kambanaret e kishave, monumente kulture të restauruara, sikur të futin në një botë tjetër e të nxitin përfytyrimin, të bëjnë të jetosh me mend në qytetin e dikurshëm të Voskopojës me akademi e shtypshkronjë.

Vjen pak e çuditshme të mendosh që pikërisht në atë rrugë ka ecur piktori David Selenicasi, në ato çezma është flladitur mjeshtri i madh

i afreskeve të manastireve të Voskopojës. Shihja një pishë të moçme e mendja më thoshte se ndoshta tamam ajo ia ka dhënë të Gjëlbrën piktorit, e malet e zhveshura të Hirtën.

Të nesërmen e paraqitjes në zyrat e kooperative, bashkë me Besën, agronomen e sektorit, dolëm parcelave për t'u njohur me tokat, kulturat bujqësore dhe me njerëzit. Voskopoja është vendosur në prehër të maleve. Tokën e ka ngastrangastra, mbështetur me murmbajtëse e çakëlle deri lart në Vllahinë. Mezhdave rritet një bar i trashë që s'e çan dot kosa, prroskave rrjedhin rrekeza uji të ftohtë që rritin luleshtrydhe erë-mira si ato. Pasi ëcëm për një kohë të gjatë, aq sa mua m'u ndezën shojet e këmbëve e buza më zuri shirit për ujë, ia luta Besës të shkonim në ndonjë burim a çezmë.

— Shkojmë te Çezma e Jorgos, — më tha ajo.

Unë, i prirë për gojëdhëna, e pyeta pse quhej ashtu e u përgatita të dëgjoja diçka që filli i humbte në kufijtë e legjendës e mbase do ishte ndonjë histori tragjike. Ç'të qe ky Jorgoja që ishte përjetësuar në atë çezmë të panjohur? Me siguri ndonjë heretik i përndjekur nga klerikët ose ndonjë kaçak që e kishte pasur limerin atje ose ndoshta ishte vrarë në atë vend. Hamendjet mund të më bridhnin ende të lira e frelëshuara. Ajo pamje që shihja nga lart, më nxiste fantazinë, po Besa, më zhgënjeu.

Jorgoja është një kampist, minoritar nga Dropulli, që banon në Tiranë. Vjen në Voskopojë për të njëzetetretin vit rresht e pothuaj është bërë vendali. E njohin të gjithë e i njeh të gjithë në fshat. Që kur ishte i ri, para Çlirimit, i kishte rënë një sëmundje e rëndë e mushkërive. Atë kohë nuk pati mundësi të kurohej. Pastaj filloi

lufta e sëmundja e tij përparoi aq shumë, sa në vitet e para të Çlirimit kishte arritur në gradën e fundit. S'la ilaç pa përdorur e mjek pa u vizituar, po të gjithë mblidhnin supet e hapnin krahet. Organizmi pothuaj i shkatërruar po rezistonte me forcat e fundit, kurse mjekësia mund të caktonte vetëm datën kur do të mbaronte kjo luftë. Dhe e caktoi. Njerëzit e qanë për së gjalli. Dikush i rekomandoi një vend të largët klimatërik, Voskopojeën, dhe ai, pasi s'kishte ç'të humbte më, shkoi.

Në Voskopojeë Jorgoja erdhi si një kufomë e gjallë, tregojnë ata që e mbajnë mend. Një çobani plak iu dhimbs djali i ri dhe e mori lart në stan. Kampe ende s'ishin hapur. Bëri një kolibe prej fieri të thatë mu në mes të vathës së dhenve. Aty binte, aty ngrihej djali i ri. Plaku kishte qëlluar njeri shpirtmirë e i dhembshur. Kurrë nuk ia reshti mishin e freskët, djathin, gjalpin e qumështin e dhenve. Po afrohej data ogurzezë e familja priste nga Voskopoja lajmin e kobshëm. Kaloi kjo datë e në vend të mandatës ata morën një letër nga djali, ku u shkruante se ishte disi më mirë.

Aty ndenji gjithë verën. Erdhi prapë verën tjetër, e prapë tjetrën. Pastaj u hap kampi i pushimit të punëtorëve. Ndodhi diçka e kundërt dhe e paparashikuar: Jorgoja nuk vdiq, perkundrazi vdiq sëmundja. Që atëherë ai vjen gjithmonë një ditë përpara fillimit të turnit të parë. Nëpër fshat qarkullojnë si anekdota fjalët e tij: «Po nuk erdha një ditë përpara fillimit të turnit të parë, dijeni: ose jam në spital, ose kam vdekur. Tjetër gjë s'më mban.»

Ka vite që ai s'ndihet si kampist i thjeshtë. Këtu është si në shtëpi. Për çdo vit ai rregullon ndonjë urë të vogël a çezmë, e njerëzit si pada-

shur e krejt natyrshëm ia vënë emrin «Çezma e Jorgos».

Këto më tregoi Besa, duke kalur nëpër monopatin që gjarpëronte midis mezhdash, anës parcelave ku tek-tuk bënte hije ndonjë pishë e vetmuar. U ulëm të lodhur e të djersitur afër çezmës së ndërtuar me gurë të gdhendur, me dy sofate anash.

— Qenke delikat si një muzikant e jo si agronom, — më ngacmoi Besa, tek më shihte duke gulçuar. — Mban erë auditor, s'je bërë akoma agronom i vërtetë.

Unë qesha. Besa ishte një vajzë me kaçurrela të zinj e të shkurtër. Flokët i shkëlqenin nga pastërtia. Edhe cipa e fvtyrës nga shëndeti. Po gishtat nuk kishin atë delikatesën e një intelektualeje. Ata ishin të fortë e lëkura e tyre disi e ashpër. Ndoshta ngaqë ajo punonte edhe vetë herë pas here, kur shkonte nëpër brigada.

Të nesërmen, në kohën e lirë, mendova të shkoja te Çezma e Floririt. Kisha lexuar për të një tregim të bukur, ndaj s'më pritej sa ta shihja. Pyeta disa fëmijë dhe mora monopatin që dredhonte në Veri të fshatit, mes rrënojave gjysmë të mbuluara nga bari i dendur e nga kumbullat që në Voskopoje rriten të egra me shumicë.

U vara poshtë në një përrua e dëgjova pak mënjanë degëve të dendura plot me gjethe të një shelgu të madh zhurmën e qetë të një pizge uji që rridhte. E mora me mend që kisha arritur. Bëra edhe ca hapa, tashmë në disa shkallë të bukura, që gjarpëronin e u gienda përpara Çezmës së Floririt, të zhytur në blerimin e përroit. Fshehtësia e saj seç ka diçka që të kujton kaçakët. Duket sikur në rrjedhjen e saj të qetë e të trishtuar ruan kujtimin e dashurisë fatkeqe të komitit me voskopojarin e bukur. Midis gu-

rëve të gdhendur të çezmës ka mbirë myshku i gjelbër e mbi të si nëpër qerpikë çurgojnë pika uji, për të cilat voskopojarët betohen se janë lotët e çezmës, për vajzën. Ujët e saj shkon poshtë për të ujitur zambakët e bardhë, nga të cilët ndoshta këputi komiti për t'ia dhuruar vajzës.

Isha gati ta lija veten në ëndërritje e të krijoja kushedi ç'sfonde të tjera romantike, por një zhurmë metali më bëri t'i ndiej këmbët në tokë. Poshtë shelgut lotues me degë të dendura dikush lëvizi. Kalova rrjedhën e ujit dhe u afrova për të parë më mirë atë që ishte nën shelg.

Një burrë i moshuar po thithte i qetë e i kënaqur cigaren, si atëherë, kur kemi mbaruar një punë të mirë e të bukur.

— Mirëdita! — përshëndeta.

— Mirëdita! — tha tjetri dhe lëvizi si për të më bërë vend edhe mua.

— Mos lëvizni, po ulem këtu, — thashë dhe u ula në një trung të sharruar rrafsh, që ishte vendosur tok me tri të tjera rreth një trangu më të trashë, që shërbente si tryezë.

— Ti sikur s'je nga Voskopoja, — tha burri me bindje duke nxjerrë bashkë me zërin edhe tymin e duhanit.

— Unë jam nga fusha. Jam agronom, po ju?

— Jam kampist.

Ai ishte një burrë afër të gjashtëdhjetave, me mish të paktë në faqe e me tëmtha të spërkatur paksa nga argjendi i thinjave. Ishte veshur me një palë rroba të përdorura pune, aq sa mendova keq për të. Kampist e të mos e mbante pak vetën!? I kisha parë kampistët e tjerë. Të veshur mirë e të shkujdesur, me radio dore e aparate fotografike, duke shëtitur hije më hije nëpër lëndinat me luleshtrydhe.

Bashkëfolësi sikur m'i lexoi mendimet, sepse



u duk sikur ra ngushtë e u mundua të më sqaronte:

— Erdha e bëra ata fronat ku je ulur. I vura parmakët edhe asaj urës së vogël atje prapa shelgut.

Unë ktheva kokën. Përtej shelgut dukej një urë e bukur druri, një miniaturë e vërtetë e atyre urave që kemi parë në Drilon.

Vetëm tani u kujtova të vija re se kampisti fliste me një theks të lehtë gjirokastrit, madje dropullit.

— Mos jeni ju ai Jorgoja i famshëm, mjeshtri i çezmave? — pyeta sikur papritur të kisha zbuluar diçka.

Burri këtë herë buzëqeshi me krenari e pa çarë kokën për modestinë tha:

— Unë jam, me gjithë çekan, mistri e sharrë.

U ngrita dhe vajta tek urëza e vogël me hark. Poshtë rridhte me gurgullimë uji, sipër vareshin degët e shelgut.

— Të lumshin duart, o Jorgo. Qenke duartë, — thashë.

Jorgoja bëri një shenjë me dorë si për diçka të parëndësishme dhe tha:

— E pse të sillem vërdallë kot? Ja, bëj ndonjë punë të vogël. S'rri dot pa punë, më hanë duart. Edhe kur dal shëtitje, prapë s'më rrihet, mbledh salep.

— Salep? Si është salepi?

Jorgoja më vështroi vëngër me ata sytë ngjyrë myshku të çelët me pikëza të zeza përreth.

— Agronom të thënçin! Ja, ky është salepi, — kroi xhepat dhe nxori një rizomë të vogël e të degëzuar si hudhër.

Ai ishte nga ata njerëz të cilët të bëhen të afërt e të njohur që në fjalët e para. Ndoshta sepse këta tipa njerëzish nuk e vrasin shumë

mendjen për etiketën, po sillen lirshëm e natyrshëm.

— Po grunjat i pe? — pyeti Jorgoja me interesim.

— I pashë. Të mbara dukeshin.

— Vetëm se duan një shi. Sikur t'u binte një shi ... Kjo tokë, more djalë, është e shëndoshë, e ëmbël. Pleh i gjallë është, por duhet punë. I them gjithnjë kryetarit të këshillit e gjithnjë zihemi. I them: mblidheni, ore, rininë e hajt të qërojmë gërmadhat, ndofta i ke parë, në fshat ka shumë rrënoja. Të hapim vendin, të bëjmë ndonjë lulishte. Mbjellim ca shelgje e bredha, vendosim dy-tre stola e të shohësh ti, ua kalon parqeve të Tiranës apo jo. E di si më thotë? Ti, Jorgo, je kandidat voskopojar, po me votë deliberative.

Jorgoja buzëqeshi dhe vazhdoi:

— Edhe dyfish prodhon kjo tokë. Po ka shumë gurë të vegjël nga gërmadhat. Eh, s'më bëri perëndia drejtor shkollë, — tha Jorgoja me shaka, — s'do lija guriçkë në ara me nxënësit në orët e punës praktike. Voskopojarët denbabaden kanë rrojtur me blegtori e tokat janë pleh i gjallë. Po këta ç'bëjnë? Tokat më të mira që janë nën ujë i lënë livadhe, kur duhet të çahen e të mbillen drithë e patate.

— Duhet edhe livadhet, o Jorgo. Bagëtitë ç'do hanë? Apo bën pak dimër këtu, — u mundova të gjeja një logjikë në këtë mes unë.

— Nuk është ashtu, s'jam dakord me ty, — mori zjarr Jorgoja. — Vetëm Voskopoja nuk e ka problem barin e bagëtive. Do jesh e do bindesh vetë për këtë. Duhet organizim, ore djalë, ç'i do llafet. Ti ke ndër mend të bësh ndërtime në verë e tullat e tjegullat i blen që në dimër. U bie ngrica e i thërrmon. Çimenton ta shurdhon lagështia. Në verë blen të tjera. Ose plehun kimik;

nuk e fut brenda, ta merr era e të gërryen shiu. Të gjitha këto me pará janë. Ja, sot në mëngjes, për shembull, pashë një djalë me mushkat. Një-rës ka katër ditë që i mungon një patkua. Po s'ia vure, ka rrezik t'i prishet thundra e me të edhe këmba. Ja, një mushkë del jashtë përdorimit për një potkua e për pak mukajet.

Jorgoja heshti:

— Më fal se e kalova ca, po të fola meqë je argonom e do punosh këtu, — tha ai, po, kur pa që unë e dëgjoja me vëmendje, vazhdoi më me guxim:

— Bëhet një patate këtu që, ç'të të them, po ç'e do? Në vend që të ngarkohet e të shkojë që nga parcela drejt e atje ku duhet, ato bëhen kavalete në arë. Pas një muaji i seleksionojnë një herë se, domosdo, do të prishen. I bëjnë prapë kavalete e prapë pas ca kohësh i seleksionojnë. Dhe kjo punë vazhdon gjersa katandiset kokoshi një thelë ...

Unë vazhdoja ta dëgjoja Jorgon. Habitesha se ku i dinte me aq hollësi ai ato gjëra. Fliste me zjarr, pothuaj i nxehur. Dukej si një fshatar, nga ata fshatarët nikoqirë të mirë të tokës, që nuk duan t'u shkojë kot as edhe një fije bari e atje ku ka një grusht dhé, duan të ketë një rrënjë bimë.

— Me këtë oreks që ke, po të ishe individ, do të ishe bërë kulak... — bëra shaka unë.

Jorgoja qeshi me zemër. Ishte nga ata tipa që u pëlqen shakaja, jo vetëm kur hedhin vetë.

— Jo, o derëbardhë, nuk e kam për vete. Në shtëpi kam vetëm vazo me lule. Më vjen inat me këta. ... Kur erdha vjet në maj, zura kokën me duar, — vazhdoi ai. — Ishte bëra kërdua në kumbullat e egra. I kishin prerë për dru zjarri, se kishin mbetur në dimër pa dru. Ato kumbulla

që, po të shfrytëzohen mirë, e ngrënë edhe njëzet e pesë për qind vlerën e të ardhurave të sektorit nga rakia që del prej tyre. E dimrin e shkuar u bë kërdua vetëm e vetëm se në kohën e verës kryesisë nuk i ra ndër mend të caktonte disa forca për një javë që të siguronte drutë e dimrit. Aj, sto dhjavalos! — shau Jorgoja.

— Dje piva një ujë në çezmën që ke bërë nga Ura e Shipskës, — thashë unë, kur e pashë t'i prishej qejfi ashtu.

Jorgos iu ndërrua shprehja e fytyrës.

— E kam bërë para tre vjetësh atë, — tha.

— E pse, s'është punë e mbarë të bësh një çezmë atje ku ka një burim? Mendo një herë: Aty afër punojnë njerëzit. A s'është gjë e bukur kur ata, të lodhur, vijnë e pinë ujë? Edhe të mos jem e të kem vdekur, ata do të thonë të kënaqur: «Kishte pasur duar të arta Jorgoja. Na la këtë çezmë të freskohemi e ta kujtojmë.» Apo qoftë edhe të dëgjosh një djalë që i pëshpërit vajzës: «Sonte të pres te Çezma e Jorgos», a s'është gjë e bukur?

Sytë e Jorgos shkëlqenin nga një dritë e bukur.

— Murator punon, ti, Jorgo, atje në Tiranë?

— pyeta unë.

— Jô, ore djalë. E kush ta tha këtë, more mavri? Unë murator! ... haha! Jam shofer autobusi. Bankë-Kombinat, Unazë.

U mahnita. Sa e çuditshme është jeta, sa të çuditshëm janë njerëzit. Jorgoja qeshi me vete:

— E di ç'më ndodhi njëherë? Rrugës, në Tiranë, shoh një voskopojar, Mihan, do ta njohësh. Për pak sa s'e shkela, dreqin. I ra bulevardit mes për mes, sikur të ishte në Voskopojë. E ndala autobusin, megjithëse nuk kishte stacion. E thirra dhe e ula në vendin e parë në autobus.

Kapardisej Miha që ç'ke me të, sikur të ishte mbi qerre. S'mbaj mend sa rrugë e mbajta atje. I thashë të ulej afër meje, mbi motor. Më dukej sikur rrobat e tij mbanin erë pishë e zhumbricë. U llafosëm e u çmallëm. Më dukej sikur në kabinë frynte era e freskët e Voskopojës.

— Edhe sa vjet të duhen të dalësh në pesion, Jorgo? — e pyeta, përpirë nga kureshtja e atyre që dëgjoja nga dropulliti.

— Edhe dy. Dhe e di? E kam vendosur. Do vij bashkë me gruan këtu. Fëmijët i kam të rritur e të martuar, përveç djalit të vogël. Edhe atë e kam shofer. Ishte vjet këtu. U njoh me një vajzë voskopojare e synë këtej e ka, qerratai. Është vajzë trime, s'ke ç'i thua, skiatore. Ia mori mendtë me ato zbritjet nga Kostamanda. Njëherë deshi ta ndiqte edhe ky imi, por e pësoi, mend theu qafën. Rri, or babam, se s'je për këtë punë ti, e ngacmoj unë, po ku dëgjon ai?! Ia ka qejfi të vijë këtu e të rrijë përgjithmonë.

Unë e dëgjoja Jorgon, atë njeri të thjeshtë që bënte çezma e ura dhe mendoja:

«A s'është kënaqësi të lësh prapa qoftë edhe një çezmë, me të cilën të lidhet emri yt e kështu ata që do të vijnë, të thonë: «kjo është vepra e tij», «ai s'e kaloi jetën kot», «a s'është kënaqësi?»

## Kur unë rritesha

*tregimi i një të njohuri*

1

Më kujtohet se kishim dy vjet që s'venim në shkollë. Ishte kohë lufte e malet buçitnin. Më shumë se kurrë njeriu shihte armë e municione, që nga revolet, që ishin gjithfarësh, e gjer te mortajat, ngarkuar nëpër mushka me ca samarë të çuditshëm, tërë gropa e gunga. Të rriturit thoshin se poshtë, andej nga fusha ku shtrihej qyteti, kishte topa edhe më të mëdhenj se ata që shihnim në fshat, me predha të mëdha sa unë, që kishin borxh ta hidhnin gjylen edhe në majë të Moravës.

Nga tërë ai bollëk armësh, sikur u ra ca vlera llastikave, të cilat më parë ishin mburrja e krenaria e çdo djali të vërsës sime. Mirëpo ja,

erdhi lufta e, në vend që të blije me dy vezë një palë llastika, fare mirë mund të blije një revolver fringo të ri nga ndonjë italian, prej atyre që mbetën rrugëve, si kopeja pa çoban.

Mua kjo gjë s'më pëlqente hiç. Nuk më harrohej që motra ime, Julia, ma shkuli veshin sa mend ma dha në dorë, kur i mora fshehurazi dy vezë për ato të uruara llastika, që tani nuk i përfillte njeri, përveç kalamajve të vegjël. Tani ai që i thoshte vetes djalë i rritur nuk merrej me të tilla vogëlimes, por gjente një beretë dhe shkante Moravës përpjetë, dilte partizan.

Ë me të vërtetë: në fshatin tonë nuk kishin mbetur djem të rritur, po të mos futim në hesap Lonin, të birin e Leko dyqanxhiut, që vërtitej si zarbë nëpër fshat dhe ngacmonte çupat.

Unë atëherë s'e kuptoja çfarë u kërkonte ai e si s'kishte turp që merrej me to. Vetëm kisha vënë re se, sa i shihte së largu, lëmonte leshrat dhe i vështronte me lakmi si maçoku cironjtë.

Unë s'kisha prindër, më vdiqën njëri pas tjetrit. Bashkë me motrën time më të madhe, Julinë, jetonim me gjyshin. S'kisha as vëlla, e kjo ishte një nga vuajtjet e mia të fshehta. Gjithmonë më sëmbonte në zemër dhe rënkoja: «Hë, që s'kam një vëlla më të madh, të shkretën, të dilte partizan! Si s'u bëre djalë, moj Juli!»

Shokët që i kishin vëllezërit partizanë trembante veshët bigë për spiunllëqe), se si në kë me partizanë të tjerë, dhe bisedonin për ...

Unë i dëgjoja me zili shokët, pa e bërë veten, mbrëmjeve, pas darke, e hapja barkun dhe e nxirrja të keqen që më mundonte:

— O gjysh, po ne pse s'marrim partizanë për darkë?

Gjyshi më hidhte një vështrim plot qesëndi e thoshte po ato fjalë:

— Hë, u bë edhe mingua të të japë mend.

Unë s'e kuptoja dot atë fjalë, «mingo», por e ndieja që ishte një fjalë poshtëruese e se kishte afërsisht kuptimin e fjalës spurdhjak apo qurravec. Shtrëngoja dhëmbët e thosha me vete: «Hë, që s'jam edhe ndonjë pëllëmbë më i madh, pa llafoseshim pastaj, o babagjysh mustaqeshtëllungë». E, tek rrija e bluaja në kokë këtë kuvend, më merrte midis gjunjëve vëllai i gjyshit, xha Todi, më përkëdhelte kryet me dorën pa gishta e i drejtohej atij:

— Po, ore byrazer, po. Këta do na japin mend neve. Nuk do rrojnë kështu si ne këta, jo, flije mendjen. Do ngrehin një dynja tjetër këtë, më të bukur.

Mua më vinte ta përqafoja xha Todin, po më ndalte vështrimi plot qesëndi i gjyshit, që mbase matej të më quante prapë «mingo».

## 2

Xha Todi s'kishte shumë vite që ishte kthyer nga kurbeti. Ai që në Amerikë të Zezë, që, siç thoshin, ishte shumë larg, tutje, andej nga perëndon dielli. Sa që në kurbet, tek-tuk dërgonte ndonjë kacidhe, sa të ndihej që që gjallë. Pastaj e qamë për së gjalli, se «e kishte zënë famбрика». Se ç'ishte kjo «fambrikë», unë nuk e dija. Madje, as motra ime, që ishte tre vjet më e madhe, nuk e dinte. Netve në ëndërr shihja të



vëllanë e gjyshit në dhëmbët e asaj «fambrikës» e unë përleshsha e gjakosësja me të.

Pastaj, një ditë prej ditësh, xha Todi erdhi nga kurbeti. Asnjë njeri nuk e njohu Todin e dikurshëm, djalin levend të fshatit, që mbushte me këngë lajthishtën. I tretur, i rrudhur e i tharë, sikur e kishin pirë një mijë piavica. Me vete kishte sjellë një sënduk me ca rroba kazmiri të përdorura dhe ca libra në gjuhë të huaj, që i ruante më shumë se ungjillin. Njërën dorë e kishte të shukosur e pëllëmbën pa gishta. Kur e panë kështu, gratë ia dhanë kujës. Edhe xha Todi u përlot dhe uli kokën i zënë ngushtë. Ndoshta i erdhi turp që ishte katandisur ashtu. Pa përreth i përmalluar, fshatin ndërtuar gjatë përroit, mbuluar me shelgje, kumbulla e arra të mëdha dhe një psherëtimë e thellë i çau gjoksin. Pastaj më kujtohet kur më mori në krahë, më puthi e pyeti:

— Ky është Josifi?

Më kishin treguar se, para se të lindja, xha Todi kishte dërguar një letër nga kurbeti, ku shkruante që, po të bëhesha çupë, le të ma vinin emrin si të donin, por, po të bëhesha djalë, të më quanin Josif. Gjyshi kishte ngrysur vetullat e, ndonëse që menduar shumë, nuk kishte gjetur ndonjë Josif në fisin tonë deri në tre breza më parë. Megjithatë dëshirën e të vëllait s'e prishi: ma vunë emrin Josif.

Më vonë, kur rrinim te sofaçi, unë e pyesja shpesh:

— Xhaxhi Todi, kush ta ka ngrënë dorën kështu?

— Ma ka ngrënë fabrika, — përgjigjej ai.

— A është e madhe fabrika?

— E madhe pa hesap. Vetëm gjak e djersë thith.

— Eh, të isha unë me llastika, more xhaxhi Todi, s'do ta lija të të hante. Do t'i vija llastikave një fiçor lumi sa një arrë, si atëherë kur e vrava atë bufin dhe do t'i bija mu në lule të ballit. Veç në kishte shtatë kokë si kuçedra . . .

Xha Todi qeshte, më përkëdhelte e më thoshte:

— Rritu njëherë, rritu, pa ke kohë ta tregosh trimërinë. Kuçedra këtej rreth e rrotull është.

Unë rreksha të merrja me mend se ku mund të ishte strofulli i kuçedrës; mbase te Përrroi i Lugetërve, apo te Guri i Capit.

Njëherë gjyshi e pyeti xha Todin:

— More vëlla nga e psonise këtë emër, Josif, xhanëm? Ne në fisin tonë s'kemi ndonjë.

Dhe Xha Todi i shpjegoi se ashtu quhej i pari i vendit më të madh në botë, që quhej Rusi, ku të tërë ishin njësoj. Kjo Rusia na qenkej e kuqe e ky na ishte një burrë i madh me mustaqe, që e thërritnin Josif Stalin.

Pastaj filloi lufta. Italianët u shtruan në shtëpitë tona sikur i kishim kushërinj. Ngritën kazerma, e lëmenjtë i bënë poligone. Vajzat e fshatit u mbyllën brenda.

Xha Todi më thoshte shpeshherë:

— Rritu shpejt, se ajo kuçedra, që më hëngri krahun më duket se do të vijë edhe në fshatin tonë.

Dhe unë veç një dëshirë e një merak kisha: Të rritesha sa më shpejt që, kur të vinte kuçedra, të isha burrë me një barrë mustaqe e me armët ngjeshur.

Atë kohë Alqin, djalin e xha Todit, e përjashtuan nga liceu se kishte marrë pjesë në një demonstratë. Xha Todi vinte te ne më rrallë darkave. Sec bënte me të birin me ata librat e trashë, që kishte sjellë nga kurbeti e që as prifti as hoxha s'i merrnin vesh.

Unë, si gjithë fëmijët që janë kureshtarë, digjeshja e përvëllohesha të dija se ç'ishin ata libra, me kapakë të trashë si librat e shenjtë Me një kumbull të bërë në xhep iu afrova një ditë xha Todit. Pasi e mora me të mirë, duke i vënë kumbullën në dorë, i thashë:

— Ore xhaxhi Todi, ç'i ke ata libra me kapakë të trashë, që më shumë ngjajnë me libra të shenjtë se me libra shkolle?

Ai m'i nguli sytë për një kohë të gjatë dhe tha:

— Të shenjtë janë, more bir. Flasin për të varfrit, për punëtorët, për fshatarët, për ty, që s'ke as me çfarë të arnosh pantallonat. Po ti, ç'bën, po rritesh apo jo? Ai adashi yt andej nga lind dielli po bën punë të mëdha. Po ia thyen hundët asaj kuçedrës që ha krahë punëtori. Ti ngjash atij, bir.

Merrja vesh unë se ç'më thoshte xha Todi! E ç'punë kishte ajo kuçedra «fambrikë» të vinte nga perëndon dielli në lindje? Veç një gjë kuptoja: duhej të bëhesha burrë sa më shpejt.

Pastaj në fshat erdhën karabinierët. Dëshën të merrnin në burg Alqin dhe mësuesin tonë. Të shoqëruar nga Loni i Leko dyqanxhiut ata shkuan në dhomën e mësuesit, derën e së cilës e thyen me kondakët e pushkëve.

Me të hyrë, e kthyen përmbys. Kontrolluan

çdo gjë, bile edhe fletoret tona e më në fund gjetën një letër. Me sa dëgjova nga më të mëdhenjtë, mësuesi u shkruante se, në qoftë se këmi-shëzinjtë i kishte marrë malli për të e për Alqin, le t'i ngjiteshin Moravës përpjetë, se do t'i qerasnin me plumba.

Që atëherë mbetëm pa shkollë, e ashtu fre-lëshuar gjithë ditën e perëndisë bridhnim korijeve e varnim nëpër degë breshka nga këmbët. Në fund të bahçes, atje ku fillonte lajthishta, poshtë tumbave të pemëve, kisha zgjedhur një vend të fshehtë, që e quaja limerin tim. Atje i kam kaluar orët më të bukura të fëmijërisë sime. Atje e ndieja veten të lirë, atje isha i pasur me gjithçka. Shtrihesha në kurriz mbi barin e trashë e të lagësht e, duke përtypur nëpër dhëmbë ndonjë fiije, e lija veten të fluturoja në krahët e ëndrrave. E çfarë nuk e bëja veten e ku nuk shkoja! Kapedan me pallë të rëndë, Gishto e Qeros. Nuk kishte div, kuçedër a fambrikë që s'e mposhtja. Përditë shpëtoja nga skllavëria një të Bukur të Dheut. Domosdo, ato ishin të mbushura gjer në grykë nga mirënjohja e të nënshtruara si shqerra, po mua as që më prekte mirënjohja e tyre. Detyra ime ishte të bëja vetëm heroizma e të dënoja të poshtrit e gjakpirësit. Ëndrrën më të bukur e ruaja për në fund, ashtu siç lija për në fund qershinë më të ëmbël. Në të e shihja veten partizan me yll në ballë, mustaqekacorr, me dylbi varur në gjoks, me rrip shtrënguar mesit, ku vareshin bombat e kuqe e supin ma rëndonte automatiku. Më shihnin me adhurim dy sy të kaltër, të cilët më bënë të dridhesha më shumë se nga mirënjohja e të Bukurave të Dheut. Se ç'ishin ata sy, më mirë s'po e them këtu. Sytë kaleshë doemos që hidhëroheshin e

përloteshin, tek e shihnin se unë as që e ktheja vështrimin andej se, ta pret mendja, një batalion i tërë trimash prisnin fjalën time. E tamam në kulmin e ëndërrimeve përherë do gjendej o gjyshi o Julia, që të ma bënin fir gjithë kështjellën time:

— Sifi, lopa hyri në misër!

Atëherë vija ndër vete e sytë më shkonnin te pantallonat e dala boje e të arnuara. Shihja këmbët e mia të holla e të shtrembra, me lëkurë të ashpëruar nga gërvishtjet e ferrave netve, kur bridhja pas xixëllonjave, dhe më vinte t'i shaja ata që më thërritnin. Dilja nga limeri im me kokën mbushur plot me fije bari të thatë ngatërruar nëpër kaçurrelat e dendur. Gjyshi më shihte me ca sy të merakosur e, kur ndodhej xha Todi, i thoshte:

— Është ca marrok ky, sheh ëndrra ditën më drekë.

Atëherë nuk e kuptoja pse xha Todi më merrte e më shtrëngonte fort e fort në gji e sytë ia mbushte një mall e dashuri sa qielli.

— Ëndërron ky djalë, — thoshte. — S'ka më mirë se kur njeriu ka ëndrra. Kjo do të thotë se lumi do ndërrojë shtrat. Diç do të bëhet ky djalë me rripat e sandaleve të këputura e gishta të zinj nga çoçanikët.

Gjyshi më shihte nën qepalla dhe hungëronte:

— Hë, mingua!

Papo edhe motra ime Julia nuk mblidhej në shtëpi. Mbrëmjeve me disa shoqe mblidheshin te shtëpia e xha Todit e çoç bënin e ç'llafoseshin atje. Gjyshi im thoshte se qëndisnin pajë, po, pajë u bëfsha unë, në qëndisnin pajë ato! Një mbrëmje shkova vjedhurazi e përgjova te dera.

Ato këndonin, veç jo nga ato «o, ç'është ajo, që po zbret nga mali», po një këngë me flamur të kuq e me bijtë e Skënderbeut. Kur hyra brenda, disa nga vajzat u matën të fshihnin ato që qëndisnin, po Frosa, e mbesa e xha Todit dhe kushërira ime, i ndaloi. Ajo u ngrit dhe tha:

— Ti qenke, Sifi? Hajde, kusho, mos ki turp.

Dhe unë pashë ca shami të çuditshme, të kuqe e trekëndëshe, kapela me yj të pambaruar, fanella e çorape të trasha leshi. Unë, domosdo, s'mund të rrija me ato çupëlina, se i thosha vetes burrë që po përgatitesha të vrisja kuçedrën etj. dhe s'isha si ai zarba Loni, që ku ta gjente t'i thoshin çupat «hajde, rri me ne», ndaj ika pa u dhënë as vaktin.

4

Kishte dy-tre muaj që Italia kishte ikur. Për gjermanët Leko dyqanxhiu, me jelekun e mëndafshhtë shtrënguar pas tuleve të sjetullave, me mësallën e bardhë gjithnjë mbi llërë e me kupën e rakisë përpara, thoshte:

— Me këta s'bëhet shaka. U thonë gjermanë këtyre.

Fshati ynë është ndërtuar rrëzë malit të Moravës, atje ku sapo nis lajthishta e, duke qenë i veçuar, ende nuk kishte shkelur këmba e gjermanit. Xha Todi vinte shpesh nga ne, të bisedonte me gjyshin, që ishte më kokëngjeshuri në fshat. Gjithnjë muhabetin e hapte me mua:

— Hë, Josifikë, si dukesh? Ajo kuçedra do

të vijë pas ca ditësh edhe në fshatin tonë. Ti si, je rritur apo jo?

Unë mundohesha të mbyllja në drejtqëndrim kërcinjtë e hollë dhe thosha sikur raportoja:

— Jam rritur e jam gatitur, xhaxhi Todi. Llastikat i lidha mirë. Kam zgjedhur edhe ca figorë lumi. Le të afrohet, po të dojë.

Xha Todi më fuste gishtat e shëndoshë në për flokë, m'i bënte dredhkë dhe thoshte:

— Me llastikun s'ke gjë në vijë hiç. Kjo kuçedër vetëm me plumba vritet.

Gjyshi ngryste ato vetullat e rëndá dhe murmuriste:

— Mos i thuaj djalit ashtu.

— Të drejtën i them, o vëlla. Gjermani kuçedër është. Pse, për mirë erdhi ai te ne?

— Erdhi se i ra rruga. Ti sikur këndon edhe gazetát. Gjetkë e ka rrugën ai, — thoshte gjyshi.

— Po në Rusi, rruga i ra? — e pyeste xha Todi. — Ja, ta zëmë se ti do të vesh në qytet, që është në fushë, po pastaj merr malit përpjetë. E po, mor qerrata, atje të bie rruga të shkosh?

— Gjermani nuk e trazon atë që s'e nget. E ka thënë me gojën e tij

— Aa, këtu u lajthite, babagjysh, — kërcej unë — se ja, ç'kërkon gjarpri që ngjitet në pemë, ku është foleja me zogj? ...

Xha Todi më rrahu krahët dhe tha:

— Të lumtë goja, more Josif! Si profesor e si komisar ke folur, po këtij gjyshit tënd s'i mbushet rradakja që vetëm me luftë ...

— Mos më trego luftën ti, — tha gjyshi. — Kam vajtur gjer në Elbasan për Fan Nolin unë. E ç'doli nga kjo? Një m... — tha gjyshi, duke hedhur vështrimin mënjanë e duke pushtuar kupat e gjunjëve me pëllëmbët e mëdha.

— Tani është ndryshe puna, — u hodh e tha xha Todi, — ata djemtë atje, të gjithë ne, populli fukara, kemi Partinë Komuniste që na udhëheq.

— Oh, lëre. Tani na qenka ndryshe puna, — hidhej gjyshi. — Tani ndryshon puna, se kanë dalë malit edhe çupat. Një me një që fitokemi. Prit Frosinën e Julinë, bashkë me këtë mingon këtu, t'i vënë drunë gjermanit.

Unë bëhesha piper nga inati e s'e doja rroj-tjen. Në dëshiroja të rritesha e të bëhesha burrë, kjo dëshirë më përvëlonte vetëm që gjyshi të mos më thoshte më «mingo».

Kështu kalonin ditët e javët. Çdo mbrëmje këto muhabete bëheshin. Mua më vinte të futesha në dhë nga turpi. Gjyshi ishte plaku i fundit në fshat që s'donte të shihte të vërtetën, që dukej ashiqare. Ndonjëherë mundahej t'ia mbushte mendjen edhe Julia, por ajo e niste muhabetin aq larg, që në kohë të sklevërve e që në kohën e majmunit që u bë njeri, sa asnjëherë s'e sillte fjalën atje ku donte se, ose gjyshit do t'i sosej durimi e do xhindosej, ose do ta kishte zënë gjumi.

Unë në fillim çuditesha se ku i dinte Julia gjithë këto gjëra, meqë as këndimi i shkollës nuk i kishte. Pas shumë rrahjesh e arsyetimesh përfundova se diç duhej t'i lexonte xha Todi nga ata librat e tij në gjuhë të huaj, netve, kur mblidheshin gjoja për pajë.

Nuk më harrohet dita kur gjyshi im sa s'u zu hasm me tërë fshatin. Nga qyteti erdhën lajme



se të nesërmen në fshatin tonë do vinte një togë me gjermanë për mbledhur bagëtitë e fshatit. Në fshat ra gjëma. Të gjithë deshën një fjalë me mend, një këshillë. Njerëzit shkonin te njëri-tjetri e bisedonin, hamendnin, haheshin midis tyre e më në fund arrinin në një përfundim: të mbidhej bagëtia e njerëzit e të braktisej fshati. Nga ana tjetër të lajmërohej batalioni partizan.

Te ne atë mbrëmje erdhi xha Todi. Pasi më pa drejt në sy, më tha:

— Ajo kuçedra që më hëngri krahun, nesër do të vijë në fshat, Sifi.

Pastaj iu drejtua gjyshit:

— Bëj gati bagëtinë, vëlla, e ndonjë plaçkë tjetër e hajde të ngjitemi përpjetë. Nesër vjen gjermani të mbledhë bagëtitë.

Gjyshi që atë kohë po qepte rripin e opingës, tërhoqi me inat spangon e lyer me dyllë, sa e këputi. Pështyu i xhindosur dhe tha:

— Unë s'tundem nga vendi. Do të rri në shtëpinë time. Gjermani s'ka punë me mua. Unë s'i bie më qafë atij e ai s'ka pse të më ngasë mua.

Xha Todi u nxeh keq. Ishte e para herë që e shihja kaq të nxehur. Pasi e flaku në vatër cigaren e pambaruar, ia pati:

— More vëlla, akoma i bën hyzmet asaj mendjeje ti? Po s'shikon e s'dëgjon se ç'bëhet? Akoma s'e ke marrë vesh se të gjithë i kanë kthyer pushkën? Si këtu e kudo gjetkë po e ndjekin nga të katër anët. Apo sovjetiku, që po i futet me kopaçe kokës. Je burrë plak e gjyko si plak, s'je fëmijë. Duhet ta ndash të bardhën nga e zeza. S'dëgjove për atë fshatin e Kolonjës, që e zhuriti me gjithë njerëz?

Gjyshi, duke mbajtur bishtin e cigares me ata gishtat e trashë tërë nyja, me thonj të kthyer e të zverdhur tha:

— Unë nuk luaj nga shtëpia. Kush do të ikë, udha mbarë i qoftë! Hesapi i Zylalit sa lakra i vë kalit, sikush ka mendjen e tij.

— Po ngrehu, o gjysh, ngrehu! — u hodh e tha Julia, që gjithnjë s'i ndihej zëri, se ishte vajzë e urtë dhe e druajtur nga natyra... — Bëj sig bëjnë të gjithë.

— Hesht, moj ti atje! — tha gjyshi me të rreptë. — U bë veza të mësojë pulën!

— Mblidh fiqirin, vëlla, e mos u bëj si kalam, — ndërhyri xha Todi. — Gjermani nuk të pyet. Ku shkel këmba e tij, vetëm gërmadha e kufoma mbeten.

— E po hë, o gjysh, hajde të ikim me fshatin. Vetë ke thënë se delen që ndahet nga tufa e ha ujku, — i lutem edhe unë.

— E sheh këtë bastun ti? Mingo! — më hakërrohet gjyshi.

«Ah, i mbiftë varri gjemba atij që e nxori këtë palo fjalë, «mingo»!» — shaj e tërbohem unë.

Xha Todi iku nga shtëpia jonë i bërë tym. Pas ndonjë gjysmë ore erdhën te ne disa nga pleqtë më të mençëm e më të nderuar të fshatit. Biseda vazhdoi gjatë por, më se mori vesh gllaniku i vatrës, aq mori vesh edhe gjyshi. Natën vonë pleqtë ikën nga shtëpia jonë pa na thënë as natën e mirë.

Gjithë natën, ku nëpër gjumë e ku zgjuar, bëja plane për ditën e nesërme. E kisha vendosur: Do ta mbroja me çdo kusht gjyshin. Llastikat i kisha të mira, gurë sa të duash. Herë-herë shihja si nëpër ëndërr kuçedrën, e cila mernte

formën e togës së gjermanëve që do të vinte të nesërmen në fshatin tonë.

6

Dita e re u gdhi siç janë gdhirë të gjitha ditët, po këtë herë mua nuk më zgjuan zhurmat, po qetësia e fshatit. Nëpër rrugicat mund të shihje ndonjë pulë e tek-tuk ndonjë mace që kalonte rrugën si ndonjë ogur i zi. Fshati ishte i shkretë. Vetëm ne e familja e Leko dyqanxhiut kishim mbetur. Asgjë s'pipëtinte, thua se në fshat kishte rënë kolera.

Gjyshi, më i ngrysur se kurrë, mendohej të dukej i qetë, por unë e ndieja se ai rrinte në pritje, në përgjim, se donte të vërtetonte diçka. Bashkë me mua dhe gjyshin kishte ndenjor edhe Julia. Ajo s'donte në asnjë mënyrë të na linte vetëm. Unë, po, më i vendosur se kurrë, me llastika në dorë e gurë në xhepa, i rrija afër gjyshit si sejmen, me vendim të prerë: o ta mbroj gjyshin, o të vritem si burrat me të.

Qetësia vazhdoi disa orë. Aty nga dreka në fshatin e heshtur e të braktisur u dëgjuan trokitje potkonjsh, atje poshtë në të hyrë të fshatit, tek ura e drunjtë. Pastaj zhurmat u shumëfishuan e ne pamë nga dritarja një re pluhuri që drejtohej për në qendër të fshatit.

Shtëpia jonë ndodhej në krye fare, tamam atje ku fillon lajthishta e çdo gjë dukej si në pëllëmbë të dorës. Nga dritarja pashë gjermanët, që ishin si nja njëzet e që zbritën nga kuajt, me ato helmetat me qafore, me llërë përveshur, me automatikë të shkurtër varur në qafë.

I pari i tyre, një feldfelbel me dy rrudha të varura në fytyrë, që të kujtonte një derr të mër-zitur, diç tha me zë të lartë në gjermanisht e, sa të thuash pesë, ushtarët lidhën kuajt në një gardh. Feldfelbeli përsëri foli e kësaj here gjermanët u ndanë në grupe prej tre vetësh. Pastaj me shpejtësi grupet nisën kontrollin e shtëpive në të gjitha drejtimet.

Nuk mund të them që s'u tremba, se gënjej, por mund të them këtë tjetrën, që dritares s'iu largova asnjë minutë dhe llastikat i shtrëngoja fort.

Pas pak pashë Leko dyqanxhiun t'i avitej feldfelbelit, lajkatar e i përrulur si një qen i rrahur, e diç po i jepte të kuptonte me shenja. Me sa dukej, i thoshte se fshati ishte i braktisur e se, me përjashtim të një familjeje, nuk kishte njeri. Dora e Lekos u drejtua si tytë mitralozi dhe shënoi shtëpinë tonë Unë u bëra njësh me pezulin e dritares, sikur ajo dorë po na qëllonte me plumba. Gjermani, pas u bëri shenjë tre të tjerëve që ta ndiqnin, me një gjest energjik u nis drejt shtëpisë sonë.

Atëherë më hynë ethet keq. Pa u larguar nga dritarja, ku ishte edhe Julia, i thirra gjyshit:

— Gjysh, ata po vijnë këtu!

— Le të vijnë, Sifi, s'kanë punë me ne ata. Po s'ngave s'të nget njeri.

Ndërkohë gjermanët hynë në oborrin tonë. Për një çast komandanti i tyre qëndroi në mes të oborrit me këmbë të hapura dhe hetoi me sy. Pastaj, papritur, ia këputi me shkelm një pule që po çukiste në paqe një krodhe buke dhe e fluturoi si një top prej puplash matanë gardhit. Gjyshit, që i kishte parë të gjithë këto, i lë-

vriu damari i ballit, po prapë u përmbajt. Gjermani dha urdhër, ushtarët hapën me shkelma derën e ahurit dhe nxorën që andej kuqalashen tonë që na lagte lugën.

Atëherë mua m'u errën sytë e më s'pyeta as për frikë, as për gjerman, por u turra drejt lopës me të lebetitura. Ndërsa rendja, feldfebeli më përplau për zverku e me zor më ktheu nga vetja. Pastaj më shkuli nga duart llastikat, e vuri kërrabën përdhé dhe e bëri copë-copë, ndërsa mua ma veshi me flakurima fytyrës.

Sytë m'u mbushën me lot nga tërbimi dhe gjithçka e pashë si pas një xhami të lagur. Pashë gjyshin, të madh sa një katana, të kërrusur nga reumatizmi, që u vërsul me bastun ngritur përprjetë drejt feldfebelit:

— Unë të dhjes tët ëmë! — ulëriu gjyshi dhe u mat ta godiste me bastun.

Feldfebeli u kthye nga ai dhe u step. Ishte më tepër çudi sesa frikë ajo stepje. Pastaj, si të ishte kujtuar për diçka të zakonshme që duhej bërë, hoqi revolverin me gjakftohtësi dhe e qëllloi gjyshin në bark.

Gjyshi bëri edhe disa hapa të mëdhenj e të çatallosur e ra plasur përdhé, duke shtrënguar barkun.

— Gjysh! — bërtita unë e u derdha mbi të.

Feldfebeli u mat të qëllonte edhe një herë, kësaj radhe ndoshta mbi mua, por s'pati kohë. Lart në lajthishtë krisën bataretë. Ishin partizanët që sulmonin.

Pas meje ra përmbys edhe Julia, që qante me lot të nxehtë. Bataretë këcitnin. Ia dhanë edhe mitralozat. Komandanti gjerman shpërndante urdhra në të gjitha drejtimet me një gjuhë që sikur i hante fjalët a kujiste.

Me mundim, nëpër fishkëllimën e plumbave, unë dhe Julia e futëm gjyshin në shtëpi. Nga plaga i rridhte gjak. Ne s'dinim ç'të bënim. Më në fund ime motër grisi një fashë, nga një këmishë e ia lidhi ashtu si munda. Gjyshi rënkonte. Tiparet i ishin mpirë e zverdhur, ndërsa djersët i binin palë-palë.

Ndërkaq feldfebeli u kacavar si një mace në manin e madh që kishim në mes të oborrit. Ne të dy vrisnim mendjen se ç'kërkonte gjermani atje lart. Për një çast harruam edhe rënkimet e gjyshit, edhe buçitjet e luftës. Gjermani mezi shquhej nëpër fletët e manit e ne më shumë e dallojm nga lëvizjet e degëve e të fletëve. Në majë të manit ndodhej një kolibe që e kisha bërë në behar. Që andej vendi dukej si në pëllëmbë të dorës, sidomos monopati që zbriste nga lajthishta në fshat.

Gjermani u ngjit deri në kolibe dhe bëri gati automatikun. Lufta vazhdonte. Muret e shtëpisë dridheshin si nga tërmeti.

Midis fletëve të lajthive nëpër shteg unë dhe Julia pamë të zbriste Pirroja, partizan nga fshati ynë. Gjermani shënoi. Automatiku u drodh si me inat dhe e dridhura e tij kaloi edhe në trupin e partizanit, që ra krahëhapur mbi një lajthi. Pas tij po zbriste i dyti. Gjermani përsëri shënoi, po nuk shtiu. Priste që partizani të dilte atje ku s'kishte gjethe e degë. Ja, partizani doli.

— O partizaaan! — thirri Julia, si e çmendur. — Fshihu se të vrau qeni, moree! Në majë të manit është.

Po partizani s'dëgjoi. Zëri i Julisë humbi midis buçitjeve të luftës. Automatiku i gjermanit shtiu përsëri dhe partizani i dytë u platit afër të

parit. I treti po zbriste nëpër shteg dhe gjermani merrte shenjë.

Atëherë Julia, ajo çupë aq e urtë, sa s'kishte guxim të trembte një pulë, s'njihej fare. Me flokë të shpupuritur u turr drejt gjyshit:

— Gjysh, gjermani ka hipur në man. Ai po i vret djemtë! Oh, medet!

Julia shkulte flokët me duar e ashtu më dukej si një luaneshë e mbyllur në kafaz. Gjyshi ngriti kapakët e rënduar të syve dhe tha me zë të mekur:

— Afro shkallën e hip në baxhë, Juli. Atje kam një pushkë e ca fishekë. Merri e hajde të ta mbush, — tha gjyshi me zë të këputur.

— Di ta mbush edhe vetë, gjysh. Edhe të marr shenjë di, — tha Julia dhe vrapoi për ku i thanë.

— E mirë, moj bijë. Sot edhe çupat luftojnë, — tha gjyshi e zëri i humbi midis krismave.

Ai po matej të fliste akoma, po s'mundte. Tani, në çastet e fundit, deshi me çdo kusht të thoshte diçka me rëndësi, mbase mësimin e madh të jetës së tij, mbase atë që deshi të vërtetonte atë ditë.

— U gabova, more bir ... derri do plumb! — pëshpëriti ai.

Unë iu afrova më pranë, pa vënë re lotët që më shkisinin faqeve e i ngrita kokën e lëshuar e të pafuqishme.

— Dëgjoje xha Todin, Sifi. Ai ka të drejtë. Mos më vër faj as mua, bir.

Gjyshi u mblodh kruspull. Mbase i ishte shtuar dhembja e plagës tanimë të ftohur.

— ... Purteka e hollë kthehet e ndreqet si të duash, po kërcuri i trashë, thyhet e s'ndreqet dot. E ja, o bir, ti je ajo purteka e hollë,

plot lëng e jetë, e unë kërcuri ... Ti je djalë i mirë, nuk je më mingo. Po rritesh ...

Gjyshi do vazhdonte më tej, por në dhomë shungulloi një krismë. Ktheva kokën. Julia po qëndronte e shtangur dhe e zbehtë te pezuli i dritares. Te këmbët e saj ishte rrëzuar pushka, që ende lëshonte tym baruti.

Unë vrapova te dritarja. Nëpër degët e manit varej i çakarritur trupi i gjermanit.

— E vrave? ... — pyeti me zë të këputur gjyshi.

— E vrava, gjysh! — tha me një fill zëri Julia.

— Të lumtë dora, moj bijë! Eh, të rronte yt atë. Hajde të të uth, Juli.

Ajo u afrua e gjyshi me duart e rënduara i mori kokën dhe e uthi në ballë.

— Ti po qan? — e pyeti gjyshi.

— Më vjen turp që më ra pushka nga dora, gjysh, — tha Julia me sytë përdhé.

— S'ka gjë, moj bijë. Për herë të parë kështu e pësojnë edhe burrat, — tha ai dhe vari kokën.

— Gjysh, — klithëm ne të dy, vëlla e motër, — ku do na lësh, gjysh!

Gjyshi hapi edhe një herë sytë e u mundua të ngrinte kokën e tij të thinjur. Mblodhi fuqitë e fundit e me zë të tendosur nga dhimbja foli me të fortë, duke mposhtur edhe drobitjen e vdekjes, sikur të donte ta thoshte patjetër të plotë e deri në fund mendimin:

— Pushkën shtrëngo, bijë! Lufto për ne të tërë. Në mal ka edhe çupa partizane. Atje do t'i gjeni të gjithë: prindër, motra e vëllezër. Afrim, moj partizane!



## S'ka faj ai, është i mirë...

Punëtorët e shkarkuan plehun kimik në një hangar të madh të shtruar me çimento, përkrah disa makinave bujqësore që ishin vënë në një rresht të gjatë e të drejtë. Pastaj ata mbyllën spondet dhe shoferi ma bëri me kokë:

— Hip!

Unë zura vend përpara e u rehatova në ndenjese. Makina ishte e re flakë e ta kishte qejfi të rrije. Shoferi paskësh qenë merakli i madh, le që dukej edhe nga mustaqja spic. E çfarë s'të shihte syri brenda në makinë; një kinkaleri të tërë. Lule artificiale, bufka të bukura që tundeshin, fotografi sportistësh e deri një palë këpucka prej letre të punuara për merak nga ndonjë i ngeshëm.

Diku në mes të fshatit shoferi u detyrua të ndalonte. Mes për mes rrugës po shkonin drejt muzeut fëmijët e kopshtit të zënë njëri pas tjetrit nga grykëset e bardha. Ishin fëmijë të shëndetshëm, të qethur e të krehur, me faqe të ndrit-

shme. Në gjokse u dukeshin të qëndisura bukur inicialet e emrave.

Edukatorja, një vajzë e re, edhe ajo me përparëse të bardhë, përkujdesej që fëmijët të hipnin në trótuar e të mos rrëzoheshin.

Nga xhami pashë Selon që po vraponte drejt makinës. Në duar kishte një kaci, një fshesë e një legen. U var te dera e shoferit e seç po i thoshte këtij me të lutur. Pasi i mori pëlqimin, u kacavar në spond e u hodh brenda në karroceri.

Unë u ktheva mbrapa dhe u mundova të shihja ç'bënte Seloja. Ky, me lëvizje të nxituara, gërryente me kaci atë pak pleh kimik që kishte mbetur në karroceri. Pasi e bëri grumbull me fshesë, e hodhi në legen.

Shoferi, i mërzhitur e i paduruar, shtrembëroi anash mustaqen dhe zbriti të ndihmonte fshatarin tim.

Seloja u ul poshtë. Diçka i tha e i bëri me shenjë në drejtim të shtëpisë dykatëshe që ishte aty afër. Pastaj u zhduk bashkë me legenin te porta e shtëpisë së tij, zhytur në harlisjen e hardhive e prej andej doli me duart mbushur plot me mollë behari.

— Merri dhe të falem nderit shumë! — tha ai me mirënjohje.

— Po ç'e do atë, o xhaxha, — qesëndisi shoferi, — s'është trahanà.

— Si ç'e dua? — u habit Seloja e, duke rregulluar strehën e kapelës, tha: — Po ai është pleh kimik, more. Gjynah të shkojë kot. Sikur edhe luleve t'ua hedhësh, hair ke, pale patateve e tjetrës e tjetrës.

— Tip kopraci, — tha shoferi duke nisur makinën. — Ky është nga ata fshatarët kopracë që e mbërthejnë paranë. Më thershin mua në ka

radio në shtëpi ai. Kushedi ç'ua nxin jetën djemve e çupave.

— Jo, — i thashë unë, — ai është xhevair burrë. Në shtëpi ka televizor, divanë e qilima.

Shoferi më hodhi një vështrim të shpejtë me bisht të syrit.

— Nuk është koprac, por është njeri që e çmon dobinë e gjësë së mirë, — shtova unë e përbrenda qesha: «Eh, djall, o Selo!»

Im atë e Seloja punojnë në një brigadë, që këtu e njëzet vjet të shkuar, atëherë kur e bënë kooperativën. Kanë shkuar mirë bashkë e ajo që i lidhi edhe më shumë, ishte një ngjarje, e cila i bëri të dy objekt talljesh, qyfyresh e hokash, aq sa puna e tyre mbeti si anekdotë për shumë vjet me radhë. Edhe sot e kujton babai.

## 1

Ishte pranverë. Koha ishte qelq, dheu shkriftohej e bëhej bukëvale. Mbillnim misër. Akoma s'ishim ulur të pinim duhanin e pasdrekës, kur Seloja më thërret që përtej jazit:

— O Teki! Lërja pendën Hysniut e hajde se na kërkon agronomi në fshat. Kështu më tha brigadieri. Merr edhe pelën me vete.

Zgjidha pelën nga shelgjishtat e jazit, ku e kisha vënë të kulloste, e i dola në krye arës:

— E ç'na kërkon agronomi? — pyeta Selon.

— Brigadieri më tha se paska ardhur pleh nga qyteti, — foli ai duke tërhequr me zor mushkën e tij, që s'donte të lëvizte.

Seloja dha e mori, po mushka në të sajën, meazallah se lëvizte. Atëherë ai shkuli një hu

nga një gardh i vjetër aty afër e, duke iu afruar asaj, tha:

— E po, druri ka dalë nga xheneti, s'thonë kot. Këtë do ti? Na!

Seloja zuri t'i binte vendçe vitheve. Mushka, pa ç'pa, u bind e ne vazhduam rrugën.

— Po ky plehu nga qyteti ç'na qenka? Pak plevica, ahure e vatha ka fshati ynë? — tha Seloja.

— Duket ato bagëtitë e qytetit e bëkan më të mirë kakërdhinë, se janë qytetare, — u përgjigja unë.

Hymë në fshat. Në sheshin e vogël, në qendër të tij, buzë një muri të shtrembër e të vjetër ku ishte shkruar si me këmbët e pulës «Të mbjellim me gara», pamë disa thasë letre të qepur me makinë e të shkruar në gjuhë të huaj.

— Erdhët? — na pyeti Fakja, roja i kooperativës, një burrë kuqërrem e inatçi si gjithë rojat.

— Siç na sheh. Ku është ai plehu i ardhur nga qyteti?

— Pse s'thua nga jashtë shtetit! Ja ku është, — tha Fakja, duke treguar me kokë thasët e shkarkuar buzë murit. — Agronomi seku shkoi. Më duket andej nga lëron traktori. Më tha t'i merrni e t'i përdorni atje ku është marrë vesh me brigadierin tuaj, Laken.

— Pse, ky qenka plehu? — pyeta unë i çuditur.

— Ky, i tëri, — tha Fakja. — Nuk i thonë vetëm pleh, ka edhe një emër tjetër... Pleh teknik. Kështu më duket se i tha Gaqoja.

Seloja grisi pak qoshen e një thesi, mori një çikë me majat e gishtave, e vuri në pëllëmbë e, pasi e vërejti me vëmendje, tha:

— Allah, allah! Mu si ilaçi që na dhanë t'ua hedhim pleshtave!

Fakja, që nuhati turbull diçka përgmuese e dyshuese për plehun, ia pati:

— Hajde, ngarkojeni e lërinin dënglat. E di kryetari atë punë. Nuk e kanë sjellë kot që prej jashtë shtetit. Merrni edhe nga një torbë të vjetër që ta shtini. Kështu më tha Gaqoja.

I ngarkuam kafshët e shkuam atje ku kishte thënë brigadieri. Shkarkuam buzë një are me grurë dhe u ulëm nën hijen e një tumbe lajthish të egra, buzë jazit. Ende pa u ulur mirë e pa ndezur një cigare duhan, erdhi brigadieri.

— E sollët?

— Ja ku është, o Lake. Katër thasë ishin.

Lakja u ul mbi njërin thes dhe nisi të shthurte qepjen.

— T'ëmën, — tha, — ç'të qepur i kanë bërë, rrufjanët, sikur është sheqer.

— Prit, prit. Kur ta shohësh ç'ka brenda, atëherë do të çuditësh, — tha Seloja.

Më në fund thesi u hap. Lakja futi dorën brenda në të, e mbushi dhe zuri ta shihte në dritën e diellit.

— Allah, allah! — u çudit edhe ky. — Ç'bën frëngu, ore! Pleh kimik.

— Mu si ai ilaçi i pleshtave, — tha Seloja.

Seloja po kruhej e po matej të thoshte diçka. Më në fund foli:

— O Lake, si ta ha mendja ty. T'i bëjë gjë bimës ky kimiku? Si e përpjetë më duket.

Lakja, si përfaqësues i administratës e si për t'i dalë zot shkencës, mori një pamje autoritare. Pasi s'diti ç'të thoshte në dobi të plehut kimik, foli:

— Ehu, sa gjëra të duken të përpjeta ty,

Selo. Unë duhet të zbraz kokën time që të mbush tënden. Oburra, pijeni atë duhan e hidhjani plehun grurit se u err. E dini si hidhet? Siç mbillet gruri, me dorë. Kështu tha agronomi. Unë po shkoj të shoh andej nga mbjellja e misrit.

Lakja iku. Ne vazhdonim të pinim duhan të heshtur.

— Ç'bën mendja, — foli Seloja prapë i menduar. — Si thua ti, Teki, ta ushqejë bimën ky?

— Vallahi, ky më shumë ngjan si ilaç e si helm se si pleh. Vështro sa erë të rëndë mban, — thashë unë duke nuhatur andej nga thasët. — Si puna e tozit të gëlqeres. Ky më shumë do ta thajë e do ta mpijë tokën, se sa do ta ushqejë.

— Ore, mos është ndonjë sabotim ky? — i shkrepën sytë xixa Selos. — Se ferra ka sa të duash. Po të më pyesësh hollë-hollë mua, ma ha mendja që ky e djeg bimën e gjë tjetër mos prit. Duket, farosi pleshtat e tartabiqet e jo grurin.

Seloja zgjidhi gjalmin e çorapes së trashë punuar me lesh të ashpër dhe kroi me thonj këmbën:

— Edhe këta pleshtat mu si borgjezët janë, — tha ai. — Rrojnë në të hazërtë, thithin gjakun e fukarasë.

Pastaj, si të ishte kujtuar për diçka, tha:

— Ore, kur s'i hodha ca nga ky kimiku, se, që është helm, kjo duket sheshit.

Seloja futi dorën në thes, mori një gjysmë grushti e ua hodhi çorapeve brenda.

— Të shohim tani. Borgjezë.

— Sikur të pyesnim edhe një herë agronomin, si thua, Selo? — kërkova mendje unë.

— E ku ta gjejmë, o lumëmadh. S'e sheh

diellin që edhe një hosten do të perëndojë. E di ç'them unë? E hedhim më mirë në ferrat lantetin? Lakes i them që ia hodhëm grurit. Se helm është, duket, të paktën le të ngordhin gjarpërinjtë. Ç'taksirat ka gruri.

— Femër ma paske atë mendje, o Selo, — e mburra unë, dhe u ngrita në këmbë.

Pas meje u ngrit edhe shoku im. Nuk e zgjatëm: mbushëm torbat që kishim marrë për këtë punë e, pasi pamë e vumë vesh se mos kishte njeri përreth, morëm me radhë mezhden e mbushur me ferra e barëra të egra.

— Kujdes, mos e hidh në një vend, se duket. Shpërndaje, — dëgjova që më pëshpëriste Seloja.

Zbrazëm torbat e para e mbushëm të dytat. Plehun e përhapnim me kujdes mbi barërat e egra e ferrat që të mos dukej. Mbaruam mezhden e parë e filluam të dytën, të tretën. Dy thasët e parë i sosëm e po mateshim të zbraznim të tjerët, kur prapa ferrave të mezhdës u dëgjua një zë:

— Puna mbarë, shokë kooperativistë! Po plehroni me gara, hë?

Ne ngrimë me torba në duar. Kësaj i thënkëshin të të zënë me presh në dorë! De, more, de! Vate edhe nderi e erzi ynë.

Që do na e bënin ngarkim plehun, kjo dukej si buka që hanim, po kushedi në ç'kallëpë do të na futnin.

Kthyem kokat dhe pamë djalin e kulakut, Xhemon. Një djalë nja njëzet e pesë vjeç, i ushqyer e i lidhur mirë, me preka në fytyrë. Dikur kishte vazhduar një shkollë bujqësore, të cilën e kishte lënë përgjysmë.

— Ti, Xhemo, qenke? — pyeti Seloja me zë të mekur.

— E, unë jam. S'më njohët, a? — tha Xhemoja. — Turp e faqja e zezë! Të hidhni plehun ferrave e gjembave! Atë pleh që shteti e blen me flori. Që tani drejt e te kryetari i pushtetit do të shkoj. Ju duheni lidhur në vend, duheni internuar. Të shpërdoroni plehun kimik ... që tani po shkoj.

Xhemoja u mat të ikte. Unë dhe Seloja iu derdhëm dhe e zumë nga xhaketa:

— Aman, Xhemo, na paç në qafë. Mos e bëj këtë, kemi fëmijë!

Xhemoja na hodhi një vështrim plot urrejtje e përçmim dhe tha:

— Kujtoni se mund të më bëni të poshtër me ato amanetet tuaja? Babai im mund të jetë ç'të dojë, edhe i poshtër e gjakpirës mund të ketë qenë. Jazëk i qoftë atij! Po unë jam i brezit të ri, që rritet e edukohet me frymën e re.

Ne dëgjonim në heshtje. E ç't'i flisnim? Xhemoja zuri të mendohej. Sytë nisën t'i ndritnin dhe heshti sikur po bënte një llogaritje të vështirë. Pastaj na hodhi një vështrim përbuzës dhe tha:

— Me vjen për të vjellë kur e kujtoj. Ju, fshatarë të varfër, ta bëni këtë punë? Unë e marr vesh që e bëtë nga padituria, po hajde e mbushua mendjen të tjerëve.

Xhemoja heshti prapë dhe mblodhi buzët. Tundi kokën i menduar e siç bën njeriu kur gjendja është me të vërtetë e vështirë. Më në fund u shkund sikur të kishte marrë një vendim të rëndësishëm e të prerë.

— Të dalë ku të dalë, nuk do ta hap gojën. Ç'taksirat kanë fëmijët të rriten pa baballarë e familjet të kalben në internim. Ne jemi fshatarë e, po s'iu gjendëm njëri-tjetrit në ditë të keqe, kur do t'i gjendemi?



Ne vazhdonim të rrinim të heshtur. Hem na vinte mirë e hem inat nga ato që dëgjonim. Na vinte mirë kur dëgjonim se ai, Xhemoja, i biri i kulakut, nuk do të na kallëzonte e kështu do të shpëtonim paq, e na vinte inat që kishim rënë në dorën e të birit të kulakut.

— Unë e kuptoj që këtë ju e bëtë për të mirën e kooperativës, se, kushedi, ky lloj plehu ndoshta e djeg bimën. Ka toka e toka. Ndofta andej nga ka ardhur, mund t'i vlejë tokës, kurse toka jonë s'është mësuar me të. Denbabaden me pleh bagëtish është plehruar. Ne që jemi me shkollë, kemi një të keqe të madhe: u besojmë të gjitha atyre që shkruhen në libra, edhe keq të jetë ... Po jo, jo. Nuk ma merr mendja. Push-teti popullor ka njerëz të zotë, që e dinë mirë se ç'bëjnë.

Xhemoja na hetoi për një çast me sy.

— Tani, që t'i vihet kapak kësaj pune, sonte fshihini thasët në ndonjë vend. Nesër ngrihuni që me natë, po, kur them qëmenatë, në orën katër të jeni këtu, dhe hidhjani grurit. Kuptuat? Dhe mos flisni me njeri, se më keq ngatërroheni. Ika, se po ju panë me mua, nuk është mirë. Hajt, bëfshi natën e mirë!

Xhemoja u zhduk në mes të ferrave po aq papritur, sa ç'pati dalë, thua se ishte i biri i tyre. Ne fshehëm thasët me pleh në mes të barërave, labotit e rrodheve, anës shelgjishtave. Morëm rrugën e fshatit, supevarur e çapërnduar, sikur të na kishte rrahur njeri.

Në të hyrë të fshatit takuam Laken:

— Hë, e shpërndatë plehun?

— E shpërndamë.

— Të gjithë?

— Të gjithë. Ashtu siç na the ti. Siç mbillet gruri, me dorë, — thashë unë.

— Të ketë dobi, o Lake, ai plehu që hodhëm? — pyeti Seloja i menduar.

— Vallahi, or ti. Një gjë që s'ta ka parë syri ... — tha me dyshim Lakja, — po kushe-di ... Nesër ju të dy do të shkoni në Selishten e Goricës. Atje do të mbjellim. Hajde, natën e mirë!

Të dy me Selon vazhduam edhe një copë rrugë bashkë, se i kishim shtëpitë në një krah të fshatit. E lamë të takoheshim rreth orës katër të mëngjesit atje ku fshehëm thasët me pleh kimik. Të paktën t'ia hidhnim grurit atë që kishte mbetur. Edhe Xhemos, që ishte bir kulaku, iu dhimbs e jo neve, që ishim të zotët e mallit.

Në shtëpi hyra i heshtur. U hodha tagji bagëtime e ndenja një copë herë në ahur, duke bërë sehir gjënë e gjallë kur përtypej. Ngaherë rrija ashtu i menduar, duke parë pa u ngopur bagëtinë. Ndieja një kënaqësi të madhe e zemra më mbushej plot. A ka gëzim më të madh për ne, sesa kur e sheh bagëtinë të shëndetshme e grurin të mbarë?

Por atë mbrëmje mendime të zymta më kishin pushtuar e s'më linin rehat. Se ç'kisha një ndjenjë të turbullt shqetësimi. Pija duhan e mendohesha. Pastaj, po kaq i heshtur, hyra në shtëpi, hëngra një kafshatë bukë aty afër gllanikut e rashë të flija.

Gjumin s'e bëra të qetë. Kthehesha e vërtitesha, dërrasat e krevatit kërcitnin e ciatnin si oshta e qerres. U ngrita shumë më përpara se të zbardhte. Ishte mesnatë. U përpoqa të flija, po gjumi më ishte arratisur.

— Pse s'fle? — më pyeti gruaja përgjumshëm. — Ti seç ke, nuk je i qetë.

Grave nuk u shpëton dot.

— Jo, s'kam gjë. Po ti pse s'fle? — thashë.

— Më doli edhe mua gjumi kur të ndjeva ty. Të ngrihem të të bëj një kafe a të të ngroh pak qumësht?

Unë i futa krahun nën qafë e zura t'i pleksja flokët nëpër gishta.

— Jo, rri këtu. S'do të hamë syfyr tani.

— Nuria do të shkojë në një kurs për mami. E fitoi ajo, — tha gruaja duke m'u afruar pranë.

— Oh, lëre ç'fitoi. Zanat putanash, — gjë-mova unë.

— Mos fol ashtu, pse e prish gojën? — kundërshtoi butë ajo duke m'u afruar. — Ti gjithmonë i përçmon e i tall punët tona. Grari hesapi, thua ti, po tani jemi njëlloj, i dashur burrë. Si tha ai shoku nga qyteti.

— E po mirë. Prit se po e mjel unë lopën, — u talla unë.

— Ndonjëherë edhe ti do ta mjelësh. Të gjitha unë do t'i bëj?

— Të shkul një vastarkë nga gardhi, të të hyj kurrizit e të ta bëj për qepë e kripë, — iu hakërrova unë. — S'do bëhemi si këmbët e dhisë. Hajt, këput qafën e mos më dërdëllis broçku-lla!

Gruaja më ktheu kurrizin e bëri sikur fjeti. Unë ndihesha në një gjendje të tillë, ku njeriu ka qejf të bluajë qetë e në vetmi mendimet e tij. Ajo e ndjeu këtë e më la të qetë.

Dikur nëpër fshat filluan të këndonin gjetlat. Unë me sytë qelq vrisja mendjen. Si e kishim hedhur tërë atë pleh ferrave e gjembave? Atë pleh që ishte sjellë nga jashtë shtetit dhe ishte blerë me flori? Njerëz të trashë jemi ne fshatarët, prapanikë. Meazallah se e hedhim një

hap përpara me dëshirën tonë, ja, mu si mushka e Selos.

Jashtë yjtë po zbeheshin. Andej nga lindja qielli sikur po merrte një dritë të bardhë. Po agonte dita. Ishte tamam koha që të çohesha. Hodha mënjanë ngadalë velenxën e u ngrita në këmbë.

— Pse u ngrite kaq shpejt? — pëshpëriti gruaja.

— Kam punë, — thashë.

— Të ngrihem të të bëj ndonjë gjë? Taz ndez llambën?

— Jo, jo. Rri atje, nxitoj.

U vesha, mora torbën varur në gozhdë dhe dola. Ajri i ftohtë i mëngjesit më ra në fytyrë e ma përzuri përgjumjen. Nëpër këmbë m'u ngatërrua me përkëdhelje qeni. Ai deshi të lozte si gjithnjë, por unë s'ia kisha vaktin. Shkova te pusi dhe u hodha nja dy grushte ujë syve. I fshiva me shaminë e xhepit, hoqa llozin e portës dhe dola.

Eca kështu nëpër terr si kuturu. Diku shkela diçka të butë e rrëshqita, sa mend rashë. Ndoshta kisha shkelur ndonjë bajgë.

Dola nga fshati ende i përgjumur dhe mora poshtë nga arat nën jaz. U afrova te shëlgjishtat, atje ku kishim fshehur thasët me pleh kimik dhe shqova një hije. Hija lëvizi.

— Selo, ti je?

— Unë, — pëshpëriti hija.

— Po këtu qenke gdhirë, o derr i derrit?

— S'më zuri që s'më zuri gjumi, — tha Seloja.

— Dje e shkelëm vënçe, me të dyja opingat. Po të paktën këtë që ka mbetur ta hedhim.

— Oburra, të mos vonohemi, se na zuri dreka, — thashë unë.

S'e bëmë të gjatë. Nxorëm thasët prej andej ku i kishim fshehur, mbushëm torbat me pleh dhe hymë në grurë. Nuk flisnim. Dëgjonim hapat e njëri-tjetrit dhe atë zhurmën e shkurtër e ritmike që bënte plehu kur binte mbi grurë.

Dita po hapej me shpejtësi e ne nxitonim. Nuk vinim ré që ishim bërë qull nga vesa e mëngjesit.

— Ja edhe kjo punë mbaroi, — tha Seloja duke shkundur mbi grurë trastën e boshatisur.

Dolëm nga gruri.

— Qenkemi bërë qull, sikur ishim në gjol, — tha Seloja.

— Shkojmë që këtej. Nuk duhet të na shohin këtu, — thash, unë, — vemi në shtëpi e ndërrohem. Mos na shohin shokët të lagur se do na pyesin.

Një të thënë e një të bërë. Shkuam të ndërrohem. Në punë vajtëm pothuaj të fundit. Mbrehëm qetë e filluam të mbillnim. Nuk isha i qetë. Mbillja e mendjen e kisha te gruri. Më dukej një punë jo e paqme ajo që kishim bërë natën. Zaten natën hajduti e hasmi punojnë. Një parandjenjë e keqe s'më hiqej e rrija me veshët ngrehur, si ai që ka vënë një minë e pret të dëgjojë shpërthimin.

## 2

Krisma u dëgjua të nesërmen. Nga larg, atje ku punonim, pamë Petritin, një djalë të brigadës sonë, që po vraponte për te ne duke i rënë arës mes për mes. Të gjithë lamë punën e drej-

tuam trupin: ç'kishte ashtu Petriti që rendte sikur kishte rënë zjarri në fshat?

— Ç'ke more, ç'të ka zënë? Fol, — i bërtitën disa.

— Gruri, u tha gruri! — tha ai përmes gulçimash.

— Si? Ç'është, more fol mbarë!

— Kaq e pati. Na u tha gruri, o shokë. Oh, të merr të qarët ta shikosh. — Djali me sy të çakërdisur mend qante nga hidhërimi.

— Ç'janë këto që po na thua, more, hëngërsh një kosh me bajgë! — nëmi më i vjetri i brigadës, xha Kristaqi, një plak i thatë e i thantë.

— Ashtu është, o xha Kristaq, që m'u thaftë gjuha e m'u këputtë që në rrëzë, — rënkoj Petriti. — Do ta ketë tharë plehu kimik. Ah, nga e hodhëm, të mallkuarin!

Sikur t'u kishte dhënë urdhër dikush, të gjithë sa ishin aty flakën veglat, morën vrapin nëpër ara e këmbët i mbajtën buzë parcelës me grurë, ku të djeshmen kishim hedhur plehun kimik. Gruri ishte shtrirë përdhe. Në vatra të mëdha, atje ku kishte rënë plehu, ai ishte venitur e shkumbosur si nga afshi i një zjarri të madh.

Të gjithë qëndruan të heshtur e krahëvarur. Si pa dashje, xha Kristaqi hoqi kapelën. Ashtu bënë gjithë sa kishin kapela në kokë, sikur po nderonin një njeri të dashur që kishte vdekur.

Kishte vdekur Gruri.

Secili u ul përtokë e ngadalë morën në pëllëmbë nga një tufëz gruri si balluke dhe e shtrënguan fort në pëllëmbë, sikur t'i jepnin jetë nga ngrohtësia e trupit të tyre.

— Po Lakja ku është? — pyeti dikush.

— Shkoi me vrap të sjellë agronomin, —  
tha Petriti.

— De, o tersllëk, de. — rënkoj Mazja, një  
burrë rreth dyzet vjeç, i zeshkët, me vetulla të  
bashkuara te hunda, duke i hedhur vështrimin  
e pikëlluar arës me grurë.

Nga larg pamë të vinin me hap të nxituar  
Lakja e Gaqoja. Turmës sonë të heshtur iu shtu-  
an edhe ata.

Agronomi i hodhi një sy të vëmendshëm e  
të mprehtë grurit, sikur të donte të përpinte  
me sy gjithë parcelën. Pastaj u ul, mori një tu-  
fëz grurë dhe filloi ta vështronte me kujdes.

— Nuk ka mundësi, — tha, — nuk është e  
mundur.

Zuri ta vështronte prapë me vëmendje tu-  
fën e grurit e papritur pyeti:

— Lake, kush e shpërndau plehun?

— Tekiu me Selon. Pse?

— Ne e hodhëm, — foli edhe Seloja.

— Kur e hodhët?

— Që atë ditë, pasdrekëherë. Me të na thënë  
brigadieri, e morën me hajvanë, e sollëm këtu  
dhe e shpërndamë. Ti kishe shkuar nga trakto-  
ri, me duket. Kështu na tha Fakja.

— E si e shpërndatë?

— Ja, mbushnim torbat dhe e hidhnim sikur  
mbillnim grurë. Kështu na tha Lakja, — sqaroi  
me zë të dredhur Seloja.

Gaqoja uli kokën dhe heshti. Pastaj, duke  
përshepëritur, tha:

— S'është e mundur, nuk është e mundur.  
Se mos ndoshta gruri ishte i lagur? — kërkoi  
një rrugëzgjdhje ai.

— Jo ... gruri ishte i thatë, koha ishte e  
mirë. Pse?

— Sepse ka vetëm një shpjegim: ose plehu është hedhur kur gruri ka qenë i lagur ose me vesë, ose thasët s'kanë pasur plehun që tregonte formula kimike e shkruar në ta po ndonjë lëndë tjetër, — tha Gaqoja me bindje. — Ju thoni që e hodhët pasdite, apo jo?

Unë e Seloja thamë po. Nuk kishim guxim të prananim para gjithë atyre burrave, në fytyrat e të cilëve ishte shkruar dhimbja, atë që kishim bërë.

— Dhe gruri ishte i thatë.

— Po.

Gaqoja pështyu përdhe me urrejtje.

— Revizionistët e djallit!

— Thua kemi të bëjmë me ndonjë sabotim? — pyeti Seloja, të cilit, siç dukej, i erdhi pas midesë kjo ide.

— E pse çuditesh, o Selo, — tha dikush. — A s'të sabotuan ata në Rrogozhinë e në Maliq? A s'po mundohet të të sabotojë armiku edhe këtu ku je? A s'ta bllokoj makinën shirëse kulaku? Ah, ç't'u bëj ligjeve, pa e dija unë si llafo-sesha me ta, — tha një djalë flokëgështenjë, i ngjeshur e rronokop.

— Vallë bën për vendin tonë ky pleh, or djalë, — tha më plaku që ndodhej atje, xha Kasoja. — Plehu i bagëtisë, ai po. Ai është i uruar prej të madhit atje lart.

— Rri, o xha Kaso, e lëre të madhin rehat, — tha me vrer Gaqo agronomi. — Pak fjalë hapin kutakët, po duhesh edhe ti ...

Plakut i lëvriu damari i ballit, po nuk foli.



Kaluan javë e muaj nga ajo ditë. Unë e Seloja shkonim shpesh nga ajo parcelë dhe shihnim bimët e rralla e të drobitura që kishin shpëtuar nga djegia e plehut. Shihnin edhe ferrat e barin që ishin rritur e bërë livadh sa humbte viji motak. Vetëm ne të dy dhe i biri i kulakut e dinim pse hazdisej bari ashtu e pse ferrat e kishin fletën aq të gjelbër e aq të madhe.

Kujtdo që i binte rruga andej ndalonte një hop e, duke krahasuar grurin e rrallë me barin e dendur e ferrat, thoshte: «Ç'na bëri ai plehu kimik, ç'na bëri! Ja, si ky bari do ishte hazdisur edhe gruri, po të mos ia kishin hedhur atë helm! Ai e farmakosi!»

Unë e Seloja në biseda të tilla s'bënim zë hiç e tulatashim të heshtur e të vrenjtur si re e zezë. E tek i shihnim ato fytyra fshatarësh që u qante syri, na sëmbonte në zemër sa s'ka më. Ndoshta ishim të vetmit në të gjithë fshatin që ishim të bindur për dobinë e plehut kimik.

Në fshat, si vetvetiu, u përhap një fushatë e gjerë kundër plehut kimik. Këtij zjarri i frynin me zell edhe njerëzit e kulakut e prapanikët. Zjarri u rrit e u bë aq i madh, saqë njerëzit e thjeshtë e të paditur as që dëgjonin t'u flitej për ndonjë metodë të përparuar a për ndonjë shërbim bujqësor, se të tregonin parcelën e grurit nën jaz:

— Ja, — thoshin ata, — i njëjti vend është. Atje ku u hodh plehu kimik, shikoje grurin, si mjekra e qoses. Ja edhe bari e ferrat tre metra më tutje si janë përhedhur. Shkenca, shkenca! Hë, ku ma keni shkencën? Ja shkenca juaj, ju rruat!

Lajmi se në fshatin tonë u dogj gruri për shkak të plehut kimik, u përhap edhe në fshatrat rrotull e, sa më larg që shkonte lajmi, aq më shumë shumëfishohej dëmi që kishte bërë ai. Në një fshat buzë Moravës, tregonin, ishin ngritur të gjithë, të mëdhenj e të vegjël, kundër një makine me pleh kimik që kishte ardhur për atje aq sa shoferi shpejtoi të kthente makinën e të ikte andej nga kishte ardhur sa pa ngrënë ndonjë dru të mirë.

Mua e Selos na rëndonte keq sekreti i asaj pune të poshtër që kishim bërë, aq sa na dukej sikur po na fryhej barku dhe e fshehta merrte më të dalë jashtë. Sa më e lehtë do kishte qenë t'ua kishim hapur zemrën shokëve e agronomit që atje në parcelë atë ditë! Njëqind herë më mirë të na shanin e të na pështynin e madje edhe të na dënonin shokët. Ne, me dorë në zemër, do t'u thoshim se aq na e preu e se u përpoqëm për mirë, paçka se na doli keq.

Sa herë që takoheshim me Xhemon, ky na buzëqeshte lehtë dhe na shkelte syrin, si të ishim shokë të një komploti. Kjo na tërbonte aq sa mend vinim ulërimën: ne, bujqit e thjeshtë, ish-hyzmeqarët e uritur të kulakëve, të ishim bashkëfajtorë me Xhemon, pinjollin e pasardhësin e atyre që na rropën! E sot ne kishim rënë aq poshtë, sa ai të na shkelte syrin sikur të na thoshte: «Mos kini frikë, unë nuk ju kallëzoj. Ju jeni njerëzit tanë». Kur i mendonim këto seq na hipte nga një damar e na përvëlonte një dëshirë: ta kishim atë Xhemon atje e ta bënim siç dinim vetë.

Kishin kaluar dy-tre muaj nga ajo që ngjau, e koha si mbi çdo gjë hodhi pluhurin e saj të harrësës edhe mbi atë hynerin tonë. Njerëzit u ngopën së mbrojturi e së shari plehun kimik, përfaqësuesin fatkeq të shkencës në fshatin tonë. Vetëm ne nuk mund të harronim.

Një ditë, ishte kohë dreke, kishim mbrehur qetë, ishim ulur nën hijen e shelgjeve e po hanim drekë. Prapa shpinës sonë nëpër bar u dëgjuan ca hapa të lehtë e më pas një zë:

— Ju bëftë mirë, o kooperativistë!

Ishte Xhemoja, i biri i kulakut.

— Hajde të hamë, — i thamë në një zë, më shumë për hir të zakonit se nga dëshira.

— Ju falem nderit, nuk dua t'ju ha racionin, se kooperativa ka racion, apo jo? Po ia dhe shokut, mbetesh vetë pa ngrënë.

— Nuk është ashtu, e Xhemo, — tha Seloja. — Hambarët plot i kemi. Për vete, për miqtë e për shokët. E në na u mbaroftë neve, shteti s'na lë në baltë.

— Ashtu është, xhanëm, ashtu, — mezi e kapërdui atë kokërr të hidhur Xhemoja. — Po unë e kisha fjalën gjetkë; kur të keni ndonjë nevojë e ndodheni ngushtë, hajdeni te ne. Kështu më tha babai t'ju them. Ju ju kishte argatë të mirë, ju donte shumë. Mos t'ju vijë zor të kërkonit, se huanë e ka dhënë perëndia. Merrni e na e ktheni kur të doni. Si i thonë fjalës: kur të keni me thes, na e ktheni me torbë.

Pashë nga Seloja. Edhe ai e kishte lënë bukën si unë.

— Falem nderit, po s'kemi nevojë. Ka shteti për ne, — tha Seloja.

Xhemoja këputi një lastar shelgu dhe nisi ta mbështillte e të çmështillte nëpër duar. Pastaj u zgërdhi e tha:

— Ka shteti, thua ti? Po ç'thotë Radio-Londra, pa!

Unë u shqetësova. Ja ku po mundohej të na fuste nëpër thekra i biri i kulakut. Ja ku pandehte se na kishte shtënë në dorë me atë historinë e grurit e kujtonte se ne tani s'mund të bënim as gëk nga frika se na kishte hedhur zinxhirin në hundë e mund të na zvarriste ku të donte ai. Zëmërimi po më ziente përbrenda:

— Ore, me kë flet ti kështu, me tët atë? S'na duhet gjë ajo Londra neve, kemi Tiranën, — shfryva unë.

— Me kë flas unë? Flas me ata që dogjën grurin e kooperativës me dashje. Flas si me njerëzit e mi!

Seloja bëri një lëvizje të papritur. Në fytyrë ishte nxirë. Xhemoja, që nuk e vuri re ndryshimin e tij, vazhdoi:

— Sa bukur ia hodhët atij agronomit, hë? Meqë ra fjala, pse të mos u thoni grave tuaja se ajo Nurija do të shkojë në kurs kastile që të bëjë avaze me Gaço agronomin në qytet, se ata e kanë ujdisur bashkë. Gratë le t'u thonë shoqeve e kështu lot huri në kurriz të Gaços e të Nurijes.

— Huri do të lozë në kurrizin tënd, o derr i fëlliqur i kulakut! — ulëriu Seloja e pa u bërë merak se ç'kishte në pëqi, kërceu në këmbë, duke flakur tej lugën, bukën e çanakun.

Iu vërsul si demi kur e zë gjaku dhe e mbërtheu për fyti. Të dy u kacafytën dhe ranë përdhe. Zunë të rrokulliseshin duke hipur sipër herë njëri, herë tjetri.

Unë kërceva përpjetë si i kafshuar nga grera dhe renda të rrëmbeja hostenin. Dëgjova një ulërimë dhe zërin e Selos:

— Ouu, më griu me dhëmbë e me thonj, o m'i lëroftë gomari kulaken! — shau ai ashtu siç dinë të shajnë në Devoll

Pashë Selon të çakërdisur, që kishte futur kokën e Xhemos midis shalëve të veta e me duar e kishte mbërthyer për shpatullash.

— Bjeri, o t'u thafshin! — më thirri mua.

Unë s'prita urdhër të dytë, ngrita hostenin dhe:

— Këtë për Selon ... këtë për pleh kimi-kun ... këtë për mua ... këtë për tët ëmë ... për tët atë ... për gjithë soj e sorollopin tuaj.

Hosteni u thye. Vrapova e mora tjetrin. Xhemoja ulërinte e vërriste si derr i egër i plagosur me saçma:

— Do t'ju denoncoj, ju kam në dorë. Ju jeni bashkëpunëtorë me mua. Ju e dogjët me qëllim grurin! ...

Zëri i Xhemos e humbi fuqinë, u zgjat e u mek. Seloja e lëshoi si thes trupin e tij të këputur. I kishte humbur ndjenjat.

— Se mos e vramë fare, derrin, — tha Seloja, i trembur.

— Në xhehenem të gomarëve të vejë! — thashë unë i ngopur me hakmarrje. — Shkojmë t'i themi kryetarit e fshatit se s'ka faj plehu kimik, se ai është i mirë, se grurin e dogjëm ne.

## Traktori i parë

### 1

Prej ditësh ai nuk kishte shkuar në shtëpi. Ishte ushqyer e kishte fjetur si kishte mundur. Sapo pati përfunduar njëra fushatë e ja tek ishin hedhur te tjetra. Puna ishte në vllug e i duhej ndenjur qiri mbi kokë.

Ashtu përgjumshëm solli ndër mend se si e kishte kaluar ditën. Iu kujtua traktori me defekt i Irfanit dhe ngastra që la përgjysmë. Iu kujtua halli i traktorist Jovanit e, nga frika se mos i dilte nga mendja, nxori me të shpejtë bllokun e shënimeve dhe shënoi me një shkrim të zvarritur: «Jovani nga data trembëdhjetë kërkon dy ditë leje. Në vend të, tij të dërgohet Perlati.» Pastaj iu kujtua premtimi që i kishte dhënë djalit për ta bërë bashkë kafazin e pëllumbave dhe së fundi kujtoi se ishte caktuar i deleguar në mbledhjen e një organizate të bashkimeve profesionale.

Mbylli bllokun e shënimeve dhe mbështeti përsëri kokën mbi llërë. Ishte gati të dremiste, kur dera u hap e te pragu i saj qëndroi një plak i rreshkur me mustaqe të thinjura e të rralla si të mbjella me dorë.

Plaku u step në derë e sytë e përgjakur nga mosha i picërroi sikur të mos u besonte:

— Do paguash hotelin, shoko.

Pastaj, duke shënuar me shkop, pyeti:

— Ti je brigadieri i brigadës së traktoristëve?

— Po, unë, — pohoi Sherifi dhe u ngrit në këmbë.

— Bukur, besa! Tërë bota punojnë, ndërsa ti bën gjumin e shqerrave. Bukur besa bukur! Gjynah që s'ka sjellë një krevat kryetarja këtu. Prandaj edhe punët atje lart venë kaq mbroth.

Sherifit i vërshoi gjaku në fytyrë e u inatos më shumë me veten sesa me plakun.

— Unë nuk po flija, xhaxha, por ndodh që ndonjëherë, ashtu, si pakuptuar ... — filloi të shfajësohej Sherifi.

Plaku e ndjeu epërsinë e tij dhe u krekos:

— Posi, posi, ashtu si pakuptuar! Të tëra ashtu si pakuptuar u bëkan! Edhe uji që shkon kot, edhe buburreci që ha patatet, edhe traktori që nuk vjen. Po ne ç'bëjmë? Ne, domosdo ia këputim gjumit.

Sherifi s'dinte ç'të thoshte. Plaku s'po e linte të mblidhte veten.

— Xhaxha, si e ke punën? Ke ndonjë hall? — pyti Sherifi.

— Kam, posi. Të madh, bile. — Plaku u ra me gishtërinj mustaqeve: — Kur do ta dërgoni traktorin në Dedinat? A e di ti, o shoko, se tokat në Dedinat edhe tri-katër ditë durojnë? Në

i plugove edhe për tri-katër ditë, mirë, në s'i plugove, kot mundimi pastaj. Dëgjon? E ja ku po ta them, unë nuk shkulem që këtej pa e dërguar traktorin lart në Dedinat, dëgjon ç'të thashë? O vete traktori lart, o s'ka derman! Kështu më thanë edhe pleqtë e tjerë të fshatit: mos u ndaj pa e marrë traktorin.

Sherifi buzëqeshi. Dedinat! Ky emër u përkiste kujtimeve të tij. Papritur sytë e plakut iu dukën të njohur. Edhe zëri, megjithëse pak më i çjerrë, iu duk i dëgjuar. Po t'u shtojë këtyre gjestin e të shtruarit të mustaqeve, si dhe krekosjen e plakut, s'kishte sesi të mos kujtonte xha Arifin e dikurshëm. E, duke i ndritur fytyra nga ngazëllimi, Sherifi thirri sa i hante zëri: — Do na ngordhësh për bukë, o kaur!

Plaku shtangu, rrudhat iu sheshuan e krekosja iu zhduk si me dorë, ndërsa Sherifi shtynte tej karrigen e, duke shtrirë dorën, i thoshte: «Si të kam, xha Arif? S'më njeh? Jam Sherifi, Sheroja i vogël. A mbahesh? Sheroja, ore, ndihmësi i Naumit, traktoristit!»

Plaku hapte sytë i hutuar e mekanikisht i dha dorën tjetrit.

— More bir, s'po të njoh, mos ma vër re, u plakëm tani, u matufosëm, na rrodhën trutë. — Plaku buzëqeshte pak si i turpëruar, sikur donte të shfajësohej.

Sherifi shtrëngoi me dashuri plakun pas vetes dhe ishte gati ta merrte hopa në krahë.

— Jam ai djali i vogël, ndihmësi i traktoristit që solli traktorin e parë në fshatin tuaj, këtu e njëzet e ca vjet të shkuar, — dhe përsëri e shtrëngoi plakun fort ...



Nëpër rrugën e ngushtë që gjarpëronte përmes ferrave e gorrive, ngjitej me nxitim një burrë i thyer në moshë, hipur mbi një gomar gërdallë. Dukej që atje tej që udhëtari nxitonte, se dendur e godiste me thembrat e opingave barkun e kafshës e i shponte vithet me majën e një shkopi. Rruga ishte e thyer e hejbet ishin të rënda, ndaj gomari shkrofëtinte dhe ishte gati t'ia merrte pallmës përvaishëm. Diku ndaloi një hop të mblidhte veten, po burri, sikur ta kishte pritur këtë, ia ngjeshi vendçe me shkop e me opinga:

— Ush, ush, o të çaftë ujku!

Kështu eci derisa hyri në fshat dhe pasi kaloi plevicat e para, u ngrit me këmbë mbi shkallinat e gomarit e, si të ishte ndonjë kalorës që sillte kushtrim lufte, thirri:

— Berihaj, o fshat!

E, pasi pa që nga dyert, dritaret e mbi avllitë u zgjatën tek-tuk koka njerëzish, vazhdoi:

— Fshatit po i vërtitet një re e zezë. Nesër na çatis mbi kokë!

Si tha këto fjalë, zbriti nga kafsha dhe filloi të shkundte poturet e pluhurosura e të ndreqte hejbet. Ndërkaq rreth tij u afruan një duzinë njerëzish. Në fytyrat e të gjithëve shkruhej kurreshtja e përzier me frikë.

— Ç'është kjo gjëmë që po na tjerr, o Arif, fol, të shkretën! Mos ata përtej do hedhin prapë diversantë? Në është kështu, na thuaj të rrëmbejmë armët e t'u tregojmë vendin, — foli i pari Sefja, anëtar i këshillit të fshatit.

— Jo, o Sefe, jo, nuk do vijmë diversantë, po do vijë ai, more, ai, si i thonë lanetit ...

— Arifi zuri të vërtiste rreth çaçkës së kokës

festen e zbërdhulët, sikur ta kishte aty emrin që s'i kujtohej.

— E po nxirre, o Arif, se na plase, ç'është ai që do të vijë?

— Ai, more, si i thonë ... traktori, de!

Gjindjen e mbuloi heshtja. Burrave u ra një hije e rëndë në fytyrë dhe lëshuan krahët si të prerë. Gratë shkulën faqet dhe vrapuan të mbylleshin në shtëpi, thuajse në fshat do të vinte bajlozi i detit.

— E ç'u pretë kështu në fytyrë, sikur po vjen beu, o shokë? Po ky është një sihariq, o vëllezër, — u hodh e ia pati me zë të lartë Astriti, një djalë i shëndoshë që sapo ishte liruar nga ushtria.

— Pa mbylle gojën ti, atë bëj! S'të kërkoi njeri mendje ty, — ia priti vrazhdë xhaxhai i tij, një burrë me xhakëtë e poture me arna një mbi një si tjegullat e çatisë.

— E kështu, o shokë, na gjeti që na gjeti e liga, — tha tërë helm e vrer Arifi, — po mbahuni të mbahemi, se, po nuk deshëm vetë, qeveria nuk na e jep me zor. Pushteti është yni e do të na e dëgjojë llafin. Puna është të mos përçahemi e të mbajmë karar.

— Po ku e more vesh ti, o Arif? A është llaf sagllam apo teje-meje? — pyeti dikush.

— Sagllam, s'e luan gjë. Vetë instruktori i Partisë, Thimi, më poqi në qytet e më tha se sonde do të vijë të bisedojë shtruar me fshatin për punë të atij mavisë, traktorit, de.

— Po ti, ç'i the, o Arif?

— E ç'ti thosha unë i varfri! Ti mirë se të na vish e të lumshin këmbët, — i thashë, — po, sa për atë lanetin, kot e keni që mundoheni për

ne. E ç'na ka gjetur gjer më sot pa traktor? Si kemi bërë, do bëjmë. Fshatari, — i thashë, — tokë të ketë pa, po erdhi puna, edhe gomarin e mbreh, edhe vetë mbrehet e tokën s'e lë pa lëruar. E ç't'i thosha tjetër? Ai qeshi, më ra shpatullave e më tha: «Do bisedojmë, Arif, do të bisedojmë shtruar atje në fshat.»

### 3

Arifi s'pati kohë as sa të mblidhte kockat nga rruga, kur te porta u dëgjua një zë fëmije që thirri:

— Në orën gjashtë mbasdite ka mbledhje fshati te shkolla. Të vijnë edhe individët.

«Or, po këta individët ç'i duan», shkrofëtiu Arifi që u ngrit nga minderi ku kishte rënë dhe futi këmbët në opinga. Pastaj me hapa të ngadaltë u nis për te shkolla.

Shkolla fillore ngrihej majë një bregu në mes të fshatit. Atje dikur kishte qenë posta e xhandarmërisë, nga e cila ruante ende zymtinë dhe dritaret e ngushta me hekura të kryqëzuar. Në klasën më të madhe kishin vënë dy llamba me vajguri, që krijonin në mure ca hije të dyfishta pa formë e të stërzgjatura, që krijonin ca figura të pakuptimta e luhatëse e i jepnin dhomës një pamje të çuditshme, pothuajse fantastike.

Sapo vuri këmbën brenda, Arifit i ra në fytyrë ajri i nxehtë e i rëndë i dhomës së mbushur plot me njerëz. Ishte një afsh, ku përzihej era e djersës dhe e tymit të duhanit. Në murin përballë, mbi presidium, ishin vendosur dy portre-

te të mëdha, i Enverit dhe i Stalinit, të rrethuara me kallëz gruri. Poshtë tyre, në një beze të kuqe, shkruhej me shkronja të mëdha: «E mira fshatarit do t'i vijë nga kooperativa bujqësore.»

Njerëzit bisedonin grupe-grupe. Një plak, me lëvizje të ngathëta, ngjishte duhanin në lullë, një tjetër shkundte opingën, duke e përplasur fort pas bankës, e një i tretë gdhendte me thikë një bisht lopate. Në qoshen më të largët e më të errët kishin zënë vend graria e fshatit, shumica punonin me shtiza.

Arifi çau ngadalë e shkoi të ulej te një grup burrash të thyer në moshë. Në mes tyre ai njohu Thimin, instruktorin e Partisë.

— Mirë se na urdhërove, o shoku Thimi, e të lumshin këmbët! — përshëndeti Arifi.

Thimi u ngrit, i shtrëngoi dorën të porsardhurit dhe e pyeti:

— Po hë, Arif, si erdhe? A u lodhe ndopak?

— E po rrugë, është, e Thimi, edhe lodhemi. Majë kafshëve erdha e jo majë tromobilit.

— Edhe automobilë do të sjellim, o Arif. Do të ndërtojmë rrugë të drejta e të gjera, do të sjellim makina, traktorë e radio. S'do të rrojmë siç kanë rrojtur pleqtë tanë. Sot të gjitha tonat i kemi. E pse të mos rrojmë mirë?

— Ashtu. Të lumtë goja, o shoku instruktor, po, sa për ato makinat e tromobilat që the zotrote, zor se vijnë dot këtu. Jemi mal këtu, or tungjatjeta, rrëzohet cjapi e thyen qafën. Ndryshe është fusha, — foli rënd-rëndë një plak i vjetër, duke i dhënë xixë eshkës me masat.

Thimi u mat diç t'i thoshte plakut, po Nurja, kryetari i këshillit të fshatit, i foli me zë të ulët:

— Shoku Thimi, unë them të fillojmë. Pothuajse tërë fshati është mbledhur.

— Po pse, a nuk kemi filluar? — pyeti instruktori dhe iu drejtua të tjerëve që ishin më larg:

— Afrohuni, afrohuni, shokë! Edhe ju, shoqe, afrohuni më pranë, se s'dëgjohet deri atje. Pastaj, s'ju dëgjojmë dot as ne, kur të thoni mendimin tuaj.

Nëpër gratë kaloi një e kukuritur me zë të ulët e si me turp dhe, duke shtyrë njëra-tjetrën, ato u afruan më pranë.

-- A e dini, o vëllezër e motra, përse kemi ardhur unë e ky djali këtu?

— Për sihariq, o shoku Thimi.

— Pushteti ka menduar t'i dërgojë fshatit tuaj një traktor për ndihmë, — rimori fjalën Thimi. — Ne e dimë që fshati juaj është ca dorëhollë ashtu si edhe shumë fshatra të tjera. Kooperativën e keni të dobët, se sapo e keni ngritur dhe është ndër të parat kooperativa malore në vendin tonë. Edhe bujqit individë nuk janë më mirë. Shumica e tyre pothuaj nuk kanë kafshë pune.

Thimi hodhi një vështrim rreth e qark njerëzve që heshtnin. Por kjo heshtje nuk qe miratuese. Njëri iu shmang vështrimit të tij, tjetri kroi shpinën, një i tretë u kollit më të thatë, ndërsa i katërti foli:

— Këtu, or djalë, është rrëpirë, mezi qëndron kau e jo më traktori. Apo të rrëkëllehet e të vejë në fund të përroit, që të mblidhet tërë fshati me kuç e me maç e të mos e nxjerrin dot.

— Që ta paguash edhe me qimet e kokës pastaj, — qesëndisi një tjetër.

— Mirë e ka Xhezua. Traktori do Myzeqenë e jo rrëpirat tona.

— Mal, mor byrazer, ç'e nget më tej? — u hodh e tha Arifi duke veçuar me buzë një letër cigareje.

— E dini si më duket kjo puna e traktorit në fshatin tonë? Njësoj si të duash t'i vësh shalë gomarit, — tha një burrë i rruar taze.

— Se mos ke folur ndonjëherë për hair ti! Ters ke folur tejmbanë, si Ters i Pojanit. Unë them të vijë traktori, o shokë. Kam parë andej nga isha ushtar. Hej, ç'të lëruar që bënte! — tha Astriti me zjarr.

— Mos merrni mendtë e atij kërthinjaku, o burra. Traktori e ngjesh dheun, e bën top e prit të mbijë bari pastaj. Këmba e kaut është e bekuar nga perëndia. Nga tjetër gjë s'ke hair.

— Ti, Azem, ç'thua? — pyeti Thimi.

— E ç'e pyet Azemin, o shoku instruktor. Nuk presim të na japë Azemi mend neve. Ai, po të ishte aq i ditur, nuk rrinte individ, po hynte në kooperativë.

Burri që gdhendte bishtin e lopatës brofi në këmbë duke shpërndarë ashklat përreth:

— E jo, Bame, jo. Më dhembset toka mua, se më ka rënë bretku duke pastruar gurët e duke sjellë dhé të shëndoshë në kurriz e s'kam ndenjor me duart në b . . . si ti. Po je bërë ti, o Bamja i Myrtos, të ngasësh qetë e mi, që i dua barabar me fëmijët?

Burri shkumëzonte nga inati, aq sa Sheriff pandehu se do t'i derdhej tjetrit.

— Azem, mjaft, se e teprove, — ndërhyri Thimi.

— Më dogëndisi, o shoku Thimi, s'e dëgjo-

ve? Pse, qenkam unë kulak? Bujk si të gjithë jam. Në jam ca më mirë, me të rropatur e kam fituar.

— E kishim fjalën te traktori, Azem. Si thua ti, a është punë me mend të vijë traktori këtu?

Azemi heshti. Duart, dy duar të mëdha, duar të vërteta bujku shtrënguan fort dërrasën e bankës, sikur do të përgjigjej në mësim.

— Ne jemi njerëz të paditur, o shoku Thimi, e për çdo gjë që s'na e rrok mendja themi «s'bëhet». Sikur të bëhet njëherë provë, them ...

— Posi, posi! Të bëjmë prova thotë. Po provat do bëhen në tokat e kooperativës, ama, e jo në të Azemit, se Azemi ato s't'i lë t'i shikosh as me dylbi, e dëgjuat vetë. Burrë i mençëm fort ky Azemi, — tha me vrer Bamja.

— Kot që përplasni këmbët e lodhni gur-mazin. Traktori nuk vjen dot këtu, sikur dhëmbin dhëmballë ta bëni, — tha një burrë i veshur me shajak, si për t'i vënë kapakun këtij muhabeti.

— Mos ia vini veshin, o shokë. Ai gjithnjë prapsht ka folur. Edhe për plehkimikun kështu thoshte: «e djeg bimën». Po shiko, o të plaçin, se ç'grurë flori u përhodh nga plehu kimik, — tha një burrë ezmer rreth të tridhjetepesave.

— Ore, mbaj gojën, se unë ta vë kufinë te dardha, — iu hakërrua tjetri.

— Ti të ma vësh kufinë? Po unë rroj një mijë vjet prej teje, mor këlysh i kulakut!

— Me të lypur mund të rrosh edhe dy mijë.

— Kush lyp, mor qen e bir qeni? — shfryu ezmeri dhe iu sul bashkëfolësit.

Ata që ishin përreth e mbërthyen për kra-hësh, të tjerët mundoheshin ta qetësonin, ndërsa ai shkumëzonte.

— Po unë të shkëlqimë, mor qen i zgjebosur i kulakëve! Unë lyp? Ti lyp te kulakët. Pale, po thua që s'vjen dot traktori këtu. Nga inati yt e i gjithë kulakëve do ta sjellim jo këtu, por edhe lart në Dedinat, që ju të pëlcitni në vend si shushunjat! Po, ore, po, se shushunja keni qenë. Po tani, ëhe, ma morët të keqen, s'kafshoni dot, jua shkuli populli dhëmbët!

Në klasë plasi shamata e rrëmuja. Këto i shtoi edhe më shumë thyerja e njëres prej llambave. Të gjithë filluan të flisnin njëherësh, të shtyheshin e të shaheshin.

— Nuk e duam traktorin!

— Fjalë me mend. Nuk e duam!

— E duam që ç'ke me të!

— E punojmë vetë tokën!

— Ngrihem, burra. Mori fund. S'e duam traktorin!

Sherifi dëgjonte me ankth e një si mëri e hidhur i shtrëngonte fytyrën, sikur ata fshatarë të veshur keq e të ashpër, në vend të traktorit po shanin babanë e tij të vranë. Gjindja u luhet si gruri kur e fryn era. Fronat kërcitën. Disa morën për nga dera, por një zë, që u ngrit përmbi të tjerët, i ndali në vend:

— Prisni, ku shkoni?

Të gjithë qëndruan ashtu siç i zuri zëri urdhërues. Në heshtje ata kthyen kokat nga instruktori i partisë që qëndronte në këmbë i ngrysur e i pezmatuar:

— Ku shkoni, o vëllezër? Pse, kështu shtrohet në kuvend burri? Kështu e thotë fjalën e tij?

Ata që ishin nisur të dilnin u kthyen si të turpëruar e mëdyshas.

— E ç'të rrimë, o shoku Thimi? Atë që ki-



shim për të thënë e thamë. Bëjmë edhe pa traktorin, — tha duke u kthyer njëri.

Në klasë ra një heshtje ngrice.

— E dini si them unë? — foli me ton pajtues një burrë i vrarë lie në fytyrë. — Jemi që jemi mbledhur këtu, t'i dërgojmë një letër fshatçe pushtetit në rreth e t'i themi që nuk duam të na vijë traktori. Boll mirë jemi tani. Reforma Agrare na dha tokë. Edhe kooperativën e ngritëm, paçka se nuk e kemi mëkëmbur akoma. Tani puno e rro. Traktori është për krahëthatët e dembelët.

Ai do të shtonte edhe diçka tjetër, sikur të mos e kishte ndërprerë Nurja, gjaknxehëtë e i paduruar:

— Ama, ç'na dërdëllise edhe ti, Mane. Gjer tani grive e grive sa u ngope e veresie fole. Traktori do të vijë, se kështu thotë Partia e pikë! Ai që s'e do traktorin, s'do Partinë, — ia preu shkurt Nurja.

Burrit i kërceu damari i ballit.

— Dëgjo këtu, ti, Nure Panja. Kur i kam ngrënë unë plumbat me grushte për Partinë, ti luaje cingël, prandaj mos më fut në ato thekra mua, se s'ndahemi mirë bashkë. Unë s'e dua traktorin, po Partinë e dua, se ajo më dha selishtën e Xhelal beut e, po më përzjeve me ata që s'e duan Partinë, ta dish se më ke shkelur në kallo. Në je kryetar këshilli, qofsh shëndoshë!

— Këto punë nuk zgjidhen me të thirrur e me të zënë, — e mori fjalën Thimi. — Ti, Nure vëllai, bëre gabim kur i the Manes ato fjalë. Të jesh i paqartë e të mos kesh besim në diçka që akoma s'e ke parë e provuar, nuk do të thotë se je kundër Partisë. Të jemi të bindur se e reja është e mirë dhe e vlefshme e jo ta zbatojmë qorrazi, vetëm për të mos ia bërë fjalën dy Par-

tisë. Ja, ti, xha Shazo, ç'thua? Të kemi bujk të mirë e burrë të drejtë, — iu drejtua Thimi një plaku që deri atëherë vetëm kishte heshtur.

Plaku, pasi u përtyp një copë herë, kërciti gishtërinjtë e trashë dhe foli:

— Mua plaku, pastë rahmet, gjithnjë më thoshte, i varfri, që insani prandaj ka dy veshë e një gojë, që më shumë të dëgjojë se të flasë. Po meqë më kërkua mendje, ja ku po them edhe unë dy fjalë. Unë traktor nuk kam parë, sa i madh është e ç'tagji ha. Por di të them këtë, o vëllezër, saqë na e jep Partia, domethënë që është i mirë.

— Kaq e patën taksiratet tona, o Mete. Tani vër kapën mbi sy e bëj sehir. Traktori ka borxh që brenda orës ta kthejë së prapi tërë tokën e fshatit.

— Po nga ju shoqet nuk dëgjuam asnjë të flasë, si mendoni ju? — pyeti Thimi. — Ja, ti atje, si thua, moj shoqe, të vijë traktori apo jo?

— Kush, unë? — pyeti e trembur nusja e re dhe u ngjesh pas shoqeve si me frikë. Pastaj, e turpëruar, tha:

— E ku di unë e shkreta! Burrat i dinë më mirë këto punë. Po ja ...

Një foshnjë ia plasi të qarit. Gruaja që e mbante mundohej ta qetësonte duke e tundur, po s'qe punë që bëhej. Foshnja çirrej sa i hante zëri.

— Dil jashtë, moj ... — i foli ashpër i shoqi, Arifi. — Prit të të japin mend gratë pastaj, — qesëndisi ai. Gruaja s'dinte ku të futej nga turpi. E kuqe flakë në fytyrë doli këkullur.

— A të them edhe unë një fjalë, — tha një plak sybardhë duke shkundur poturet. — Siç e kemi nisur, zor se mbarojmë edhe për një javë.

Ca thonë të vijë traktori, ca të tjerë thonë të mos vijë. Ju të gjithë keni qenë në pazar dhe e keni parë e provuar vetë. Ai që e ka mallin, i thotë më shtrenjtë se ç'është. Ai që do ta blejë, ia ul më poshtë sesa vlen në të vërtetë, ja, këtë bëjnë. As nga imja as nga jotja. Edhe unë kështu them: t'i biem shkurt hesapit. Të lërojmë nja dy ngastra sa për provë.

— Jo. Toka do të lërohet e gjitha me traktor. O e gjitha, o hiç, — ia preu shkurt Nurja.

— Kurse unë jam dakord me mendimin e xha Agushit, — tha Thimi. — Fundja le ta provojmë në disa ngastra. — Nurja u kthye i habitur nga instruktori. Ky vazhdoi: — Jeni dakord të lërojmë Kulat?

Në sallë u ndeh heshtja:

— Do na ngordhësh për bukë, o kaur! — e çau heshtjen një zë i revoltuar.

Të gjithë kthyen kokat andej nga erdhi zëri dhe panë Arifin me çehren shafran e sytë të zgurdulluar.

Në çast Arifi e kuptoi se e kishte kaluar cakun dhe vazhdoi me ton më të zbutur:

— A e dini, mor shoku instruktor, që fshati ato ka tokat më të mira? Po nuk prodhuan ato, ne ç'të bëjmë? Të ngrohemi në diell? Apo të marrim çairot?

— Unë them të lërojmë Dedinat, — u hodh e tha një tjetër. — Le ta provojmë atje. Ato pllogë që pllogë janë.

Ashtu u la. Mbledhja mbaroi.

Njerëzit filluan të shpërndaheshin. Nëpër rrugët e fshatit dëgjoheshin biseda nga më të ndryshmet.

— ... Arif, këtë djalin, ndihmëstraktoristin, e kemi caktuar bazë te ti.

— Unë nuk kam vend as për traktoristë, as për ndihmëstraktoristë.

— Kurse për hoxhën ke, hə?

— Atje është puna ime. S'të jap hesap ty! ...

— ... A s'është kjo një tërheqje, shoku Thimi? S'është një lëshim?

— Edhe kooperativën nuk e ngritën menjëherë në të gjitha fshatrat, o Nure. Edhe në mal s'dolën të gjithë menjëherë. Ke për të parë që më pas kanë për ta kërkuar vetë e me ngulm bile.

#### 4

Të nesërmen, aty nga dreka, nëpër rrugën që të çonte lart në Dedinat dukej një turmë e madhe njerëzish si një procesion i çuditshëm. Midis turmës shquhej një gjë e stërmadhe. Nuk ishte procesion të vdekuri, sepse përpara gjësë së stërmadhe rendnin e kërcenin të shkathët si keca një trumbë fëmijësh. Por nuk ishte as një vargan krushqish të gëzuar, sepse mungonte nusja, megjithëse kënga vlonte vendçe e vallja turrrej e përdridhej. Ishte traktori i parë që ngjitej në Dedinat.

Diku njerëzit qëndruan. Përpara traktorit doli një plak i dobët dhe gazmor. Që poshtë tallaganes së trashur nga arnat nxori një palë brirë të mëdhenj kau e, pasi i ngriti e i vërtiti lart që t'i shihnin të gjithë, filloi t'i lidhte në turi të traktorit.

Turma gumëzhiu nga entuziazmi.

— Të lumtë dora, xha Arshin! I bekuar si kau qoftë!

Pastaj traktoristi befas shtoi gazin. Traktori ulëriu si me inat dhe turma u praps e trembur e pak e fyer nga sjellja harbute e traktorit, si ajo fëmija që, pasi ka përkëdhelur dhe ushqyer një qen të huaj, ky ia kërcëllet dhëmbët me hungërimë, duke i treguar se ende nuk janë bërë shokë.

Traktori u nis i pasuar nga njerëzit.

Dedinat shtriheshin mbi fshat dhe përfshinin një pllajë të tërë që skuqte nga larg. Tuli i tokës ishte i paktë. Kishte vende ku mezi futej i gjithë beli, se poshtë dilte tabani prej shtufi të petëzuar. Në vjeshtë shirat shpëlanin gjithçka, kurse në verë dielli digjte aq shumë, sa toka bëhej çerep.

Me të arritur në vend, traktoristi kërceu për tokë e pas tij ndihmësi, Sherifi.

Thimi u afrua e, pasi i kapi bërrylin traktoristit, i pëshpëriti me zë të ulët, thujse po i fliste vetes:

— Naum, vëlla, shiko sytë e njerëzve: Ka që shohin me dashuri, ka të lëkundur, po janë edhe vështrimet e smirëzinjve, të njerëzve të kulakut. Ata presin që ne të dështojmë. Dëgjon, Naum? Prandaj kanë ardhur. Të shohin se si do të thyhemi. Ki kujdes, vëlla, të lutem! Lëroje ngadalë tokën. Dhe jo shumë thellë, se tuli është i paktë, na del plloga sipër e, në vend të pjellim, dështojmë. Mundohu ta bësh bukëvale tokën. Shkrištoje. Norma jote matet me thyerjen e mosbesimit në mendjet e njerëzve. Si thua ti, Sherif?

Djaloshi buzëqeshi. Thimi i shkoi dorën mbi flokë me përkëdheli dhe e shtrëngoi pas vetes.

— Sikur të të shihte babai majë traktorit! Sa do të gëzohej! Bisedonim gjithmonë. Pas luftimit a në pritë, kur flinim kurriz më kurriz a

kur mësonim gjerat: «Djalë e kam të mirë. Dua të ngasë makina», më thoshte.

Thimi hipi mbi zinxhir të traktorit dhe iu drejtua njerëzve:

— Sot, shokë, po çajmë Dedinat me traktorin që na ka dërguar pushteti ynë. Gëzuar e me bereqet, vëllezër e motra! E ja ku jeni të gjithë këtu: Do të vijë koha kur kjo skërkë, që vetëm gjemba e shkurre rrit, edhe llokume do prodhojë. Do rrojmë e do shikojmë. Jepi, Naum!

Traktori bëri përpara, lëshoi plugun dhe plisat e parë u kthyen përmbys duke nxjerrë sipër rrënjët e gramit.

## 5

Këto kujtuan Sherifi dhe xha Arifi, ndërsa dielli po rrëzohej poshtë maleve duke lëshuar reflekse të kuqërremta në xhamat e dritareve.

— Kemi qenë të paditur, mor bir, ç'i do llafet. Të të thonë «na, o qorr, sy» e të mos i duash ... — foli plakun. — Po urdhëro, urdhëro të shkojmë nga shtëpia!

— Falemnderit, xha Arif. Në dasmë të nipave e të mbesave!

— Atëherë po e po, por edhe tani do të vish. Të kam borxh një natë te shtëpia që atëherë, e mban mend? Dhe borxhet duhen larë, — tha dhe e tërhoqi me zor Sherifin.

Rrugës plakut s'i pushoi goja për asnjë çast. Ndihej i gëzuar e i përtërirë, sikur të kishte takuar një mik të vjetër.

— Ja, kjo është shkolla tetëvjeçare, ajo

ndërtesa atje është qendra shëndetësore, kurse ajo e madhja, e pambaruara është kinoklubi i ri. Ja edhe muzeu tok me dyqanet. Këtej, djath-tas.

Në verandën e shtëpisë të shpinte një rrugicë e drejtë shtruar me çimento, anëve të së cilës ngriheshin si gardh lulepatatet me ngjyra të ndezura, ndërsa sipër mbulohej si me tunel nga pjergullat e rrushve.

Hynë brenda.

— Urdhëro ulu, — e ftoi i zoti i shtëpisë.

Sherifi ngurroi të ulej. Ishte me rroba pune.

— Ulu, mor djalë, ulu. S'jemi si një takëm që i blejnë kolltuqet vetëm për bukuri ne, or, jo, — tha plaku dhe e uli me zor Sherifin në kolltuk.

Ndërsa plaku mbushte gotat, Sherifi hodhi sytë përreth. Dhoma ishte plot dritë, e pastër dhe e mobiluar me shije.

— Që ta marrësh vesh ti, tani verës shtëpia na boshatiset fare. Fushatë, or tungjatjeta. Njëri shkon këtej, tjetra andej e, kur të shohësh ti, ke mbetur vetëm fare. Le po edhe plakën s'e nxë vendi. Por edhe unë, ama, s'e ha thatë! Çoç bëjmë edhe ne pleqtë, — u krenua xha Arifi.

— Ç'njerëz ke në shtëpi, xha Arif? — pyeti Sherifi.

— Kam një stan të tërë, — tha plaku me gaz. — Djem e çupa plot. I kam të martuar e të ndarë veç... Ja, këto shtëpitë e reja karshi të tyre janë. U shtuam, u bëmë një mëhallë. Këtu kam djalë e çupën agronome ... Urdhëro e mirë se na erdhe!

— Për të mira e për gëzime ju ardhshim!  
— uroi Sherifi dhe ktheu gotën.

— Dhe gëzimin afër e kemi, — tha plaku duke ulur zërin. — E di? Kësaj çupës sime sikur i hahet muhabeti me atë brigadierin e blegtorisë. Çoç pëshpëritin e çoç ujdysin. Djali është i mirë, ç'i do llafet, por edhe unë çupën e kam si yll. Se, që ta marrësh vesh ti, jam qerrata për këto punë. Kam hundë të hollë, s'më shpëton gjë. I nuhat që shumë larg. Të rinj janë, le të martohen e të gëzohen.

— Me shtëpi qenke rehatuar mirë, — vërejti Sherifi.

— Çka, jo keq, megjithëse ka të tjerë që janë edhe më mirë. Sikur të të kisha marrë bazë atë natë, e di ku do të flije? Ja, tek ajo plevica atje në fund të oborrit, se atë kishim shtëpi, kurse sot atje mbaj bagëtitë. Po tani edhe ato nuk do t'i lë atje, se kemi stallat moderne të kooperativës. Do t'i tufëzojmë bagëtitë.

— Po Dedinat a prodhojnë? — pyeti me interesim Sherifi.

— Dedinat? Kur të ngjitemi nesër, s'do t'i njohësh fare. Janë rregulluar e sistemuar. Eh, ç'grurë flori që bëjnë Dedinat e uruara! — tha plaku me entuziazëm. — Doli fjala e Thimit. E di ç'ndodhi atë vjeshtë? Tërë verës s'ra pikë shiu e dielli dogji për kiamet. Do ti që nga tërë tokat e fshatit vetëm Dedinat e mbajtën mirë vlagën dhe erdhi e t'u bë një misër që ç'të të them, ta prisje me sëpatë. Në shtator zjeva një gjym të madh me misra dhe ua shpura Thimit e Naumit në qytet: «Janë nga të Dedinave», u thashë. Lëre se ç'vajti!

Të nesërmen, nëpër rrugën që të çonte në Dedinat, Sherifi ngjitej me një traktor, zhurma e të cilit përzihej me uturimën e makinave bujqësore që korrnin e shinin të lashtat.



## PËRMBAJTJA

<b>AJËR I KULLUAR</b> .....	<b>3</b>
<b>FREDI</b> .....	<b>59</b>
<b>RASTËSIA</b> .....	<b>72</b>
<b>DITË TË REJA</b> .....	<b>79</b>
<b>AJO FJALË!...</b> .....	<b>97</b>
<b>JORGOJA</b> .....	<b>104</b>
<b>KUR UNË Rritesha</b> .....	<b>113</b>
<b>S'KA FAJ AI, ËSHTË I MIRË</b> .....	<b>133</b>
<b>TRAKTORI I PARË</b> .....	<b>154</b>